PRANË PYLLIT

Zhaneta Vreto Prifti

PRANË PYLLIT

Titulli: Pranë Pyllit

Autore: Zhaneta Vreto Prifti

Kryeredaktor: Alfred Cako

Redaktore: Lila Plasari

Kopertina, përgatiti: Intergrafika

Imazhi i kopertinës është marrë nga Poema
"Rruga e pa Marrë" nga Robert Frost

Copyright © Helga's Secret, 2023
ISBN 9789928091338

Kush mund e bën si do vetë,
bën si thotë Perëndia,
nukë ka në këtë jetë
gjë m'e vyer se Liria.

Në kujtim të babait Dhimitër Vreto, (1912- 1996),
i cili i recitonte shpesh këto vargje të shkëputura
nga poezia "Liria dhe Varfëria" e A. Z. Çajupit.

Dy udhë u ndanë në pyll, dhe Unë -

Unë mora më pak të shkelurën,

Dhe ajo bëri gjithë ndryshimin.

Robert Frost

PARATHËNIE

Memuaret, si kërkesë estetike për të mirën

Nga Ben Andoni

Ka disa arsye pse njerëzit ulen për të shkruar. Pa përmendur ngucin shpirtëror, një pjesë e njerëzve që ulen duan të kumtojnë estetikisht atë që jetuan në një periudhë kohore dhe për sytë e të tjerëve është e huaj dhe e pavërejtur. *"Dëshira për të ndarë një përvojë që dikush ndien se është e çmuar dhe nuk duhet të humbet*", shprehej dikur Oruell në një nga traktatet e tij për estetikën e shkrimit.

Znj. Zhaneta Prifti, një profesioniste e dedikuar dhe pas viteve '90, edhe një zyrtare e mirë, ka rënë 'peng' e këtij kumti. Duke dashur të japë konceptet estetike të së mirës dhe të keqes, përballë njëra-tjetrës në përballjet e saj, ajo rrëfen historinë e vet jetësore, deri në momentin e pensionit, përmes zhanrit të memuareve. E ka nisur nga e mbramja, kur cinizmi i shtetit ndaj nëpunësit të vet arrin apogjeun. Momenti i largimit shënon fundin e një epoke, por për fat dhe hapjen në botën e letrave. E provon cinizmin në lëkurën e vet dhe që nga ai moment do të dojë të shfryjë dikund. Por, ndaj shtetit është e pamundur, sepse kjo makinë e madhe burokratike tek ne ecën me një logjikë të pamëshirë. Ascili s'i ka parë

veprimet e fundit të Zhanetës, përballë urdhrit për daljen në pension, por me gjasë ka ditë që është e përgatitur. Kumti i eprores është i pritur. Pa bërë skena, Zhaneta, një nëpunëse që e mendon devotshmërinë si detyrë, ngrihet përshëndet dhe dorëzon trashëgiminë e vet.
Kjo është fillesa dhe pastaj autorja na merr, tashmë në vetën e parë dhe, na përcjell në të gjithë të papriturat e veta. Janë shumë, por disa të zakonshme për atë kohë, disa të pasens nga ata që i bëjnë për meskinitete, por zgjuarsia e Zhanetës tani është se merr pjesën tjetër të estetikës: Të bukurën. Paçka se në fillim merr përsipër të na përballë heroiken, përmes kujtimit të njërit prej të parëve të saj, me atë që i ka dedikuar botimin masakrave të egra ndaj shqiptarëve.
Strukturimi i të gjithë librit ndjek një logjikë të kujdesshme që përkon me historinë e saj personale. Dikur fëmija e lumtur, prej një familje të mirë; më pas nxënësja shumë e mirë; adoleshenca me episode të bukura, si ajo me prezantimin që i bën aktori i njohur prej ngjashmërisë; dashuria e saj që është zgjidhur në formë shumë të thukët, por edhe shumë të këndshme; përpjekja dhe zhgënjimi për shkollimin, njerëzit e ndryshëm që e përballin në këtë sfidë; punësimi, familja; njerëzit që e rrethojnë dhe evoluimi i Tyre; ndryshimi i regjimit dhe marrja me fushën e mjedisit dhe në fund edhe mendimi intelektual, si në vend të konkluzioneve, për mënyrën sesi mund të ecet.
Znj. Prifti ka qenë vetëm një cak nga përcjellja e këtyre memuareve drejt fikshënit, por duket se përpjekja për dëshminë dokumentare ka qenë më e madhe. Përgjegjësia ndaj jetës së vet dhe institucioneve ku

punoi e ka braktisur disi fikshënin, që zakonisht në doza të ndryshme i përfshijnë kujtimet. Sa më të ulëta të jenë dozat e fikshënit aq më të mëdha janë vërtetësitë e dëshmisë te memuaret. Dhe, autorja duket se është shumë më tepër familjare në këtë drejtim.

Është e vështirë në përqasjen e një zhanri, që nuk e ke familjar, të dëshmohesh, por megjithatë autorja ia ka dalë që të japë përditësinë e individit shqiptar në dy kohë, të përfaqësuara nga dy sisteme ekonomiko-shoqërore të ndryshme me një gamë të tërë nuancimesh emocionale dhe perceptimesh interesante. Ndjeshmëria dhe pozitiviteti në shumë nga momentet e bën autoren më të lirë që të shprehë mendimet, por edhe të gjejë linjën e drejtë të mendimit të saj, e cila s'është vetëm jeta e Zhaneta Priftit por edhe një brezi përfaqësuesish intelektualë, që ishin projeksioni i Shqipërisë. Hamendësoj se do të jenë nga të fundit, që po e bëjnë këtë, pasi sot përmes memuareve thjesht bëhet retushim. Prandaj duhen respektuar këto kujtime të shkruara thjesht dhe pastër, për një jetë që edhe me privacionet ishte e bukur deri në pakësitë e saj. E, kjo, pra, është një arsye e mirë për të shkruar. Ashtu si edhe bëri Zhaneta Prifti.

ÇLIRIMI

Zyrtarisht quhet dalje në pension, dikush mund ta quajë faqe të re të Librit të Jetës, "Krijimtari të lirë" e ka quajtur motra ime violiniste, që një pjesë të veprimtarisë së saj e kishte pasur veprimtari artistike, si dhe të tjera etiketime që kujtdo i duhet t'i përdorë kur provon emocionet e hyrjes në fazën e re të jetës.

Unë e quajta faza e lirisë dhe pavarësisë, sepse kjo është ndjesia që provova me shkëputjen nga puna si këshilltare në Ministrinë e Mjedisit dhe nga veprimtaria e lidhur me institucionet shtetërore.

Si këshilltare kabineti e ministrit L. K. në Ministrinë e Mjedisit, duhej të lija detyrën pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017, sipas rregullit të ndërrimit të kabineteve.

Ndërkohë që ministri me anëtarët e tjerë të kabinetit u larguan menjëherë, unë, paksa e tërhequr gjatë kohës nga pjesa tjetër e kabinetit, e fokusuar më tepër në veprimtarinë teknike, pata ndjesinë të largohesha atëherë kur ministri i ri B. K. ta shihte të arsyeshme.

Pas katër muajsh do të dilja në pension sipas ligjit dhe, përveç kësaj, vitet e shumta të punës, kontributet dhe përvoja e gjatë në institucionet shtetërore, ishin një arsye më shumë që e justifikonin mbylljen në kohën e duhur të karrierës profesionale.

Pa e konsideruar këtë rrethanë, vendimi për largimin nga puna ishte marrë dy javë para se të më njoftonin, ndërkohë që unë vazhdoja të vija në punë.

Ishte mesditë kur troket në derë drejtoresha e Burimeve Njerëzore, I., me shkresën e vendimit në dorë.

- Ju faleminderit! - i them pasi lexoj shkresën, - për mua është një *Happy End* (fund i lumtur)... por do të ishte mirë të më kishit njoftuar paraprakisht, sipas rregullores.

- Ndoshta do t'ju kishte mbajtur ministri edhe pak kohë, nëse do t'i kishit ndërhyrë, sepse u mendua nëse do t'i kishte ndërhyrë ndonjë person për ju…; ose nëse do ta kishit takuar personalisht për t'i kërkuar edhe katër muaj vazhdimësi", - më thotë paksa e frikësuar I. për shkeljen e procedurës në fjalë.

Fjala *ndërhyrje* më kujtoi në moment gatishmërinë e dy miqve të mi, (I. Manushi, ish-ministër, shok gjimnazi dhe mik në vazhdimësi; dhe V. Tole, akademik dhe mik i respektuar, mirënjohës ndaj motrës sime si ish-mësuesja e tij e violinës). Të dy miqtë rastësisht më kishin ofruar mbështetjen e tyre për të ndikuar, po ta ndieja të nevojshme, në kohën që isha në pritje të vendimit, nëse do të vazhdoja punë edhe katër muaj si këshilltare e ministrit të ri. E dija që mund të ishte mirëpritur ndikimi i miqve të nderuar, ose kërkesa ime, nëse do ta kisha takuar ministrin; kishim bashkëpunuar personalisht me ministrin për skemën e riorganizimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve, (në atë kohë specialist i Administratës Publike); por nuk isha e bindur nëse ia vlente të vazhdoja në sajë të *xhentilesës* së ministrit, në qoftë se nuk do të isha e *nevojshme* në ato kushte.

Mjaftonte përgjigjja e drejtores dhe pasi mbledh në qetësi sendet personale, dal nga ajo ministri. Në fakt,

kishte kohë që e ndieja që kisha dalë prej saj...kisha dalë jo vetëm nga institucioni, por edhe nga i gjithë *Sistemi aktual*.

Janë çaste reflektimi, mbi hyrjen në ato dyer institucionesh, me kënaqësi, vullnet, luftë për ekzistencë dhe dëshirë për të punuar, për t'u bërë pjesë e një kontributi të përbashkët për më të mirën e mundshme.

Por vjen një ditë që duhet të largohesh, sepse të tjerë dhe të ndryshëm nga ty, do të të zëvendësojnë. Ishte kjo arsyeja pse ndjenja e keqardhjes u shndërrua në një ndjenjë kënaqësie dhe çlirimi nga ai ambient ku prej kohësh isha ndier *e panevojshme*.

Të ndihesh e dalë nga sistemi ku ke qenë e pranishme për vite të tëra, kur ke ditur të mbijetosh në vite, me idenë se me drejtësi, aftësi e përkushtim dhe sigurisht me sakrifica mund të përballet sfida e ngritjes së mureve para teje nga injoranca dhe korrupsioni (në vend të dashurisë për pyjet, natyrën dhe ambientin në tërësi), do të thotë të pranosh ose paaftësinë e mbijetesës, ose të vazhdosh të luftosh me mënyrën tënde deri në fund të ekzistencës.

Të vazhdosh të kontribuosh, së pari do të thotë të shprehësh të vërtetën si dëshmitare e pranishme e tragjedisë së madhe me natyrën shqiptare në përgjithësi dhe pyjet në veçanti, pasojë e gjithçkaje që ka ndodhur në këtë vend ndër vite...

Kënaqësi në këto kushte është ndjenja e lirisë, e të mos qenit e detyruar të komunikosh me njerëz ku tek një pjesë e konsiderueshme mungon komunikimi apo bashkëpunimi, sepse mendojnë dhe punojnë ndryshe nga ti. Është interesant fakti që papritur kupton

falsitetin edhe të fenomeneve që ke qenë e detyruar të përjetosh gjatë kohës së punës në institucione dhe mbi të gjitha edhe shfaqje falsiteti të *miqësive* të kohës që le pas. Është shumë e vërtetë shprehja se mund të jesh mes njerëzish dhe të ndihesh e vetmuar; siç mund të jesh edhe vetëm, e të mos ndihesh e tillë. Mund të numërosh vitet dhe të jesh e ndërgjegjshme për moshën, por as mosha dhe as pasojat e pashmangshme fizike të saj nuk të bëjnë të ndihesh keq. Kompensimi më i bukur i viteve është ndjesia e përvojës, e mençurisë së shtuar dhe mungesa e keqardhjes për atë që nuk ke bërë.

Zakonisht shëtis vetëm nga Liqeni Artificial, me muzikën që më shoqëron, por mund të takoj Verën, Anitën, Irisin etj., shoqe që kanë të njëjtën dëshirë për të bërë shëtitjen së bashku, me të njëjtin këndvështrim të çështjeve që diskutojmë, me të njëjtën dashuri për natyrën, me të njëjtin ritëm. Ndihemi të kënaqura, të lira për të shëtitur, të lira për të biseduar jashtë çdo kornize, të lira për të shijuar së bashku kafen ku duam dhe kur duam.

Mbi gjithçka, kënaqësi është bilanci për punën në vite, ku nuk ekziston asnjë lloj pendese për punën dhe përkushtimin në përballimin e sfidave, vështirësive, në kushtet e imponuara... të imponuara jo vetëm nga mënyra e drejtimit të institucioneve, vështirësive për t'u përballur me mungesën e dëshirës për ndryshim, por edhe pengesave të krijuara qëllimisht gjatë të gjitha kohërave nga njerëzit e pushtetshëm të të gjitha niveleve.

Shkaku? Përgjigjja është e thjeshtë: Interesi partiak, vetjak, për pasojë korrupsioni në rritje, që çdo ditë ka

shtuar varfërinë, mosbesimin, mungesën e sigurisë...së fundmi, dëshirën për të mos qenë pjesë e përgjegjësisë së gjithanshme për këtë realitet të dhimbshëm.

E rëndësishme është të ndihesh mirë për gjithçka ke bërë, ndjesi që të bën të mendosh se në këtë periudhë refleksioni ia vlen të shkruash kujtimet e jetës, që në çdo rast e kanë një vlerë. Kanë vlerën për t'u lënë pasardhësve, apo edhe kujtdo tjetër që do të dijë diçka mbi historinë e një jete apo dhe të një brezi, në një kohë të panjohur për ta.

Vlerën e lënies së kujtimeve e kemi ndier në familje nga shënimet e hedhura herë pas here nga babai, mbi kujtimet më mbresëlënëse; gjithashtu me librin me kujtime mbi masakrat e andartëve grekë në Shqipëri, shkruar nga gjyshi, babai i mamasë, Kostë Papa Konomi.

Libri është botuar në vitin 1917 në SHBA, ku ai punonte pranë shoqërisë "Vatra". Libri ka vlerë jo vetëm për vërtetësinë në përshkrimin e ngjarjeve të viteve 1913-1914, ku autori ishte një dëshmitar okular, por më shumë për ndjenjën e atdhetarisë që përcjell te bashkatdhetarët e tij. Mbi gjithçka, na bën të ndihemi mirë për karakterin e tij, lidhur me të Vërtetën, në mënyrë të veçantë kur na duhet të përballemi me rëndësinë e së Vërtetës në çdo kohë dhe rrethanë.

Fakti që vërtetësia e kujtimeve i jep lehtësi shkrimit, më jep zemër të mos ngurroj t'i hedh në letër kujtimet më mbresëlënëse të viteve të shkuara, të bazuara vetëm në ngjarje të vërteta dhe të lidhura natyrshëm me realitetin e kohës së bashkëmoshatarëve të mi.

Me shumë vërtetësi (ngjarje, njerëz, data dhe fakte të vërteta) dua të tregoj vetëm për ngjarje që kanë

ngelur në kujtesën time. Janë ngjarje ku kanë qenë të pranishme dëshirat, kënaqësitë, qëllimet, vizionet për të ardhmen, zhgënjimet, vështirësitë, pengesat, deri në paradokset për ngritjen e mureve të pakapërcyeshme në arritjen e qëllimit.

Para se të shkruaj për punën në atë ministri, që më vonë do të përflitej si një ministri e korruptuar dhe do të shkonin para drejtësisë drejtuesit kryesorë, më duhet të filloj me rrugëtimin tim në vite. Nga ky moment, do të flasin vetëm kujtimet, duke shpresuar të vijnë jo vetëm kujtimet më të bukura dhe më mbresëlënëse që truri natyrshëm i ka ruajtur, por edhe ato më me vlerë dhe më interesante për lexuesin, duke ia lënë harresës momentet jo të këndshme, që me ndërgjegje jam përpjekur t'i harroj.

KUKULLA

Fëmijëria ka qenë e bukur për mua dhe motrën më të madhe Lidën, në një familje ku Zoti na kishte bekuar të rrethoheshim nga ata prindër dhe familjarë që padyshim kanë meritën më të madhe për atë që ne t'ia dilnim me sukses në jetë, sikurse ata dhe ne dëshironim.

Në kushte ekonomike pak a shumë të njëjta me shumicën, (sipas parimit socialist të barazisë), mënyra e organizimit të jetesës në familjen tonë na kishte mundësuar kushte që ne të mos ndienim asnjë mungesë, sipas mundësive dhe kërkesave të kohës.

Babai Dhimitër, i përkushtuar (pak me tepri) pas cilësisë së ushqimit që duhej të hanim, jepte vazhdimisht këshilla, të bazuara në librat që lexonte. Këto këshilla zbatoheshin me rigorozitet nga tetoja jonë Izmini, motra e babait. Teta, siç e quanim ne, merrej me gatimin në familje, gjithashtu dhe me veshjen tonë, falë talentit të saj për të qepur. Ishte e prirë të shihte fillimisht *figurinat*, siç i quante ajo katalogët e kohës; më pas merrte fustanet e mamasë që i kishte dërguar tetoja e saj nga SHBA dhe me shumë shije i përshtaste për ne.

Mamaja Marika, përveç punës, merrej kryesisht me punët e shtëpisë dhe pazarin; shpesh i duhej të shpenzonte shumë kohë për mbajtjen e radhave. E vështirë ishte ngritja e saj shumë herët në mëngjes për të zënë radhë te dyqani i qumështit; më pas te dyqani i mishit apo dhe i ushqimeve, veçanërisht në ditët pas

marrjes së pagës (pesëmbëdhjetëditëshit, në atë kohë), kur të gjithë drejtoheshin te dyqani i ushqimeve.

Ishte babai që merrej veçanërisht me edukimin tonë dhe në mungesë të tij xhaxhai Llazi, i cili, veç të tjerash, na kënaqte me interpretimin e tij me muzikën e gojës. Për herë të parë Serenatën e Shubertit e kemi dëgjuar të interpretuar prej tij...ikja e tij e parakohshme ishte mungesa e parë e një dashurie të madhe për ne.

Babai ishte tepër këmbëngulës në kërkesat rigoroze për edukimin tonë. Këshilla e përhershme e tij ishte që ne nuk duhej të shkonim nëpër radha, as të ngarkoheshim me punë shtëpie, sepse duhej të merreshim, motra kryesisht me violinën, unë me librat. Por ishim fëmijë dhe donim të luanim, prandaj përpiqeshim t'i bënim shpejt detyrat që na ngarkonte babai dhe t'i vidheshim për të vazhduar me kënaqësitë tona të pazëvendësueshme. Shkonim të gëzuara te kopshti i fëmijëve, ku na çonin prindërit çdo ditë deri në mesditë, sepse pastaj në shtëpi ishte tetoja që kujdesej me shumë dashuri dhe përkushtim për ne; ndërkohë te kopshti kujdesej edhe nusja e vëllait të mamasë, Donika, edukatore kopshti, që na jepte shumë dashuri. Ne ndiheshim mirë, si fëmijët në përgjithësi, me gjithë mungesën e larmisë së lodrave, që nuk mund ta ndienim në atë moshë.

Edhe sot e kujtojmë me Eriketën (Ketin), shoqen time që prej fëmijërisë, kënaqësinë dhe emocionet gjatë një vizite me kopshtin në kufirin shqiptar. Se çfarë kërkonim ne fëmijët nga tre deri gjashtë vjet në kufi, për të vizituar ushtarët shqiptarë, (pyetje që na bën të qeshim sa herë e kujtojmë), këtë mund ta dinin vetëm ata që na çonin. Fotot që i kemi ende, tregojnë sa të

gëzuar ishim të takoheshim me ushtarët në kufi. Aty na thanë se për ne ata ishin *heronjtë* që na mbronin jetën nga *armiqtë* që na rrethonin...aty mësuam që na donin aq shumë, sa, për të na mbrojtur, rrezikonin të vdisnin në luftë ballë për ballë me armikun që e kishin shumë pranë. Gëzim i madh ishte kur kërcyem valle me *heronjtë tanë* dhe akoma më i madh ishte ky gëzim kur ata na morrën në krahë për të bërë foto. Mua më morri në krah komandanti, me të cilin me shumë qejf kërcyem edhe valle dorë për dore, por nuk do të zgjaste shumë gëzimi, sepse një nga shoqet e grupit qau, pse atë e mori në krah ushtari dhe jo komandanti; pastaj fillova të qaja edhe unë, duke i thënë se nuk ishte faji im për këtë. Ishte tepër mbresëlënëse, kjo vizitë përderisa ka mbetur e paharruar.

Luanim shumë me lojërat e kohës, kryesisht në rrugë apo në oborrin e shtëpisë sonë. Gëzim i madh kur binte dëborë dhe luanim me topa dëbore, me Dianën, shoqen e afërt të fëmijërisë dhe në vazhdimësi. Luanim *me cingla, lojë luftash, poza bukurie, apo me plloçkë* në oborrin e shtëpisë. Loja që na pëlqente më tepër gjatë verës ishte ajo *me poza bukurie* pranë vazove me lule në oborrin e shtëpisë. Merrnim poza nga më të ndryshmet, pranë vazove të shumëllojshme, që zbukuronin oborrin e shtëpisë sonë nën hijen e pjergullës që mbulonte një pjesë të oborrit. Të gjitha këto lojëra ishin të bukura dhe pa shpenzime, sepse ishin të sajuara si të tilla, në mungesë të lodrave në treg... por, megjithëse ishin më të thjeshta, sot nga pozitat e gjysheve na duken më të bukura se lodrat e shumta dhe të larmishme të të vegjëlve tanë; mbase më të bukura edhe se sfilatat e fëmijëve sot *në platformat luksoze të modës*.

Nuk mund të harrojmë kur luanim në shtëpitë e njëratjetrës me kukullat e bëra prej copash të rastësishme nga mamatë në shtëpi, sepse ato mungonin në treg. Mbi të gjitha, mbetet e paharruar kukulla e vetme e blerë nga prindërit te "*Valuta*", siç quhej dyqani ku bliheshin mallra të huaja, që ishin shumë të pakta dhe më të shtrenjta se në tregun e zakonshëm. Kukulla ishte gjëja më e bukur dhe më me vlerë për ne në atë shtëpi. Për t'u ruajtur, kjo kukull vendosej në sëndukun (siç e quante nëna) e sendeve më me vlerë të shtëpisë dhe nxirrej me raste, kur shtrohej shtëpia në ditët e festave (ditën e Shën Mitrit, emri i babait, apo ndonjë festë tjetër e familjes). Sapo ndienim erën e naftalinës që ruante qilimat dhe velenxat nga mola, kuptonim që ishte hapur sënduku ku mamaja, veç të tjerash, ruante gjërat më me vlerë të pajës së saj të dikurshme, së bashku me gjënë tonë më të dashur, kukullën. Ia merrnim vrapit me motrën, kush ta merrte më parë në krahë atë kukull, që ishte lumturia jonë më e madhe në ato ditë të bukura familjare.

Gëzimi ishte kaq i madh, sa na dukej sikur edhe kukulla që sapo zgjohej, me shkëlqimin e syve bojë qielli dhe gojën e hapur duke qeshur, na shoqëronte në gëzimin tonë. Kjo lumturi do të përsëritej edhe ditën e 1 Majit, kur edukatorja shumë e dashur Vangjelia na porosiste që duhej të kishim në krah një kukull kur të parakalonim atë ditë *si fatosa të lumtur të xhaxhit Enver*. Sa mirë do të ishte të kishte më shumë *data 1 Maj*, mendoja unë, sepse kukulla pas parakalimit do të futej përsëri në sëndukun e pajës së mamasë, për të dalë në festën e ardhshme.

Ky ritual vazhdoi për vite, sepse pas motrës që e kishte gëzuar para meje, do ta gëzoja unë dhe pas meje do ta gëzonin vajzat e motrës, Zelina (Ina) dhe Emi.

Kështu, kukulla ngelej gjithmonë e re, deri sa pas vitesh e mori në dorë Tedi, im bir; puna e parë që bëri Tedi, ishte që e zhveshi kukullën, i hoqi fillimisht fustanin, pastaj krahët dhe këmbët, dhe së fundi mbeti vetëm koka e bukur e kukullës, që na vinte keq ta ruanim ashtu. Ky ishte edhe fundi i *kukullës 40-vjeçare*. Duhej ruajtur ajo kukull që na sillte shumë kujtime.

VIOLINA DHE SHKOLLA

Lida, motra ime, do të ishte e para që u regjistrua në klasën e parë të shkollës fillore. Me gjithë gëzimin e shkollës, ajo u mërzit sepse nuk u pranua në Shkollën e Muzikës, pavarësisht talentit të spikatur që herët. Babai, i cili e donte shumë artin dhe muzikën në veçanti (vetë kishte luajtur në kitarë) e kishte pasur ëndërr që motra ime të mësonte në shkollën e muzikës, në degën e violinës. Ishte i bindur për talentin e saj, por u deshën edhe 3 vjet pas klasës së parë për të realizuar ëndrrën e tij dhe më vonë edhe të motrës.

Fillimisht, bëri të mundur ta çonte motrën në Shtëpinë e Pionierit, për të ndjekur aty, jashtë shkolle, mësime të violinës, gjithashtu edhe mësime private tek një mësues që banonte afër nesh. Më pas vazhdoi lufta me institucionet e arsimit. Ishte një periudhë përpjekjesh trevjeçare, që, falë këmbënguljes së babait, motra u pranua në shkollën e muzikës, në degën e violinës, në klasën e katërt. Ishte një konkurs i veçantë, me komision të posaçëm, organizuar nga Komiteti Ekzekutiv i kohës, që e pranuan falë paraqitjes më të avancuar se bashkëmoshatarët e saj në shkollën e muzikës në Korçë. (Me gjithë kufizimet e regjimit komunist të kohës, edukimit artistik të brezit të ri i kushtohej vëmendje, sigurisht *brenda kornizave të paracaktuara*).

Babai ishte i ndërgjegjshëm përse vajza e tij nuk ishte pranuar që në fillim në shkollën e muzikës. Pas

një konkursi formal, ishin pranuar të hynin në klasën e parë të muzikës, fëmijët, prindërit e të cilëve bënin pjesë në shtresën e të privilegjuarve për kohën, ose të atyre që me ndërmjetësi kishin arritur ta fitonin konkursin e fëmijëve të tyre. Por ndërsa të gjithë fëmijët e tyre i ndërprenë më vonë studimet në atë shkollë, motra Lida vazhdoi si një violiniste e talentuar, fillimisht në qytetin e Korçës dhe më pas në Institutin e Lartë të Arteve, në Tiranë, ku u pranua pas konkursit që e fitoi falë aftësisë dhe talentit të saj.

Lida kishte detyrë studimin në violinë dhe veprimtaritë lidhur me të, kurse unë, veç mësimeve të shkollës, kisha edhe librat jashtë shkollorë dhe ndonjë veprimtari në Shtëpinë e Pionierit, ku ishin të shumtë fëmijët që shkonin aty në kohën e lirë. Babai nuk lëshonte pe me mënyrën e tij këmbëngulëse, lidhur me kërkesat ndaj nesh për të dhënë maksimumin, motra në violinë, kurse unë në mësime. Tingujt e violinës ishin sfondi i përhershëm normal në shtëpinë tonë. Violina dëgjohej jo vetëm brenda shtëpisë, në çdo cep të saj, por deri jashtë në rrugë. Kështu prania e tingujve të violinës, që filloi shumë herët në fëmijëri, do të më shoqëronte në vite, sa edhe tani muzika vazhdon të jetë gjithmonë e pranishme kur lexoj.

Nuk duhet të ketë asnjë notë veç dhjetës për ty, më përsëriste vazhdimisht babai; kurse motrën, përveç përkushtimit ndaj mësimeve, e shoqëronte gjatë gjithë kohës së studimit në violinë (në mungesë të metronomit). Babai ynë nuk dilte pasditeve me shokë, siç ishte zakoni i shumicës së burrave në atë kohë, që pas pune do të dilnin të bënin xhiron e zakonshme

me shokët në bulevardin e Korçës, apo do të uleshin në ndonjë kafene të asaj kohe. Kohën e lirë e kalonte së bashku me ne me shëtitje në natyrë dhe ajo që na është ngulitur në kujtesë, janë librat që nuk i ndante asnjëherë.

Nga shkrimtarët shqiptarë, përveç Jani Vretos (me të cilin ndihej krenar si për njeriun e familjes), lexonte Nolin, Kutelin, Konicën, Lasgushin (të parapëlqyerin e veçantë); ndërsa ndër të huajt lexonte Hygoin, Tolstoin, Gëten, Niçen, Shopenhauerin, Khajamin me "Rubairat" që na i recitonte shpesh, krahas vargjeve të famshme të poemës "Skënderbeu" nga Longfellou që e dinte përmendësh.

Të shumta ishin historitë nga jeta e tij dhe e brezit të tij, të mbrujtura me ndjenjën e patriotizmit dhe të dashurisë për vendin dhe qytetin e dashur, Korçën.

- Ndiheshim krenarë, - na thoshte shpesh, si pasardhës të familjeve patriote, që kishin kontribuar në hedhjen e bazave të gjuhës dhe arsimit shqip. Ishte brezi që, në gjurmët e të parëve të tyre, do të pasuronin vlerat e qytetit të Korçës, të njohur si djepi i patriotizmit, arsimit, kulturës, artit, muzikës, së shprehur aq bukur në *Serenatat* e kënduara në masë nga djalëria korçare. Gjithashtu këngët e kënduara nga Kori Lira, që sot përbëjnë një trashëgimi me vlerë kulturore të qytetit.

Ishin këto vlera në sajë të të cilave Korça do të quhej *Paris i Vogël*, shumë kohë para ngritjes së Liceut Francez në vitin 1920. Ishte koha kur do të ndihej ndikimi i kulturës franceze, jo vetëm në aspektin e qytetarisë, kulturës dhe artit, por edhe në atë të urbanistikës dhe arkitekturës së banesave qytetare korçare.

Babai tregonte se fillimisht i kishte parapëlqyer idetë bolshevike të një komunizmi idealist. Në përgjithësi, thoshte ai, të rinjtë e moderuar dhe të miredukuar të kohës e përqafuan bolshevizmin, si teorinë e duhur *për një jetë më të mirë*..dhe jo vetëm kaq, por kontribuan gjatë luftës për çlirimin e vendit (e kishte ende shenjën e plumbit në këmbën e djathtë, që e kishte marrë në Demonstratën e Bukës në Korçë).

Shumë shpejt ai dhe disa nga shokët e tij e kishin kuptuar se ndërsa *marksizmi* kishte qenë një *teori e bukur dhe joshëse*, *bolshevizmi* kishte qenë vetëm një utopi dhe ishin zhgënjyer nga çka kishin ëndërruar dhe nga çfarë u pa të realizohej nga *ata* që morën në dorë *pushtetin komunist*. Nuk mund të bëhesha komunist përkrah njerëzve, një pjesë e të cilëve, kur ne aspironim idetë komuniste, ishin në listat e rinisë fashiste. Më pas po ata u gjendën komunistë në pushtet, na thotë babai një ditë me zë të qetë, duke na lënë të nënkuptonim se këto fjalë thuheshin vetëm brenda shtëpisë.

-Të paktën të kishe mbajtur një flori për kujtim, - i thoshte me humor kushëriri i tij Jani, që kishte ardhur një ditë për vizitë në shtëpinë tonë.

- Çfarë ishte ai floriri që duhej të kishe mbajtur për kujtim? - e pyes me kuriozitet babanë pasi iku kushëriri. Si gjithmonë, që babai na thoshte të vërtetën mbi gjithçka kur e pyesnim, na tregoi mbi faktin se si kishte vendosur të punonte si ekonomist i thjeshtë, pasi kishte dhënë dorëheqjen nga puna e ngarkuar nga Partia në atë kohë, për të marrë pjesë në konfiskimin e pasurisë së tregtarëve.

- U dorëhoqa, sepse ishte e pamundur të merrja pjesë në tragjedinë e kohës, të shihja sesi e vuanin konfiskimin e pasurisë tregtarët, qytetarët e nderuar të qytetit të Korçës. Për pak orë, u merrej pasuria që e kishin vënë me punë në vite, - tregonte babai, midis të tjerash me dhimbje dhe shqetësim...

Vendimin e kishte marrë të prerë, kur, pak kohë pasi po kryente këtë detyrë, një tregtari i kishte rënë të fikët kur kishte parë babanë të hynte në shtëpinë e tij. Pas kësaj ngjarjeje, babai kishte shkuar në Komitetin Ekzekutiv të kohës dhe kishte dorëzuar dokumentet, së bashku me çelësat e magazinës së mallrave të konfiskuara deri në atë moment. Babai ishte i ndërgjegjshëm që dorëheqja e tij mund të kishte edhe pasoja, por nuk mund të vepronte ndryshe..

Gjithashtu ishte i ndërgjegjshëm që po të mos ishe fëmijë *të privilegjuarish*, donte të thoshte të mos gëzoje të mirat e njerëzve të pushtetit të kohës. Përballja me të *privilegjuarit e pushtetit* do të na ndiqte gjatë gjithë kohës, që nga fëmijëria e në vazhdimësi, pavarësisht *parimeve komuniste* në dukje. Ishte kjo një arsye e rëndësishme që duheshin përpjekje të shumëfishuara për të arritur me forcat tona ato që fëmijët e tjerë i arrinin si të privilegjuar. Ishte një arsye më tepër kjo dhe ne e kishim kuptuar që duhej të punonim shumë për të arritur në jetë atë që dëshironim... prandaj e mirëkuptonim kërkesën e rreptë të babait që duhej të jepnim maksimumin, Lida në violinë dhe unë në mësime. Pranonim gjithashtu kufizimet që duhej të kishim si fëmijë për t'u marrë me lojëra, me sport, kur kujtonim gjithmonë shprehjen e babait që na e thoshte

shpesh në italisht *tempo perduto*. Edhe sot e kujtoj këtë shprehje, kur ndeshemi me ngathtësinë tonë në lojërat e sportit, apo kur nuk marr pjesë në *lojërat me letra*, që janë veçanërisht të pëlqyera nga im shoq Anesti, por edhe nga miqtë tanë francezë.

Babai ndihej i kënaqur që me punën e tij jashtë shkolle kishte arritur që Lidës t'i jepte drejtimin e duhur në fushën e artit, kurse mua në fushën e librave, duke më ngulitur që herët në fëmijëri dashurinë për librin. Isha pesë vjeç, kur, në sajë të punës së tij, kisha filluar të lexoja libra për fëmijë. Më ka ngelur në kujtesë, kur mësuesja shumë e dashur dhe e paharruar e klasës së parë Stefania, duke biseduar me babanë në takimin me prindër, i thotë:

- Nuk është shumë e përqendruar në mësimin e Abetares, ndoshta sepse ka mësuar të lexojë para kohe; të marrë shembull nga shoqja e saj Mira, që është më e përqendruar.

Mira, shoqja ime e shkollës fillore, me të cilën ndanim kohën e shkollës, por edhe kohën e lirë, ishte vërtet një shembull pozitiv, dhe jo vetëm për mua. Ka qenë mbresëlënëse keqardhja kur ajo u largua për shkak të ndryshimit të shtëpisë, që e detyroi të ndryshonte edhe shkollën. E kujtoj shpesh si mbresën e parë të mungesës së një mikeje të ngushtë, pa ditur atëherë që jeta do të na sillte në vazhdimësi përballje të shpeshta me ndjenja keqardhjeje të largimit të njerëzve që kemi ndarë kujtime të bukura.

Vërejtja e mësueses ishte e tillë që në atë moment më preku shumë, por sot e mendoj si vërejtje me vend. Ndërkohë, babai do të vazhdonte me mënyrën e tij

këmbëngulëse për edukimin parashkollor, kur pas nesh, edhe fëmijët tanë patën fatin të rriteshin në prani të tij për pak kohë. Zelina, Emi dhe Tedi, krahas kujtimeve të paharruara të përkushtimit të nënës në rritjen e tyre, nuk mund të harrojnë përkushtimin dhe këshillat e gjyshit, që i ndihmojnë edhe tani që vetë janë bërë prindër.

- Ruani bukurinë natyrore, që është bukuria e vërtetë femërore, - ishte këshilla që na përsëriste shpesh dhe ende sot mbetet shumë e vlefshme për vajzat mbi nocionin e bukurisë.

Këmbëngulja dhe këshillat e tij në miredukimin tonë nuk shkuan kot, por u bënë realitet nga ne. Falë punës dhe talentit të saj, por edhe prej mbështetjes pa fund të babait, Lida fitoi konkursin për violinë dhe mbaroi Institutin e Lartë të Arteve. Violina ishte profesioni shumë i dashur i saj, që do ta ndihmonte në vazhdimësinë e punës si mësuese e përkushtuar dhe me rezultate në mësimdhënien e violinës. Mund të kishte zgjedhur edhe jetën koncertale motra, por *vetëm talenti dhe puna nuk mjaftonin..*

Unë mbarova shkollën e mesme me notën mesatare dhjetë gjatë katër viteve, me të drejtën e Medaljes së Artë. Ishte kjo arsyeja që do të më ndihmonte në realizimin e synimeve në vazhdimësi, për të cilat ndihesha e kënaqur dhe e vlerësuar nga babai.

Ai ndihej i lumtur, që pas nesh shihte edhe fëmijët tanë në rrugën që ai kishte dëshiruar dhe që premtonte realizimin e ëndrrave të tij. Para se të ndërronte jetë, na la amanet që të mos qanim, por Lida të luante në violinë *"Andaluzën" e P. Sarasates*, që e kishte kënaqësi

sa herë e dëgjonte dhe e këndonte motivin e saj. Kështu iku i kënaqur, për gjithçka kishte arritur, duke lënë pas mirënjohjen tonë dhe të fëmijëve tanë, që do të gdhendnin mbi varrin e përbashkët të gjyshërve epitafin: "Faleminderit për përkushtimin tuaj ndaj nesh!"

MBRESA

Fëmijëria dhe rinia në diktaturë përjetohej pak a shumë njëlloj nga të gjithë që synonin për një jetë ku të gjenin hapësirat e duhura për realizimin e ëndrrave. Për kohën, ishte normale që, nëse kjo ëndërr do të realizohej, nuk do të mjaftonte vetëm aftësia dhe talenti individual në një fushë të caktuar, pa mbështetjen dhe më pas shansin apo fatin siç quhet shpesh.

Ishte brezi im, të lindurit e vitit 1957, sikurse dhe të viteve të tjera të kohës së diktaturës, një nga brezat që e kanë përjetuar diktaturën me privimet e gjithanshme, në ushqime, sjellje, veshje, edukim, arsimim, punësim etj., të cilat kanë lënë mbresa të pashlyeshme në memorien e viteve.

Lindëm kur ishte kulmi i thurjes së lavdisë ndaj të mirave të komunizmit tonë, që për fat të keq as nuk do të revizionohej si në vendet aleate të kampit socialist ku bënim pjesë. Ishim vetëm ne, që do të shkonim me *guxim dhe vetëmohim* drejt fitoreve në rrugën e socializmit dhe të diktaturës së proletariatit. "*Shkëmb graniti buzë Adriatikut*" titullohej vjersha që më ishte caktuar të recitoja, nga mësuesja ime e dashur e fillores, Stefania. E recitoja gjithë emocion dhe pasion atë vjershë, sepse përfytyroja *vendin tim të bukur dhe të lumtur, në plazh buzë detit*; por kënaqësinë e përfytyrimit e shtonte më shumë vargu i fundit dhe i vetmi që mbaj mend: ...*dhe të gjithë popujt paqedashës janë me ne*. Këtu mbyllej vjersha, por edhe përfytyrimi im, që nuk do të zgjaste

shumë, kur pas pak vitesh do të kuptonim sa *të lumtur* ishim... sa *të mbrojtur ishim nga armiqtë, nga librat dhe informacionet e ndaluara të botës së përtej kufijve, nga dogmat fetare dhe ideologjitë e botës kapitalisto-revizioniste.*

Vetëm pak kujdes, *sipas porosive* dhe nuk kishte forcë të ndalte *lumturinë* tonë.

Mungoi ky "*kujdes*" tek organizatorët e Festivalit XI të Këngës në RTV, që solli këngë ndryshe nga festivalet e tjera. Ishte ai *ndryshim* që i la ato këngë të gdhendura në memorien e shqiptarëve, për bukurinë, melodinë, tekstin dhe të rejat që sollën në muzikën e lehtë dhe artin shqiptar të kohës. Ishte ai, gjithashtu, që *shqetësoi* Partinë, që do të mblidhte Plenumin IV të KQ, ku u nxorën përfundime e vendime mbi *prirjet liberale dhe shfaqjet e huaja* në fushën e Muzikës, Letërsisë dhe Artit.

Ishin këto ngjarje që do të shënonin kthesën e frikshme, jo vetëm në këto fusha, por në krejt jetën e shqiptarëve. Kthesa filloi me goditjen e elementëve që u quajtën shkaktarë të *liberalizmit dhe degjenerimit në fushën e kulturës dhe të artit*...më pas do të vazhdonte me goditjen e njerëzve që konsideroheshin të *rrezikshëm për situatën*.

Ishte një mëngjes i zymtë, kur si gjithmonë më duhej të shkoja në shkollën e mesme "Raqi Qirinxhi", ku vazhdoja mësimet. Nuk më kujtohet data, të cilën e kisha shkruar në ditarin që mbaja në atë kohë. Me ngjarjet që do të pasonin, e grisa atë ditar, në vend që ta fshihja; por ndoshta bëra mirë, për t'ia besuar natyrshëm trurit kujtimet më mbresëlënëse.

Gjatë rrugës ndjeva lëvizje jo normale makinash dhe parandjeva se diçka po ndodhte. Sapo rreshtohemi për të hyrë në shkollë, dëgjojmë me shoqet se atë ditë ishin duke u internuar disa familje, që ishin të njohura për familje të nderuara në qytetin e Korçës. Ishin arrestuar gjithashtu persona që akuzoheshin se kishin shkruar parulla kundër pushtetit. Midis tyre ishte internuar edhe një nga mësuesit tanë më të nderuar, mësuesi i fizikës, G. Kolaci, së bashku me vëllanë e tij Vaskën, (ish mësuesi i respektuar i violinës i motrës, në Shkollën e Muzikës), gjë që na shqetësoi aq shumë, sa atë ditë nuk kishim vëmendjen e duhur në mësim.

Nuk kuptonim çfarë po ndodhte dhe flisnim vetëm mes shoqeve të afërta në fshehtësi, sepse terrori dhe censura bënin punën e vet. Në vazhdën e arrestimeve, ato ditë u ndjemë shumë keq kur mësuam arrestimin e një komshiu në rrugën tonë, mësues në fshat dhe djalë i respektuar me prejardhje nga një familje *e deklasuar*, me mbiemrin Harilla. Ishte një familje e respektuar ku fqinjët e mëhallës shkonin shpesh për të pirë kafe, sipas zakonit mes fqinjësisë së mirë në mëhallat e qytetit të Korçës. Lajmi i arrestimit të djalit të saj donte të thoshte që fqinjat nuk do ta kishin më atë kënaqësi në shtëpinë e teta Niqit, sepse shtëpia e saj do të përgjohej. Pafajësia e tij do të vërtetohej vetëm kur me ndryshimin e sistemit, do të merrte dëmshpërblimin monetar për vitet e burgut.

Në vazhdën e ngjarjeve, ishte tregim horror, kur kthehet mamaja nga Lushnja, pas pjesëmarrjes në varrimin e burrit të kushërirës së saj të paharruar, një nga mësueset e nderuara të qytetit të Lushnjës. Nuk

ishte vdekje e zakonshme, ishte vetëvrasje. Burrit të kushërirës, njeri i njohur dhe i respektuar, para aktit të vetëvrasjes, i kishin kërkuar nga organizata e Partisë ku bënte pjesë të dorëzonte teserën e Partisë. Shkaku?: Ishte kunati i një prej të porsa arrestuarve (ministrit të Brendshëm), një prej njerëzve më të pushtetshëm të asaj kohe. Dhe ai, *e dorëzoi teserën*, së bashku me jetën. Miqtë, shokët, qytetarët e Lushnjës, të terrorizuar nga situata e kohës, nuk kishin guxuar të afroheshin për të marrë pjesë në përcjelljen e atij miku aq të respektuar deri në atë moment...as të afërmit e familjes së tij dhe të gruas së tij nuk kishin guxuar, nga frika e pasojave që mund të kishin në familjet e tyre...as shokët dhe miqtë e djemve të tij të njohur shumë të respektuar mes shokësh në qytetin e Lushnjës, nuk u afruan madje edhe në momentin kur kishin ngelur të vetëm para ngritjes së arkivolit të babait të tyre. Pranë u gjendën vetëm tri kushërirat pensioniste, mamaja ime, motra e mamasë, Meropi dhe nusja e dajës, Donika, që në pamundësi për t'i ndihmuar fizikisht djemtë, i ishin lutur shoferit të makinës për t'i ndihmuar në ngritjen e arkivolit. Qytetarët në rrugë, gjatë kohës që kalonte makina mortore e shoqëruar nga gjashtë veta, mundën të bënin nderimin e fundit vetëm nga larg. E kishin nderuar mikun e tyre duke ndalur në rrugë me kokën ulur në momentin që trupi i tij po çohej në banesën e fundit...për ne mbeti një tregim horror, së bashku me keqardhjen për ikjen e njeriut të dashur.

Ishte një ngjarje në vazhdën e shumë ngjarjeve të tjera të lidhura me familjet e njerëzve të pushtetshëm të kohës. Ishin *kundërshtarë të diktatorit*, që po dënoheshin me vite të tëra në burg apo edhe me vdekje.

Historitë vazhdonin me ngjarjet tragjike të të afërmve që pasonin dënimet e tyre, si internime, ndarje të çifteve dhe të fëmijëve nga prindërit, për t'i shpëtuar internimit, ndarje të dashuruarish, e të tjera si këto, që vuanin jo vetëm personat e dënuar, por edhe të afërmit e tyre.

Në realitet këto i vuanin edhe njerëzit e thjeshtë që i dëgjonin nga larg, sepse ishin njerëz që po vuanin për çështje ideologjike apo politikash të kundërta, për të cilat dënoheshin.

Si një tregim horror ka mbetur në memorie edhe dita e arrestimit dhe më pas dita e gjyqit të profesorit të nderuar, njeriut erudit, poliglot, me një kulturë të jashtëzakonshme, K. Venediku, ku, të detyruar nga shkolla, na çuan të merrnim pjesë si dëgjues në atë gjyq. Do të mbetej i pashlyer në kujtesë, terrori që na krijoi zëri i tmerrshëm i prokurorit, si dhe shpërfytyrimi i profesorit të respektuar, pas vuajtjeve dhe torturave që kishte kaluar. Por ajo që na tmerroi më tepër ishte kur dëgjuam Vendimin e Gjyqtarit, Burgim me 25 vjet. Së bashku me profesorin, u dënuan edhe piktori V. Tushi dhe profesori i nderuar G. Peci (i biri i patriotit të shquar S. Peci), i cili na kishte dhënë mësimin e gjuhës franceze, si gjuhë suplementare në shkollë.

Me profesor Kiçon kishim një kujtim të veçantë. Një ditë shkuam së bashku me motrën dhe babanë të dëgjonim disqet me muzikë klasike tek ai, sepse gramafoni ynë kishte defekt. Ndërkohë, profesori na tregonte, veç të tjerash, histori interesante mbi të kaluarën e qytetit të Korçës, rreth muzikës dhe artit, por edhe kuriozitete filozofike mbi idealizmin, ekzistencën e

shpirtit, botën misterioze, duke na ngjallur kuriozitet për ta dëgjuar me kënaqësi. Motra ishte 16 vjeç, kurse unë 13. Nuk e besuam kurrë që profesori t'i bënte këto biseda për qëllime politike, por ndoshta biseda e tij ndikoi në formimin tonë për sa i përket besimit ndaj botës së idealizmit, ose dhe atij fetar.

Në familje, përveç mamasë, nuk ishim mbrujtur me edukimin fetar. Kur diskutonim rreth fesë, babai shprehej se besonte rreth një *fuqie të jashtëzakonshme*, por jo te praktikat fetare.. ishte kjo arsyeja që nuk e nxiste mamanë të na merrte edhe ne kur shkonte të dielave në kishë. Një të diel, kur mamaja më mori me vete në kishë, babai me motrën shkuan në kinema, ku shfaqej filmi "Shtëpia Rikordi". Kur u kthyem në shtëpi motra më tregonte me shumë kënaqësi historitë e jetës së kompozitorëve që kishte parë në film, kurse unë u ndjeva keq, sepse nuk kisha çfarë t'i tregoja. Megjithatë, ne vazhdonim të shkonim në kishë, sa herë na çonte mamaja, rregullisht çdo të diel, si edhe në ditët e festave fetare.

Feja do të ndalohej, kishat do të mbylleshin pas pak kohe, por besimi na shtynte të besonim në hapjen e tyre.. megjithatë, nuk mungonin rastet kur me shoqe do të shkonim vjedhurazi në ndonjë kishë, që konsiderohej si vend i shenjtë.

Ngelet i paharruar në kujtesë ekskursioni në natyrë me motrën dhe shokët e shoqet e saj, R.Suxho, çiftin Mara (Tatiana dhe Dhimitri), T. Misrasi, B. Fundo dhe I. Lulo, që ishin bashkënxënës me motrën në shkollën e mesme të muzikës "Tefta Tashko" në Korçë (miq të përhershëm të kujtimeve të bukura). Qëllimi

i ekskursionit ishte të shkonim te një kishëzë e vogël në kodër mbi fshatin Barç, që pas mbylljes së kishave ishte kthyer në magazinë. Dritaret e kishëzës ishin zënë me dërrasa, që të mos shihej çfarë kishte brenda saj; por, nga fjalët që qarkullonin fshehurazi nëpër Korçë, çuditërisht nga një pjesëz e vogël e lirë e dritares dukej afresku i Shën Mërisë. Ishte një rreze drite që e bënte të dukshëm portretin e *Shën Mërisë*, si për të tërhequr njerëzit, të cilëve u ishin mbyllur dyert e kishës, por gjenin një mundësi për të parë *Shën Mërinë* nga dritarja.

Kemi shkuar në fshehtësi dhe aty shkonim me radhë te dritarja, gjithë kuriozitet dhe emocion, ku kishte vend për të parë vetëm me një sy. U ndjemë të kënaqur në kthim, por njëkohësisht nuk mungonte frika dhe ankthi nga vëzhgimi i ndonjë *syri të keq*...e kujtojmë me nostalgji dhe humor njëkohësisht këtë ngjarje, kur komunikojmë me miqtë tanë që tani ndodhen larg, por këto kujtime mbeten të pranishme në bisedat tona.

Vinim me motrën shpesh te Muzeu Mesjetar, për të takuar mikeshën tonë shumë të dashur Tatianën, besimtare po aq sa ne, që restauronte me shumë dashuri dhe kujdes ikonat mesjetare; më vonë, me po atë përkushtim, Tatiana do ta drejtonte atë Institucion që e donte shumë. Vizitonim sallën e ikonave, ku një nga lutjet tona në fshehtësi ishte që Zoti të hapte dyert e kishave për ne dhe për të gjithë besimtarët, gjë që nuk vonoi të realizohej.

Dyert u hapën për të gjithë besimtarët, dhe jo vetëm. Lejimi i besimit, mbi gjithçka, ishte një faktor që e lehtësoi dhe e ndryshoi disi mënyrën e jetesës së shqiptarëve, që diktatura e kishte egërsuar së tepërmi.

Ishin kohë të trishta, veçanërisht në ngjarje që shoqëroheshin me viktima të asaj kohe, që i duheshin regjimit për të ngjallur frikë dhe terror në pjesën më të madhe të popullatës. Njerëzit nuk duhej të guxonin të mendonin, dhe jo më të flisnin për pakënaqësitë ndaj regjimit.

Ishte koha e tabuve, kur flitej fshehur ose nuk flitej aspak për seks, kur nuk dihej, të paktën nga ne të rinjtë, se çfarë ishte seksi dhe homoseksualiteti. Ndërkohë, në botën perëndimore kishte filluar të ndihej tjetër frymë rreth këtyre çështjeve. Kishte qëndrim ndryshe ndaj artit, muzikës, letërsisë, dhe çështjeve të tjera të padëgjuara më parë...kurse tek ne, informacioni rreth seksit konsiderohej tabu, jo vetëm në institucionet e edukimit, por edhe në familje dhe mjediset shoqërore.

Midis shoqesh të afërta mund të diskutonim ndonjë libër, si Frojdin, që ndalohej të qarkullonte, por falë disa përkthimeve në shqip që qarkullonin fshehur, thyenim kuriozitetin rreth teorive të tij të guximshme për kohën.

Sipas moralit të kohës, shumica e moshatarëve tanë duhej të përqendrohej vetëm tek shkolla, gjë që na linte të kuptonim se lidhjet intime do t'i takonin kohës kur të kishim mbaruar detyrat me edukimin. Marrëdhëniet me djemtë e klasës dhe më gjerë ishin në përgjithësi miqësore, ndërsa lidhjet erotike midis vajzave dhe djemve ishin të rralla në shkollën e mesme dhe si të tilla trajtoheshin si të veçanta apo dhe "të pamoralshme". Ishte kjo arsyeja që edhe kur ekzistonin *lidhje serioze*, mbaheshin të fshehta, sepse ndryshe do të paragjykoheshin nga opinioni, nga rrethi shoqëror dhe familja, deri sa të merrnin formën ligjore.

Sigurisht që sot këto kujtime ngjajnë si skena humori, ndërkohë që trajtimi i çështjes së seksit, apo homoseksualitetit, është kthyer në çështje tepër të diskutueshme, deri edhe ndasish politike. Por ndalimi deri edhe me ligj i ngjarjeve të *pa moralshme* erotike të kohës, (sot janë ato që trumbetohen të mbrohen me ligj), nuk do të thotë se ndryshonin instinktet njerëzore, përkundrazi i ndrydhnin në atë mënyrë sa kur shfaqeshin, tronditnin dhe çorodisnin opinionin shoqëror në masë.

Ka mbetur në kujtesë vizita në shtëpinë tonë, pas daljes nga burgu, e kushëririt të mamasë, Boriz Plumbi, pianisti i nderuar dhe shumë i respektuar i qytetit të Korçës, por edhe më gjerë. E para që i hapi derën e shtëpisë pas burgut, ishte gjyshja me vëllanë e mamasë, gjë që Borizi do ta kujtonte shpesh me mirënjohje gjatë gjithë kohës.

Dënimi nuk mbaronte me burgun, por vazhdonte edhe me *qëndrimin e detyruar* më pas të shoqërisë ndaj të dënuarit. Kur erdhi në shtëpinë tonë B. Plumbi, kujtoj që pyetëm prindërit, për kuriozitet, për arsyen përse kishte qenë në burg dhe na u desh pak kohë të kuptonim arsyen e vërtetë, sepse ishin biseda tabu për moralin e kohës. Më vonë do të kuptonim absurditetin e ligjit mbi homoseksualitetin, kurse figura e B. Plumbit do të lartësohej vetëm me ndryshimin e sistemit, sepse për kohën përfaqësonte njeriun e artit që sistemi nuk do ta falte në emër të *moralit*.

Të pakonceptueshme mbeten këto situata nga brezi i sotëm, që ndihet plotësisht i lirë të ketë martesë tradicionale, po aq sa dhe lidhje, partneritet, apo

bashkëjetesë të pakushtëzuar nga rrethanat dhe të padetyruar nga opinioni.

Ishte koha kur, me gjithë presionin e gjithanshëm të diktaturës që na rrethonte, në rrethin tonë më të ngushtë guxonim të flisnim për kufizimet që kushtëzonin qëndrimin ndaj letërsisë, muzikës, artit... mbi padrejtësitë e kohës, injorancën e njerëzve në krye të sistemit, izolimin e gjithanshëm, ndalimin e të drejtës së besimit fetar e të tjera si këto. Aq e pranishme do të ishte frika e censurës, sa ndonjëherë krijohej dhe ndonjë situatë komike, nga frika që kishte pllakosur njerëzit. Ndodhi një herë, kur ishim me shoqet e motrës gjimnaziste duke dëgjuar disqe të muzikës klasike në gramafon dhe ndërkohë po flisnim rreth gramafonit, pa censurë, si midis shoqesh të besuara. Në fund, kujtohet njëra nga shoqet, me fantazi pak më tepër se të tjerat, dhe hedh dyshimin se nëse mund të kishte ndonjë incizues në gramafon, ç'mund të ndodhte? Fantazia shkoi deri aty sa i luten babait të Brunës, shoqes ku ndodheshim, të çmontonte gramafonin, deri sa u bindën që nuk kishte pasur incizues. Kështu u mbyll komedia e ditës, ndërsa ai i këshilloi që të mos harronin këshillën e kohës, se *edhe muri kishte veshë*. Janë kujtime që bëjnë pjesë në *nostalgjinë* për atë kohë, duke iu shtuar nostalgjisë së ëndrrave fëmijërore, rinore, nostalgjisë për ngjarjet e bukura familjare, për njerëzit e mirë dhe të dashur që na rrethonin me mirësi dhe dashuri.

Babai, si gjithmonë i vëmendshëm, na këshillonte të ishim të kujdesshme në sjelljen tonë, veçanërisht në ngjarje që lidheshin me *politikën* në vend dhe ne nuk duhej të dallonim nga të tjerët. Nuk harroj ditën kur

do të shkonim të votonim dhe babai na zgjoi herët në mëngjes, sepse dihej që do të përgjoheshin njerëzit që do të shkonin me vonesë. Porosia e Partisë ishte të votohej sa më herët, në mënyrë që të shpallej sa më shpejt rezultati i shumëpritur i votimeve, si zakonisht, *99.9%,* për të vetmit kandidatë të shpallur paraprakisht.

U ngrita sipas porosisë së babait, për të bërë atë që do të bënin të gjithë, por nuk mund të harroj momentin kur pashë që radhën e gjatë e kryesonte *familja e deklasuar*, por e dashur dhe e respektuar e mëhallës, me djalin që sapo kishte dalë nga burgu. Pas tyre qëndronte gruaja e piktorit të burgosur V. Tushi, mësuese dhe qytetare e respektuar në Korçë. Ndërkohë, qendra e votimit ende nuk ishte hapur dhe radha vazhdonte të shtohej, por të gjithë e dinin që nuk do të vonoheshin. Sapo qendra të hapej, sipas porosisë së Partisë, votimi do të bëhej direkt, me fletën në dorë, pa hyrë në kabinë dhe kështu të gjithë kandidatët ndiheshin të zgjedhur që para se të zgjidheshin...ndërkohë njerëzit ishin të *lumtur* që kishin zgjedhur *përfaqësuesit e duhur*.

- Jeni të lumtur që nuk e dini sa të varfër jeni - ishte shprehja e *guximshme* e një të huaji nga SHBA, mysafir në një familje korçare, shprehje që nuk vonoi të qarkullonte nëpër Korçë.

Nuk dinim sa të varfër ishim, por kjo nuk na pengonte të ëndërronim botën e panjohur përtej kufijve, të cilën përpiqeshim ta shihnim nga të vetmet dritare, librat e ndaluar, si edhe në kanalet e huaja në radio apo televizion, kur mundeshim t'i realizonim. Vështirësia ishte në faktin që në vitet '70 televizorët ishin shumë të pakët. Ata i kishin vetëm familjet që kishin mundësinë

të siguronin një autorizim për blerje televizori, ose familjet që kishin mundësi t'i gjenin nga jashtë vendit. Por përveç kënaqësisë së televizorit, këto familje kishin edhe *kënaqësinë* të prisnin çdo natë mysafirë për të parë në Tv, në mungesë të televizorëve në shtëpitë e tyre.

Shkoja shpesh të flija te motra e mamasë Meropi (teta Opi), shumë e dashur dhe gjithmonë pranë nesh, për më tepër që vetë nuk kishte fëmijë; por kënaqësia shtohej kur do të më çonte te miqtë e saj që ndodheshin shumë pranë, që na prisnin me dashuri kur i vizitonim dhe njëkohësisht kishim mundësinë të shihnim ndonjë emision të veçantë në Tv.

Nuk përjashtoheshin skenat komike, në rastet kur në shtëpitë me televizor dhomat do të ktheheshin në salla, ku mysafirët rrinin ku të mundnin dhe si të mundnin, në pritje të spektaklit të ditës. Qarkulloi një ditë lajmi që një kanal i huaj televiziv do të shfaqte një film me aktor kryesorë *Marlon Brando, dhe Romy Schneider,* "Tangoja e fundit në Paris", shumë i dëgjuar për *degjenerim* në ato vite. Konsiderohej turp për arsye të skenave erotike që mund të shfaqeshin, nëse filmi do të shihej nga çiftet së bashku, që në fakt ishin miq mes tyre. Si do të zgjidhej kjo çështje e vështirë për të dyja palët? Pasi u debatua mirë çështja, u vendos që burrat ta shihnin filmin në një nga shtëpitë me televizor dhe gratë në një tjetër. Por nuk mbaronte këtu çështja, pasi njëra shtëpi kishte televizor me ngjyra dhe tjetra pa ngjyra. Dihej që si gjithmonë do të fitonin burrat, të cilët shkuan e panë me ngjyra filmin, kurse *gratë e varfra* pa ngjyra. Megjithatë, gratë u ndjenë të kënaqura që, megjithëse në fshehtësi, ishin të lira të shihnin filmin,

të flisnin dhe të bënin humor lirshëm si të donin, pa praninë e burrave dhe kështu përfundoi *komedia e filmit të famshëm, por të ndaluar për kohën*.

Pavarësisht situatave të vështira nga më të ndryshmet e asaj epoke, ishte rinia me bukurinë dhe hijeshinë e moshës që bënte të harroheshin shpejt të këqijat dhe të shijohej ajo pjesë që natyra nuk ia ka kursyer qenies njerëzore për të shijuar anët e bukura të jetës, kënaqësitë e pamohueshme të moshës.

Nuk mjaftonte lodhja që ndienim pas ndonjë marshimi që na kishte mpirë këmbët, por të frymëzuar nga *parrulla absurde në një dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën*, do të bënim edhe foto për kujtim, të rreshtuara me uniformën ushtarake; më pas do të qeshnim në hilaritet me shokët tanë Vangjushin, Mondin, Pavllon, Tomin, Ilirjanin, që ishin të pranishëm në shoqërinë tonë me humorin e tyre dhe dita mbyllej bukur, kur në shoqërimin e kitarës këndonim serenatat korçare.. kështu ishim gati *për stërvitjen* që na priste të nesërmen.

Mundësitë e argëtimit ishin të pakta, por kishim praninë e njerëzve që donim, kurse mungesat materiale kishin edhe anën pozitive, që na bënin të vrisnim mendjen për të gjetur mundësi të reja të kalimit të kohës së lirë.

- Sa mirë ua mbushnim mendjen prindërve, pasi u luteshim, që të na plotësonin dëshirën për të kaluar së bashku ditët e pushimit në shtëpitë e njëra-tjetrës - më thotë një ditë Anita, që vazhdonte mësimet në shkollën e muzikës, sot mësuese pianoje e realizuar. U njohëm rastësisht me Anitën, por shoqëria jonë do të vazhdonte në vite.

Me shoqet dhe shokët e klasës kishim të përbashkët humorin, kënaqësitë e moshës, por edhe përkushtimin ndaj mësimeve, pjesëmarrjen në konkurse, olimpiada, e të tjera veprimtari të kohës, sepse ishim nxënës të mirë në mësime, por edhe të miredukuar.

I paharruar ka mbetur konkursi i anatomisë. Grupi ku bëja pjesë fitoi çmimin e dytë në Republikë, me diferencë gjysmë pike me çmimin e parë. (me gjysmë pike vlerësoheshin pyetjet rrufe, siç quheshin ato që merrnin përgjigje të shkurta Po ose Jo dhe isha caktuar unë për përgjigje). Ishte hera e parë që jemi përballur zyrtarisht me padrejtësinë, së bashku me anëtarët e tjerë të grupit. Në Korçë fituam çmimin e parë në një konkurs interesant që drejtohej nga profesori i nderuar N. Face dhe më pas vazhduam konkurrimin me grupet nga qytetet e tjera të vendit, deri sa arritëm në finale me grupin e qytetit të Elbasanit. Skuadra që do të fitonte do të merrte Çmimin e Parë në Republikë.

Nuk kishte ndodhur ndonjëherë në historinë e atij konkursi, që zhvillohej çdo vit në atë kohë, që të vazhdonte tri orë e gjysmë, nga dy orë të mundshme, dhe të humbitnim padrejtësisht me diferencë gjysmë pike, pas një barazimi të gjatë. Mënyra si u veprua shfaqi hapur prirjen e jurisë që duhej të fitonte skuadra e Elbasanit. Pra, ishte padrejtësi dhe u konceptua si e tillë nga të gjithë të pranishmit, nga drejtoria e shkollës, por edhe nga Seksioni i Arsimit të Rrethit Korçë. Arsyeja? Kryetari i jurisë, profesor dhe mjek nga Tirana, (sikurse na u tha prej më të rriturve), kishte mik dhe ndante dhomën e hotelit në Korçë, gjatë kohës së konkursit, me personin që shoqëronte grupin e Elbasanit. Nuk arrinim

të konceptonim një padrejtësi të tillë. Të gjithë u ndjenë të indinjuar, deri sa u vendos nga drejtoria e shkollës dhe Seksioni i Arsimit të qytetit, që unë si kryetare e grupit, së bashku me mësuese Marianën, të sqaronim situatën për padrejtësinë tek organizatorët në Tiranë.

Kujtoj që drejtori i institucionit përgjegjës që takuam kuptoi diçka rreth padrejtësisë që kishte ndodhur dhe përgjigjja e tij ishte që nuk mund ta kthenin konkursin, ndërkohë që ne shpresonim të ribëhej konkursi.

Përse na dërguan në Tiranë, këtë nuk e kuptova mirë, përveçse tani që mendoj se e meritonim një vizitë në kryeqytet, së bashku me mësuese Marianën e dashur dhe tepër komunikuese që kaluam shumë bukur. Ky ishte edhe fundi i atij konkursi që e shijuam fillimisht me shumë punë dhe përkushtim. Së fundi, ngeli një një kujtim i paharruar; ishte vizita ime e parë në Tiranën e bukur, të hijshme, të pastër dhe të qetë të atyre viteve, konkurruese në atë kohë me kryeqytetet europiane për nga arkitetktura, gjelbërimi, pastërtia e ajrit dhe ajo akustike. Ngeli një kujtim i gdhendur në memorie së bashku me fotot te monumenti i Skënderbeut, që do t'ia tregonim grupit në kthim, pa përjashtuar zhgënjimin tonë mbi *padrejtësinë e më të mëdhenjve ndaj më të vegjëlve*. Megjithatë, ka qenë një nga mbresat që do të mbushte kohën tonë me pak mundësi argëtimi për moshën. Në realitet ishin këto mungesa që na shtynin drejt gjetjes së mundësive të reja të kalimit të kohës së lirë. Nuk na trembte as dëbora dhe as i ftohti acar i Korçës, t'i ngjiteshim malit të Moravës, apo të çanim dëborën e fshatit të bukur piktoresk të Voskopojës apo të Dardhës. Sa herë kam përpara ndonjë pjatë me kërmij, kujtoj

shijen e kërmijve që na gatoi gjyshja e dashur e shoqes së afërt të shkollës, Natashës, në shtëpinë e saj në Dardhë, (ku rrinte së bashku me motrën e gjyshes së shoqes tjetër, Dianës). Për mua, shija e asaj pjate nuk mund të krahasohet me asnjë pjatë restoranti. I paharruar do të më mbetej në kujtesë edhe portreti i atyre gjysheve të dashura që mishëronin tiparet tipike të grave dardhare në pamje dhe në sjellje, tipare që shoqet e mia Natasha dhe Diana i trashëgonin më së miri.

Përveç ekskursioneve në natyrë, mbrëmjet e vallëzimit mbeteshin argëtimi më liberal për kohën, pa përjashtuar momentet që ktheheshin në skena humoristike, kur, sapo fillonte muzika, djemtë turreshin kush të kapte i pari vajzën që donte për vallëzim me shprehjen "Ka mundësi"?

Vetëm një herë ftesën për vallëzim ndaj një djali e kam bërë unë. Ishte një i ri suedez, Anderson quhej, anëtar i një delegacioni të rinjsh suedezë, përfaqësues të partisë marksiste, që kishin ardhur të vizitonin vendin tonë. Kishin ardhur të shihnin nga afër *jetën e lumtur* të rinisë në *Shqipërinë socialiste* dhe një nga aspektet e lumturisë ishin edhe mbrëmjet e vallëzimit. Ishim disa të rinj të përzgjedhur për të marrë pjesë së bashku me mësuesit, të përkujdesur veçanërisht për këtë mbrëmje, që e bënte më të veçantë pjesëmarrja e delegacionit të huaj.

Fillon orkestra të luajë, për të çelur mbrëmjen e vallëzimit dhe drejtori i shkollës drejtohet tek unë duke më thënë që, në shenjë nderimi dhe respekti, të shkoja unë të ftoja në vallëzim të riun nga Suedia. Ngela paksa e çuditur *pse m'u drejtua mua*, sepse në

sallën e vallëzimit kishte edhe shumë vajza të tjera më të rritura se unë, (unë isha në vit të dytë gjimnaz). E zbatova këshillën e tij dhe u drejtova tek i huaji simpatik për ta ftuar në vallëzim. Nuk mund të komunikonim, sepse unë në atë kohë dija vetëm rusishten e mësuar në shkollë, kështu vetëm vallëzuam sipas tingujve të muzikës. Ishte mbresëlënëse lirshmëria e tij në të kërcyer, gjë që ne na mungonte përveç gjuhës..më pas filluam të komunikonim me shenja, duke qeshur herë pas here por nuk zgjati shumë, se orkestra ndaloi bashkë me keqardhjen që na duhej të ndaheshim dhe nuk do të përsëriteshin më ato çaste kënaqësie..

Kufizimet do të shfaqeshin kudo dhe kurdoherë, deri në rregullat strikte të veshjes dhe paraqitjes së jashtme, por kjo nuk na pengonte të gjenim mënyrën e një veshjeje të hijshme brenda kornizave të kohës. Zgjidhnim vetë copat dhe rrobaqepëset personale ku i qepnim, që ishin duararta, ishin stiliste të vërteta për kohën. Mjaftonte një copë e vogël katalogu e mezigjetur, për ta bërë të bukur si origjinal. Veçantia dhe thjeshtësia ishin pikërisht ato që shtonin bukurinë dhe hijeshinë e veshjes sonë në atë kohë, sipas zgjedhjes që do të bënim me rrobaqepëset personale.

Duhej treguar kujdes, sepse kush do të guxonte të dilte jashtë modeleve standarde të veshjes që detyronte sistemi, do të thoshte të përfundonte në tabelën e fletërrufeve, në qendër të qytetit, ku do të vihej në lojë me të gjitha mënyrat, deri në karikaturë (bullizmi i regjimit).

Ndalohej dëgjimi i muzikës në kanalet e huaja të radios dhe më pas të Tv, por mësuesit tanë nuk arrinin

të kuptonin nxitimin tonë, që të arrinim në shtëpi para orës një të drekës për të dëgjuar *hit parade*, që transmetohej në një nga kanalet e Radios Italiane me këngëtarët më në zë të kohës.

Kështu kalonin ditët e *asaj kohe*, të mbushura nga një anë me ankthin, frikën, censurën dhe terrorin që na ndiqte ngado, por edhe me kënaqësitë dhe shpresën që do të vinte një ditë që do të ndryshonte gjithçka.

Shpresonim të mbaronte lufta e ftohtë, që fatkeqësisht na kishte brendapërfshirë në kampin socialist. Dinim që kishim bashkëvuajtës të gjithë popujt e Lindjes, pjesë e këtij kampi, por më vonë do të kuptonim që ishim më fatkeqët, sepse diktatura jonë ishte më e egra dhe ne ndiheshim më të izoluar se të tjerët.

Realiteti i mungesës së ushqimeve dhe gjithçkaje të nevojshme, dhe vështirësitë e gjithanshme që po kalonte sistemi, na linin të kuptonim se ndryshimi do të ishte i pashmangshëm. Ndryshimet filluan të ndiheshin kur shihnim të hynin në treg edhe mallrat e huaja dhe gëzimi ishte i pamasë kur arrinim të siguronim me shumë vështirësi atë që kërkonim.

Miku dhe vetëm miku ishte rrugëzgjidhja për çdo gjë të munguar dhe fati na kishte ndihmuar në familjen tonë me burrin e motrës, e kudo dhe kurdo gjendur. Përveç mundësive falë miqësive të shumta, Kiu kishte përkushtimin që nuk ngurronte të na siguronte brenda mundësive çdo gjë të munguar në treg, por që gjendeshin për miq në magazina të veçanta *për njerëz të veçantë* si pjesë e realitetit të kohës.

Kënaqësi e paparë ishte magnetofoni *Philips*, i siguruar pas shumë përpjekjeve...por nuk mbaronte

këtu historia, sepse duheshin gjetur kaseta, që në atë kohë sapo kishin filluar të hynin dhe përveç se ishin shumë të shtrenjta, gjendeshin vetëm me mik.

- Sa kaseta do të blesh me këtë rrogë? - më pyeste ditën kur merrja rrogën, ish-kolegu dhe bashkëpunëtori im i respektuar ing. S. Plasa, që dallohej për humorin e tij të hollë.

- Mos e ngri zërin - i thosha unë në vazhdim të humorit, - se na dëgjon Myfiti" (komunisti, por dhe informatori i drejtorit).

Kënaqësia vazhdonte me mbledhjen e shoqërisë që vinin në shtëpi për të dëgjuar kasetat e incizuara me këngët e *E. Piaf, Ch. Aznavour, M. Matieu, T. Jones, E. Prestly, M. Jakson, W. Huston, Beatles, J. Iglesias* e të tjerë të parapëlqyer të kohës.

E kujtojmë shpesh me Belën atë kohë, kur nuk do të mungonte të kthehej për të dëgjuar këngën e saj të pëlqyer, edhe kur i duhej të nxitonte pas ndonjë pazari të ditës.

- Sa shumë kënaqeshim, - kujtojnë atë kohë kushërinjtë më të vegjël, Kosta, Leonardi, Kristofori, me të cilët ndanim momente të veçanta kënaqësie, kur vinin dhe prisnin të hapej magnetofoni...kurse ne, shkonim në shtëpinë e tyre që ishte dhe shtëpia e gjyshes së dashur, të shihnim në televizor.

Vëllai i mamasë, Ylli, kishte siguruar nga puna Autorizimin e blerjes së televizorit, që fillimisht u jepeshin anëtarëve të Partisë së Punës, por nuk kishte lekët e mjaftueshme; kurse ne nuk na mungonin lekët, por na mungonte kryesorja, letra e Autorizimit për ta blerë...çështja u zgjidh shpejt midis motrës dhe vëllait,

sepse mamaja i dha lekët vëllait dhe ne shkonim te gjyshja që shihnim Tv, kur kishte emisione interesante. Ne do ta siguronim më vonë, kur mamaja doli në pension, që, si shpërblim me rastin e daljes në pension, i dhanë *Autorizim* për të blerë televizor dhe ky ishte gëzim i madh për ne, ndërkohë që mamaja ndihej paksa e pezmatuar për shkëputjen nga puna.

Me kalimin e kohës prodhimi i televizorëve po shtohej, por njëkohësisht po shtoheshin edhe barrierat për të mos parë kanalet e huaja, kur kontakti me televizorin po bëhej masiv. U vendosën të ashtuquajturit zhurmues, që pengonin hyrjen e kanaleve të huaja televizive, por gjithashtu nxisnin njerëzit të bëheshin *novatorë të kohës*, duke shpikur truke të ndryshme deri sa arrinin *të çanin rrethimin*.

Një ditë, një miku i babait hipi në çatinë e shtëpisë për të rregulluar antenën, që të mos dukej nga rruga, pasi ishte njoftuar që një komision nga lagjja do të dilte nëpër rrugë për të parë drejtimin e antenave, nëse ishin në drejtim të Maqedonisë. I vetmi kanal i huaj televiziv që shihej në atë kohë në Korçë ishte Shkupi dhe urdhri i Partisë ishte të mos shihej, me gjithë zhurmuesit që nuk mungonin. Detyra e mikut në çati ishte që ta bënte të padukshme antenën nga rruga, por gjithmonë në atë drejtim që të vazhdonim të shihnim Shkupin. Babai shoqëronte mikun, kurse detyra ime ishte të rrija para televizorit për të parë kur do të shfaqej në ekran kanali i Shkupit, pasi do të lëvizej antena. Prisja me ankth deri sa më në fund, duke nxjerrë kokën nga dritarja, thirra me të madhe: “Doliii, mos e lëviz mëë!”. Me kokën lart nga çatia, ndesh me fytyrën e babait me gishtin

tregues te goja. E kuptova, kisha bërtitur shumë; më ngeli buzëqeshja në buzë, por e rëndësishme ishte që filluam të shihnim kanalin e Shkupit, aq shumë sa po mësonim edhe gjuhën maqedonase. Përkthimin e saj si gjuhë sllave, na e lehtësonte gjuha ruse që mësonim në shkollë dhe kishim filluar t'i ngatërronim të dyja. Më shumë e ndiente këtë shqetësim shoqja ime Natasha, e cila si shumë e apasionuar pas Tv Shkupit, më ankohej shpesh që po ngatërronte gjuhët.

E shihnim aq shumë atë kanal Tv, sa nuk i ngelej kohë babait të shihte lajmet te Tirana Tv. Më së fundi u bë një *pakt familjar*, që në orën tetë të darkës do të shiheshin patjetër lajmet në Tirana Tv. Shkak u bë lajmi që ishte dhënë natën e kaluar për vdekjen e ish-kryeministrit (më vonë do të deklarohej vetëvrasje), por babai nuk e dinte, sepse ai nuk i kishte parë lajmet në Tv dhe ishte ndier shumë keq para shokëve të nesërmen, kur të gjithë e dinin lajmin përveç babait. Unë gjithashtu e dëgjova lajmin kur shkova në ndërmarrje, por nuk u ndjeva keq, sepse edhe Tatiana, shoqja e punës që më dha lajmin, aty e kishte dëgjuar. Që atë ditë, sipas *marrëveshjes sonë*, në orën tetë të mbrëmjes do të shiheshin lajmet e ditës.

Në realitet ishte koha që kjo ngjarje do të pasohej nga shumë ngjarje të tjera politike dhe nëse nuk ishe i informuar rreth këtyre ngjarjeve, do të shiheshe si i dyshimtë në orën e informacionit politik që zhvillohej në zyrat e ndërmarrjes çdo të hënë në orën shtatë të mëngjesit.

Përveç Tv, librat ishin pjesa tjetër që na lidhnin *me botën e përtej kufijve*. Shkëmbenim në fshehtësi mes

shoqesh ndonjë libër që konsiderohej si jo i përshtatshëm për kohën dhe që nuk qarkullonte as në librari dhe as në Bibliotekën e qytetit. Arrinim t'i gjenim këto libra edhe falë miqësisë me bibliotekaren e mirënjohur të Bibliotekës së Korçës, zonjën K. Mitrushi, e cila me xhentilesën që e karakterizonte na ofronte edhe libra që nuk kishim mundësi t'i gjenim në gjendje të lirë. Përveç shkrimtarëve të mëdhenj francezë të lejuar për t'u lexuar, lexonim *S. Beauvoir, J. P. Sartre, A. Camus, Ch. Baudelaire, G. Maupassant, G. Apollinaire* etj., që nuk qarkullonin lirisht.

Kujtojmë shpesh me Marjetën, shoqen e fëmijërisë dhe në vazhdimësi, librat që na huazonte pa hezitim Klara, midis të cilave përkthimet e veta të poezive nga Baudelaire, që na i jepte t'i lexonim për kënaqësi. *E humbura në pyje* do të më quante Klara sa herë që takoheshim në Bibliotekë dhe unë e prisja me kënaqësi të më thërriste ashtu, sepse tingëllonte bukur nga mënyra si ajo shprehej.

Nuk munda të lexoj volumin e dytë të romanit "Doni i Qetë" të M. Shollohov, pasi kisha lexuar të parin, nga biblioteka e vëllait të mamasë, sepse kur shkova të merrja të dytin, nuk e gjeta në bibliotekë, gjë që sa më trishtoi edhe më çuditi. Më vonë do të më sqaronte kushëriri Kosta që, me shumë keqardhje, xhaxhai e kishte hequr nga biblioteka, pasi në mbledhjen e organizatës së Partisë u ishte dhënë lista e librave të ndaluar dhe ishte i detyruar të zbatonte porosinë.

Fillimisht nuk e kuptova pse duhej të ndalohej ai libër që ngjante shumë me "Lufta dhe Paqja" e Tolstoit që qarkullonte lirisht. Mendova se ishte *konsideruar i*

tepruar përshkrimi i skenave të dashurisë së të rinjve, që ishte dhe një nga më të bukurat e atij libri, por më vonë do kuptoja se çështja qëndronte *tek autori* më tepër se tek libri i tij.

Ndoshta ishin barrierat që na shtonin më shumë kuriozitetin për të lexuar më tepër librat e ndaluar dhe jo vetëm kaq, por gjetja, leximi dhe më pas diskutimi i tyre, përbënte një kënaqësi të spikatur për kohën e lirë.

Do ta lexoja fshehur dhe në kohë rekord romanin "Krim dhe Ndëshkim" të Dostojevskit, duke marrë kohë nga pushimet në plazh, për ta kthyer në kohë, sepse, si libër i ndaluar, mjaftonte një *sy i keq* që të mos e lexoja lirshëm në mes të njerëzve në plazh. Më pas dorëzoja librin në kohë te Klara, e cila si gjithmonë do të ishte përsëri e gatshme, kur të vija t'ia kërkoja po atë libër për t'ia dhënë dikujt tjetër...kështu qarkullonin librat mes miqsh, edhe pse të ndaluar për t'u lexuar.

Këto kujtime vijnë shpesh sa herë shoh sot të shiten libra nga më të ndryshmit, jo vetëm në librari, por t'i zë syri ngado, në pika shitjeje buzë trotuareve, edhe pse mungon ai interes dhe etja e brezit të kohës sonë për t'i lexuar.

Është kjo një arsye më shumë që këto kujtime të mbeten të paharruara dhe të sillen sot me keqardhje kur shohim të rinj edhe fëmijë indiferentë ndaj librave dhe të ngulur para ekraneve të të gjitha llojeve, gjë që është kthyer në shqetësim dhe makth për ata prindër që e kuptojnë efektin negativ të tyre.

Nuk e di deri kur Hygo, nipi ynë fantastik, që na ka lumturuar me ardhjen e tij në jetë, do t'i bindet t'et për të qëndruar larg tabletave dhe ekraneve, sepse ndikimet e

jashtme mbeten të pashmangshme. Dua të besoj që me gjithë sfidën e Teknologjisë, Libri do të mbetet parësor në vazhdimësi.

FILMI

Ekrani i vetëm i fëmijërisë dhe adoleshencës sonë ishin filmat e huaj në kinemanë e qytetit, kryesisht ata me temë historike *pa ndikim ideologjik të kohës*, që bëheshin akoma më të pëlqyer kur interpretonin artistët e njohur të kohës, si B. Bardo, J. Mare, G. Filip, Xh. Lolobrixhida, S. Loren, M. Brando, A. Delon etj. Ishin filma që priteshin me padurim, qysh prej njoftimit të para dy javëve, që do të dilnin te kinema "Morava" e qytetit të Korçës.

Mbresat në memorien e brezave shprehin vlerat e tyre jo vetëm për atë kohë, sepse vlerat e tyre nuk qëndronin vetëm tek aktorët e famshëm, por edhe te mesazhet që ato jepnin.

Kënaqësia më e madhe ishte kur siguroheshin biletat që ditën e parë të filmit, por kur filmi na pëlqente shumë, mund të shkonim edhe dy herë për ta parë. Të paharruara kanë ngelur netët verore, kur shkonim te Doli, mikja jonë e hershme, që na priste me kënaqësi për të parë për herë të dytë nga dritarja e dhomës së saj filmin e parapëlqyer (apartamenti i Dolit ishte ngjitur me Kinemanë erore).

Pandi këndezka, e thërrisnin fëmijët personin që transportonte kutitë e rënda me materialet e filmave të radhës që do të shfaqeshin te kinema Morava dhe ishte bërë personazh i njohur me të cilin argëtoheshin fëmijët, por dhe adoleshentët, kur ai u kthehej t'i shante. Kalonte shpesh në rrugën para shtëpisë sonë, (vetëm

një rrugë e ndante nga pastiçeri "Moska" që ndodhej përballë kinema "Moravës") dhe e kujtoj me keqardhje atë njeri, që veç peshës së kutive mbante dhe sikletin e talljeve të njerëzve (bullizmi ka ekzistuar në çdo kohë).

Personazh tjetër i njohur lidhur me kinemanë ishte personi që bënte të mundur transmetimin e filmit, të cilit i thërrisnin nga salla me zë të lartë *Çomeeee, mos e hiq*…! Kjo ndodhte shpesh në momentin kur në film shfaqej ndonjë pamje erotike, që më e shumta mund të ishte puthje normale të dashuruarish, por që për kohën konsiderohej si *shfaqje degjenerimi,* nëse do të zgjaste pak më tepër. Kështu ngrinte kënaqësia posa fillonte të ndjehej në pritshmërinë e spektatorëve që ishin mësuar me kufizimin e skenave të tilla që zgjasnin vetëm me momente, sepse pjesa tjetër do ishte hequr nga çensura e kohës...ishte çensura që kontrollonte gjithçka para se t'u servirej spektatorëve.

Personazhet e famshëm të Korçës ishin pjesë e pandarë e historive humoristike të korçarëve, që shpesh i ka sjellë me humor në fb, K. Stralla, ish-profesor i gjimnazit, që përveç informacioneve të vlerësuara ofron dhe kuriozitete të shumta për miqtë e *fb*.

Një nga filmat që u bë pjesë e kujtimeve të rinisë ishte filmi "Beteja për Romën", film historik interesant, ku personazhi *Julia* në film kishte një lloj ngjashmërie me mua. Lajmi mori dhenë si lajm i ditës në të gjithë qytetin e Korçës.

Thashethemet për mirë apo për keq, ishin pjesë e pandarë e jetës qytetare korçare, që shpesh nuk mund të kalonin pa shkaktuar shqetësime tek ata që i përjetonin. Për mua ishte e pakuptueshme pse duhej të isha në

vëmendjen e njerëzve, kudo ku gjendesha në qytet, për një gjë krejt normale të ngjashmërisë së rastësishme me një aktore filmi. Isha vetëm 13 vjeç dhe nuk arrija të kuptoja se ku qëndronte çudia në këtë rast, që unë të vihesha në siklet; për më tepër, kujtoja që kisha dëgjuar që çdo njeri e ka të ngjashmin e tij diku në botë.

Ka mbetur në kujtesë dhe jo vetëm për mua, momenti kur mbaroi seria e dytë e filmit ku personazhi Julia vdes, filmi mbaron dhe hapen dritat. Aktori i mirënjohur korçar Ll. Sërbo që u ndodh afër meje, u drejtohet spektatorëve të sallës me zë të lartë që ta dëgjonte e gjithë salla duke u drejtuar nga unë: "Mos u mërzitni, ja ku është Julia!" Mjaftonte kjo që njerëzit *e sapomallëngjyer* nga vdekja e Julias në film, të turreshin për të parë *Julian e gjallë*.

E frikësuar nga turma, mund të shpëtoja vetëm duke vrapuar në drejtim të shtëpisë, që për fat gjendej shumë afër kinema "Moravës"; ndihesha e trembur, por edhe e mbrojtur nga shoqet që më gjendeshin gjithmonë pranë. Ky ishte një nga momentet më komike, por që do të pasonte me të tjera jo aq komike sa dukeshin në fillim.

Isha në klasën e gjashtë të shkollës tetëvjeçare "Mësonjëtorja e Parë Shqipe". Pasi kishte dalë filmi, kur një ditë, duke hyrë në shkollë të rreshtuar, me shaminë e pionierit në qafë, shoh që mungonte fotografia ime në tabelën e të dalluarve në mësime. Duke menduar se kush mund ta kishte marrë fillimisht, më shkoi mendja te një djalë që më ngacmonte, po nuk mund të kuptoja si kishte arritur ta merrte atë fotografi, sepse nuk ishte as nxënës në atë shkollë. U shqetësova shumë kur dëgjova që fotografia po qarkullonte edhe te të tjerë. Hynte në djemtë imponues për t'i pranuar shoqërinë dhe më lodhi

deri sa më ktheu fotografinë. Kështu vendi në tabelë mbeti bosh nga frika që të mos përsëritej ngjarja, por në fakt pati edhe raste të tjera shqetësimesh paksa të çuditshme.

Një ditë, babai, duke kaluar pranë tabelës së të dalluarve në qendër të qytetit, dëgjon biseda rreth fotos sime me babanë, dhe duke qeshur sapo hyn në shtëpi thotë: "Po më quajnë dhe mua *babanë e Julias*". (*Ceteg* ishte emri i babait të Julias në film.) Mua ndërkohë po më thërrisnin me emrin *Julia*, aq sa një pjesë deri vonë e dinin sikur ky ishte emri im i vërtetë.

Ishin situata që përveç humorit kishin edhe shqetësimin, që nuk kaloi pa lënë mbresa dhe efekt në formimin dhe personalitetin tim. Nuk ishte e lehtë të kaloje në rrugë ku nuk mungonin njerëzit e ulur në gurët pranë portave të shtëpive dhe të ndieje që tërhiqje kureshtjen e tyre, të të gjitha moshave, veçanërisht të djemve, që më ndalnin në rrugë, duke më imponuar frikë dhe ankth gjatë kohës që do të gjendesha vetëm.

Pasojat u ndjenë shpejt në qëndrimin tim të impostuar me një seriozitet jo të zakonshëm për moshën, paksa e tërhequr në shoqëri, veçanërisht nga djemtë. Përveç shoqeve të mia, ndihesha mirë në shoqërinë e motrës, që më mbante gjithmonë pranë, aq sa më vonë shoqet e saj bëheshin edhe shoqet e mia, megjithëse më të mëdha se unë në moshë.

Nuk mund të harroj kur shoqja e dashur e motrës, pianiste e talentuar, R.Suxho, (Rozka e quanim shkurt), që ishte bërë shumë e dashur edhe për mua, vinte cdo mëngjez të më krihte flokët. Kishte kohë që nuk mungonte mëngjezeve para se të shkonin së bashku me

motrën në shkollë; por pas daljes së filmit vinte akoma më me kënaqësi dhe këmbëngulte, edhe kur unë i thosha të ndryshonim modelin e flokëve që të mos bezdisesha nga njerëzit. Ndihesha vërtet më e mbrojtur dhe më e sigurt në shoqërinë e motrës dhe shoqeve të saj, ndaj presionit të pakuptimtë dhe paradoksal të kohës.

Një ditë, mamaja ime e shqetësuar më thotë që një shoqe, djali i së cilës ishte bashkëmoshatar me mua në një shkollë, i kishte thënë se mua më konsideronin mendjemadhe, që nuk ofroja shoqëri me të tjerët. Edhe mua më ndodhte shpesh të ma thoshin këtë, shoqe apo shokë te rinj, kur ndryshonin opinion mbas njohjes. Kuptohet që kjo ndodhte për shkak të seriozitetit të detyruar dhe qëndrimit tim të tërhequr për të shmangur hyrjen time në *personazhet e njohura* të Korçës.

Kjo histori vazhdoi të kujtohej në vite, megjithëse kur filmi doli përsëri, ndryshova modelin e flokëve, për të mos u kujtuar njerëzve ngjashmërinë, por historia vazhdoi si më parë..

Një nga shoqet e afërta të kohës, Vera, e dashur dhe xhentile, që tani jeton në Zvicër, e kujtoi ngjarjen e filmit në *fb*, ku nxori dhe foton e aktores në faqen time të *fb*. Diskutimet rifilluan me komente, por tani kuptohet në tjetër sens, në atë të humorit, të veshur me nostalgji.

- *Sa palë këpucë kanë grisur* djemtë duke të ardhur prapa dhe *sa kanë lajthitur,* - më shkruan Vera, që nuk e ka harruar dialektin korçar edhe pse është larguar prej shumë vitesh nga Korça.

- *Këpucët dhe mendjen e tyre po, por jo mendjen time*- vazhdova unë - .. dhe kujtuam episode të asaj periudhe, sepse janë kujtime të tilla, që vetëm me humor mund të sillen tani.

Empatia dhe humori që karakterizonin Verën, do të më mungonin pas transferimit me familjen e saj në qytetin e Elbasanit, por nuk e dija që një ditë, do të largohej edhe vetë Vera.

Historia e Julias do të rikujtohej gjithashtu me humor kur të takoja në Francë Andreasin, shokun që tashmë është si vëllai i tim biri, Tedit. Ditën e dasmës së Tedit, Andreasi që do të ishte njëkohësisht dëshmitar i celebrimit të çiftit, hyn në dhomë, (hera e parë që takoheshim) duke bërtitur *Bonjour Juliaa...!* dhe vazhdon përshëndetjen në frëngjisht, duke më quajtur *mama* më pas dhe duke i lënë të shtangur të pranishmit me skenën e parapërgatitur për humor me Tedin. Kalova pak në kohë, por ishte kujtim i këndshëm, që më befasoi, sepse nuk e dija që Tedit t'i kishte lënë aq shumë mbresa historia e dëgjuar prej kohësh, sa ta ndante me shokun e ngushtë, të mirë dhe me sens të këndshëm humori.

ZHGËNJIMI

26 Gusht, dita e daljes së të drejtave të studimit për maturën e vitit 1976. Nisur nga rezultatet e katër viteve të shkollës së mesme, me mesataren dhjetë, me besim të plotë që e kisha arritur qëllimin në vite me rezultatet e dëshiruara, nuk e vija në dyshim që do të më jepej mundësia e studimit në një degë të merituar.

Besimin ma përforconte Rregullorja e Ministrisë së Arsimit, që nxënësit me mesatare dhjetë të katër viteve të shkollës së mesme kishin të drejtën e propozimit për Medalje të Artë dhe të zgjedhjes së degës ku do të vazhdonin studimet.

Ishte natë, ora 22, kur u afishuan listat me emrat e maturantëve që u ishte dhënë e drejta e studimit, por lajmi u shpërnda në mënyrë të rrufeshme. Vesha shumë shpejt një fustan basme që m'u ndodh pranë, sepse ishte koha kur po bëheshim gati për të fjetur. Dola me flokët e lëshuar deri te mesi; zakonisht ato i mbaja të kapura me lidhëse, por nuk arrita t'i lidh nga shpejtësia. Duke vrapuar në mes të errësirës arrij te shkolla "Themistokli Gërmenji", ku ishin afishuar listat.

Edhe tani ndiej emocion. I paharruar momenti, kur Stefi, vëllai i shoqes së afërt, Dianës (komshinj me miqësi të ngushtë në vite), më thotë se më kishte dalë e drejta e studimit në degën agronomi, në IB në Korçë. Nuk e besova fillimisht, mendova që bënte shaka, por kjo më bëri që të drejtohesha drejt e te lista e Agronomisë, ku pashë emrin tim. Sesi u ndjeva më

pas, kjo më është fshirë nga kujtesa. Në moment m'u kujtua që pak ditë më parë, një e njohura jonë dhe njëkohësisht kushërira e ish drejtorit të gjimnazit P.Lako(njëkohësisht edhe kryetar i komisionit të të drejtave të studimit), më kish thënë duke qeshur se më kishte dalë e drejta e studimit në një *degë të bukur* që fillonte me "A". Nuk kishte arsye të mendoja për degën e Agronomisë në kushtet e mia dhe as nuk më shkoi mendja, por ndërkohë mendova degën e Arkitekturës, që atë vit nuk pati konkurs.

Në mes të turmës së nxënësve, atë natë takoj rastësisht nxënësin e vetëm me rezultate të njëjta me të miat, por nga shkolla tjetër e mesme, G. Joti. Edhe atij nuk i ishte dhënë mundësia e zgjedhjes së degës, por i kishte dalë e drejta e studimit në degën e matematikës në Universitetin e Shkencave të Natyrës në Tiranë. Si i pakënaqur që ndihej, më afrohet dhe më thotë: - Edhe unë si ti e pësova. - E ndërrojmë degën bashkë, - i them unë. Kuptohet që ai as mund ta mendonte ndërrimin. E kam takuar pas vitesh, të plotësuar më së miri në fushën e informatikës dhe më pas në atë të biznesit, ku matematika që ai studioi e ndihmoi më vonë në profilin e punës dhe në biznesin e suksesshëm.

I kam të turbullta më pas kujtimet si jam kthyer në shtëpi. Vetëm nuk harroj tetën, që me këmbën e dëmtuar, për shkak të një aksidenti, është hequr zvarrë në dysheme deri te krevati ku unë isha shtrirë. Me sytë drejtuar në tavan, i drejtohesha Zotit, se çfarë të keqe kisha bërë që të më jepej ai ndëshkim. E vetmja përgjigje ishte që nuk mund të ishte ndëshkim i Zotit, por i Djallit.

Djalli në këtë rast fshihej te Sistemi i padrejtë dhe i pamoralshëm, i personifikuar te kryetari i komisionit të të drejtave të studimit në atë kohë, njëkohësisht ish-drejtori i shkollës së mesme, P.L.

Dega agronomi në Institutin Bujqësor në Korçë, ishte shuplaka në fytyrë për besimin, përkushtimin dhe karakterin e shfaqur në vite, sepse në atë institut deri atëherë kishin shkuar në përgjithësi nxënësit me *probleme biografie* nga qyteti i Korçës dhe nxënës të dobët në mësime nga zona të thella.

Ishte e pabesueshme në fillim jo vetëm për mua, por edhe për opinionin në qytetin e Korçës, ku gjithçka merrej vesh dhe diskutohej shpejt. "Është bërë lajm i ditës e drejta jote e studimit, edhe në kafenetë e qytetit", do të më thoshte vëllai i mamasë, i shqetësuar për vendimin që do të merrja.

Nuk ishte i thjeshtë vendimi që do të pasohej nga një plejadë e gjatë e përpjekjeve dhe e betejës kundër padrejtësisë më mizore që e kam quajtur jo vetëm ndaj meje personalisht, por edhe ndaj disa të tjerëve që nuk fituan të drejtën e merituar.

Ishte momenti kur kuptova se ishte goditje e së keqes ndaj meritës, së drejtës, karakterit të mos bindjes ndaj së keqes dhe imoralitetit, që dukej se ishte më e fuqishme se unë. Ishte më e fuqishme se unë, sepse ata që kishin vendosur dënimin tim, ishin në pushtet, gjë që ishte e njohur tashmë, që njerëzit e pushtetit nuk kishin arritur në ato poste vetëm për aftësi dhe merita. Ata dinin më shumë se kushdo të godisnin aftësinë, inteligjencën dhe mbi të gjitha moralin...dinin të godisnin ata që mendonin ndryshe prej tyre.

Me gjithë zhgënjimin e madh, që m'u desh kohë të reflektoja se çfarë do të bëja në vazhdim, dy gjëra kisha të qarta në mendjen time: Në atë shkollë nuk do të vazhdoja kurrsesi studimet e larta dhe do të filloja të kërkoja të drejtën time të zgjedhjes së degës së studimit, gjë që përkonte me të drejtën legjitime që sistemi në fuqi e quante të pamohueshme.

Ishte zhgënjim për gjithçka kisha menduar dhe shpresuar deri në atë moment, përfshi zhgënjimin akoma më të madh ndaj drejtësisë së *Sistemit Socialist* që trumbetohej si tabu e padiskutueshme e epokës socialiste.

Gabimi im ishte që kisha besuar në vetvete, se nuk do të hakmerrej ndaj meje ish-drejtori i shkollës, kur e dija që ai do të ishte në komisionin që do të vendoste të drejtat e studimit. Ishte naivitet nga ana ime që mendoja se me qëndrimin tim i kisha imponuar respekt atij njeriu dhe jo hakmarrje, pavarësisht mosarritjes së qëllimit të tij imoral ndaj meje, nxënëse 17-vjeçare, në shkollën që ai drejtonte. Isha ndeshur edhe një herë tjetër para dy vjetësh, e ngacmuar nga një mësues i shkollës 8-vjeçare, që falë reagimit tim jo vetëm që nuk guxoi përsëri, por kisha kuptuar që më sillej më me respekt se më parë. Ishte kjo një arsye që mendova se do të ndodhte e njëjta gjë edhe me drejtorin në fjalë, por këtë herë isha gabuar.

Ndoshta të tilla ngjarje u kanë ndodhur në të gjitha kohërat dhe shumë vajzave, por për mua ishte tepër shqetësuese dhe e jashtëzakonshme për pasojën që solli, edhe pse kishin kaluar mbi dy vjet nga ajo ngjarje.

Ishte koha kur mbi gjithçka sundonte *ligji i hekurt i diktaturës* në dukje dhe këto sjellje ishin aq të

dënueshme sa as që përfytyrohej të ndodhnin ngjarje të tilla. Në fakt nuk dëgjohej të ndodhnin, sepse, ose vajzat heshtnin për nënshtrimin ndaj ngacmimit të tyre seksual, ose në rast të kundërt nuk flisnin nga turpi i viktimizimit. Ndërkohë, në kulisa dhe nga njerëz të pushtetshëm, ndodhnin gjëra të tilla që i dinin vetëm ata dhe bashkëpunëtorët apo viktimat e tyre. Por për njerëz të *rangjeve të larta* ishte e pakonceptueshme, që mund edhe të përballeshin me qëndrimin e duhur që ata meritonin, por vetëm me atë që mendonin se u takonte, si të pushtetshëm që ndiheshin.

Besimi në zbatimin e ligjit të kohës kundrejt *moralit*, kishte ndikuar tek unë që të mos merrej me mend as imoraliteti dhe as hakmarrja, por të shpresoja për pak respekt ndaj një qëndrimi dinjitoz; por njerëzit imoralë nuk e njohin respektin, dinjitetin, karakterin dhe këtë nuk mund ta dija, sepse kështu ishim edukuar ne dhe në atë moshë nuk mund të parashikonim që e keqja nuk kishte kufij.

Duhej reflektim i thellë për të përcaktuar sjelljen përballë një njeriu të veshur me pushtet, ndërkohë që duhej treguar e vërteta e historisë për të kërkuar edhe zgjidhjen e saj.

Në atë kohë, P ishte Sekretar i Parë i Rinisë së Rrethit Korçë. Fillimisht diskutimi u bë me prindërit, sepse me motrën, (dashurinë dhe këshilltaren time të përhershme, me të cilën diskutonim jo vetëm gjithçka të bukur që shijonim dhe na gëzonte, por edhe gjithçka që na privonte), e kishim diskutuar prej kohësh, që kur kishte ndodhur ngjarja. Kjo histori tashmë shihej si e largët dhe e përballuar më së miri nga ana ime, por nuk kisha parashikuar pasojat e mëvonshme.

Pasoja do të ishte jo vetëm për mua, por edhe për të tjerat si unë, që të kuptonin se nuk do të kishin të ardhme në qoftë se nuk do t'i nënshtroheshin *dëshirave të pushtetarit* nga i cili vareshin. Prindërit, pasi më dëgjuan, më miratuan me besim të plotë, për të treguar të vërtetën e historisë, sepse kishim të bënim me një hakmarrje të padrejtë.

Historia fillon në vitin e dytë të shkollës së mesme "Raqi Qirinxhi" në Korçë, atëherë kur unë dhe shoqet e mia më të afërta kuptuam vardisjen e drejtorit të shkollës, fillimisht nëpërmjet veprimeve të tij të çuditshme ndaj meje.

Hera e parë që u vu në dyshim sjellja e tij ishte një ditë të hënë, kur në një *shikim rreshtor* pa asnjë arsye, më nxjerr para shkollës, sepse pantallonat e mia kadife kishin ngjyrë të kuqërremtë.

Ishte viti 1974, koha e luftës kundër prirjeve të modernizmit, pas plenumit IV të KQ dhe çdo të hënë bëhej kontroll i të gjithë nxënësve *për mënyrën e veshjes dhe pamjen e jashtme të të rinjve*. Gjatë kontrollit shiheshin me kujdes sa të gjata ishin favoritet e çunave, gjithashtu veshjet dhe veçanërisht pantallonat, sa cm të gjera ishin te gjuri dhe sa në fund. Nëse ishin më të gjera në fund, quheshin *kauboj* dhe meritoje ndëshkim për modernizëm. Për fat, pantallonat e mia nuk ishin *kauboj*, por mbasi ishin kadife ngjyrë të kuqërremtë, sipas drejtorit quheshin moderne dhe duhej *të kritikohesha*.

Kjo ndodhte kur para pak kohe, në një fjalim që mbajti para shkollës, më kishte cilësuar si nxënëse të dalluar, kandidate për Medalje të Artë, meqenëse vitin e parë e kisha mbyllur me të gjitha notat dhjeta.

Më pas, ishte e diel kur ishim thirrur në aksion së bashku me klasat e tjera, për hapjen e një kanali kullues në fshat, siç ndodhte rëndom në atë kohë në fundjavë. Aksionet, ose si mund të quhen ndryshe *punë vullnetare e detyruar*, ishin pjesë e pandarë e jetës së shoqërisë shqiptare dhe zhvilloheshin zakonisht ditën e diel, që ishte e vetmja ditë pushimi e javës për të gjithë. Direktivat e Partisë ishin që njerëzit duhej të ishin të përfshirë në punë gjithë kohën, për *ndërtimin e socializmit*.

Në mes shoqesh, duke punuar me lopata në duar, rastësisht po qeshnim. Në këtë moment na sheh drejtori e na drejtohet duke na thënë se nuk punohet duke qeshur, prandaj ishim të përjashtuar si klasë nga aksioni.

Ditën e hënë, njoftohemi nëpërmjet mësuesit kujdestar G, që pasdite duhej të vinim me prindërit për të diskutuar sjelljen tonë të pahijshme në aksion. Ishte absurditet shkaku, prandaj u shqetësova, sepse si sekretare e klasës kisha edhe përgjegjësinë më të madhe në këtë rast dhe po ndieja që ishin presione të qëllimshme dhe të frikshme për sa po ndodhte. Fillon mbledhja, ku shumica nuk po kuptonte arsyen e vërtetë të mbledhjes, vetëm se u quajt shumë e rëndësishme, përderisa merrte pjesë përveç mësuesit kujdestar edhe drejtori.

Mbledhja hapet nga mësuesi kujdestar, i cili me tonin e tij tepër autoritar vë theksin në rëndësinë e mbledhjes, sepse në klasën tonë kishte pasur *shfaqje të huaja* (asnjë nuk kuptonte se cilat ishin konkretisht) dhe që duhej të bënim autokritikë. Më pas e merr fjalën

drejtori, i cili shprehu shqetësimin se ishte puna e dobët e organizatës së rinisë që ishte kjo situatë tepër shqetësuese. Konkretisht *organizata e rinisë e klasës kishte shfaqje intelektualiste, tepër të dëmshme për të rinjtë*. Folën disa prindër, që i kujtoj edhe sot si *tepër të devotshëm*, si anëtarë partie që ishin, të shqetësuar për çfarë po ndodhte me ne *intelektualistët* e vitit të dytë gjimnaz...por mund të na konsideronin edhe *armiq të popullit*, po të vazhdonin kritikat me atë gjuhë.

Nuk do të mungonte dhe një moment humori, kur një shoqja jonë, për të mbështetur babanë e saj që po na kritikonte, e filloi diskutimin e vet me shprehjen "Fjala e shokut babi është shumë e drejtë". Mezi e kemi përballuar të qeshurën me Ketin që më ndodhej pranë, të trembura nga ndonjë ndëshkim tjetër që mund të na ndodhte. Më pas fola unë si sekretare e klasës, që po më ngarkohej përgjegjësia më e madhe për situatën. E qartë për farsën e takimit, fjala ime kishte për qëllim të tregonte se asgjë e qëllimshme në dëm të mësimit dhe edukimit nuk kishte ndodhur me ne. Megjithatë, na duhej të thelloheshim në qëndrimet dhe sjelljet tona për të mos krijuar keqkuptime te mësuesit tanë.

Mbledhja me diskutime dhe qortime vazhdoi deri në mesnatë, kur u mbyll me kërcënimin që duhej të reflektonim për të mos qenë të *pasjellshëm me mësuesit*. Përndryshe do të përballeshim me masa të rrepta. Në realitet bëhej fjalë për "sjelljen e vajzave" dhe djemtë kishin të drejtë të ndiheshin më tepër të pafajshëm se ne që duke qeshur u bëmë shkas i asaj ngjarje të çuditshme për të gjithë. Gjithçka ishte një absurditet, një inskenim dhe një kërcënim që duhej të reflektonim

për çfarë po ndodhte. Me gjithë lehtësinë apo naivitetin e moshës, që na bënte të vazhdonim të qeshnim midis nesh me shoqet e afërta, u ndjeva e shqetësuar për këtë mbledhje, duke uruar të mos ishte e qëllimshme si sulm ndaj meje dhe të mos kishte vazhdimësi.

Nuk vonon shumë dhe drejtori na thërret në drejtori mua dhe dy shoqet e mia, Ketin dhe Dianën, me pretekstin se kishte nevojë për të shkruar disa materiale dhe ne do të shërbenim si shkruese. Shkojmë në drejtori, ku ai na caktoi vendet ku do të uleshim dhe materialet që do të shkruanim. Ishim paksa të shqetësuara nga ngjarjet e mëparshme, por të detyruara të kryenim një detyrë që, nëse nuk do të ishte e qëllimshme, do të kalonte normalisht. Filluam të shkruanim, ndërkohë që drejtori ishte i pranishëm. Nuk kalon shumë kohë dhe hap perdet e zyrës, perde doku ngjyrë blu që errësuan dhomën, ndërkohë që ne po shkruanim dhe kishim nevojë për dritë. Më pas vazhdon me veprime të çuditshme, duke ecur me nervozizëm dhe duke u afruar sa te njëra te tjetra, me pretekstin të shihte si po shkruanim. Kur afrohet ndiej frymëmarrjen e shqetësuar të tij që më frikëson dhe shikoj nga shoqet si për të kuptuar reagimin e tyre...ato vazhdonin të shkruanin, ndërkohë që ai u drejtohet papritur dhe u thotë:

- Ju të dyja shkoni, kurse ti, - më drejtohet mua, - do të vazhdosh të shkruash!

E vështirë të përshkruaj çfarë ndjeva në atë moment, por ajo që s'mund të harrohet kurrë ishte frika e tmerrshme, si frika e presë para agresorit. Instinkti mbrojtës veproi më së miri, sepse, pa u menduar gjatë, e tmerruar nga frika se çfarë mund të më ndodhte,

ngrihem nga karrigia ku isha ulur dhe i drejtohem me ton të trembur, të revoltuar dhe të vendosur:

- Nëse do të shkojnë shoqet, do të shkoj edhe unë së bashku me ato.

- Jaaashtë që të treeeeja! - ulërin si bishë e tërbuar.

Me shpejtësi dalim nga zyra e tij tepër të shqetësuara, shkojmë në klasë, marrim çantat dhe kthehemi për në shtëpi.

E kujtuam ngjarjen një ditë me Ketin, shoqen time të afërt, e cila më kujtoi që rrugën e kishim bërë në heshtje dhe së fundi unë u isha lutur të dyja shoqeve, para se të ndaheshim, që ta mbanin sekret dhe të mos e diskutonin me asnjë njeri atë çfarë ndodhi. Kështu ndodhi, sepse me gjithë shqetësimin, shpëtuam mrekullisht, ndiheshim të çliruara, pas asaj ndodhie që nuk do të harrohej lehtë, me besimin që asnjë tjetër veç nesh nuk do të dinte çfarë ndodhi me ne atë ditë në zyrën e *Drejtorit*. U mbetem shumë mirënjohëse Ketit, Dianës edhe Natashës, me të cilat flisja shpesh për shqetësimin tim, që u treguan të gatshme të dëshmonin për sa dinin lidhur me këtë ngjarje, (nëse do të pyeteshin më vonë), kur erdhi momenti të diskutohej e vërteta.

Kjo gjë nuk ndodhi, sepse ai kishte vetëm forcën e *Pushtetit*, por jo kurajon për t'u përballur, kurse ne kishim të Vërtetën që besonim se do të fitonte.

Megjithatë, edhe pse nuk u përball, ai nuk do të qëndronte indiferent ndaj kësaj çështjeje, jo vetëm ndaj meje, por edhe ndaj shoqeve, dëshmitare të ngjarjes.

Ndoshta jo rastësisht, Ketit, ndaj së cilës jam ndier pa fund mirënjohëse, përveç vitit të parë, nuk iu miratua asnjëherë e drejta e studimit, për sa kohë ai ishte në

pushtet në Korçë. Kam ndier vërtet keqardhje për Ketin, që nuk iu realizua dëshira për të vazhduar studimet e larta, por u ndjeva mirë kur u gjend e kënaqur me punën në Korçë dhe më vonë e sistemuar familjarisht më së miri jashtë vendit.

Kur më kujtoi Keti ngjarjen, mendova që me të drejtë u kisha kërkuar të ruanin sekretin, meqenëse nuk degradoi situata dhe nuk ndodhi më e keqja që mund të kishte ndodhur...gjithashtu shpresoja që nuk do të vazhdonin orvatje të tjera të kësaj natyre më vonë.

Por historia nuk mbaroi këtu, sepse vazhdoi ndryshe. Pas dy ditësh nga ngjarja, mësuesi kujdestar, i cili kishte marrëdhënie të mira me drejtorin, si epror që e kishte, më ngre në mësim në lëndën e gjuhës ruse. Pasi u përgjigja rrjedhshëm, më pyet për një nëntitull shkruar me gërma të vogla në krye të tekstit: "Çfarë ka thënë Lenini për Gorkin?" U përgjigja mbi vlerësimin e Gorkit nga Lenini, por shprehjen saktësisht me germa të vogla në fillim të tekstit nuk e kisha fiksuar. Kjo përkonte me pritshmërinë e tij, i cili menjëherë më thotë të ulem me vlerësim notën pesë. Pas meje ngre në mësim dy nxënës, të cilët i vlerëson me notën katër dhe më pas më drejtohet mua me ironi në gjuhën ruse: "*Përsëri mbetesh më e mira!"*

Duke kuptuar që ishte një sjellje e qëllimshme e tij në vazhdën e sjelljeve të qëllimshme të drejtorit, mendova që, nëse ishte qëllimi për prishjen e mesatares së notës përfundimtare, do të kërkoja provim me komision në fund të vitit që po afronte. Ndihesha e familjarizuar me gjuhën ruse, sepse, përveç mësimeve të shkollës, konsultohesha herë pas here me mësuesen e nderuar

të gjuhës ruse, Dhespina Skëndi, njëkohësisht mike e familjes.

Ishte ora e fundit dhe si gjithmonë me shoqet ishim duke dalë nga klasa. Duke zbritur shkallët mes turmës së gjimnazistëve, rastësisht ndeshim para nesh duke biseduar midis tyre, drejtorin dhe mësuesin kujdestar dhe dëgjojmë papritur: "...dhe e di si i thashë në fund? Përsëri mbetesh më e mira!" Një e qeshur buçitëse doli nga goja e tij, ndërkohë që mësuesi kujdestar, i kënaqur që e kishte kryer misionin dhe kishte kënaqur drejtorin vazhdoi bisedën, të cilën nuk e dëgjuam më pas..të shtangura dhe të habitura për çfarë po ndodhte, vazhdojmë rrugën së bashku me drejtimin për në shtëpi. Si zakonisht, ecëm gjatë bulevardit "Republika", ku për fatin tonë të mirë atë ditë, u ndjemë paksa më mirë jashtë në shoqërinë e rrezeve të ngrohta të diellit pranveror.

Ishte rruga jonë e përditshme nga gjimnazi për në shtëpi, ku zakonisht sodisnim deri në detaje shtëpitë e bukura, karakteristike për nga arkitektura, kufizuar me kangjellat buzë trotuareve dhe lulet shumëngjyrëshe që nuk mungonin në oborret e tyre. Nuk mund të mos e bënim gjithmonë me shumë kënaqësi atë rrugë, por atë ditë ndryshonte gjithçka. Ndihesha e përhumbur. Ishte paralajmërim i një eklipsi të gjatë që do të pllakoste errësirën...më duhej të shpejtoja hapat për të shkuar sa më parë në shtëpi dhe nuk harroj që as fjalët e ngrohta të shoqeve të mia, që përpiqeshin të më qetësonin, nuk kishin vlerë në ato momente. Shqetësimi ishte akoma më i madh se ditën e *ngjarjes së mëparshme*, sepse kuptova që vështirësi të mëdha do të pengonin rrugën time që e shihja aq të bukur dhe të dëlirë.

Isha e përkushtuar në realizimin e ëndrrave të shumta për të ardhmen, por ndjeva që më duhej të përgatitesha për diçka tjetër që mund të më priste dhe ky moment mund të ishte vetëm fillimi.

Në shtëpi si gjithmonë më priste dreka e ngrohtë e gatuar me shumë dashuri nga teta, e cila ishte e përkushtuar tërësisht me dashuri të pamasë ndaj nesh gjatë gjithë jetës së saj. Teksa më pyeti si gjithmonë si kisha kaluar në shkollë, vazhdoi të më pyeste nëse kisha ndonjë shqetësim, sepse me intuitën e saj kishte kuptuar që diçka nuk shkonte mirë. Ndodhte rrallë që të mos i tregoja mbi ngjarjet jashtë shtëpisë, por këtë herë ishte e pamundur, sepse e kisha të vështirë të shpjegoja atë që edhe unë nuk po e kuptoja mirë çfarë po ndodhte...njëkohësisht nuk doja ta shqetësoja.

Fillimisht ndryshova bangën, nga ana e derës, bashkë me shoqen e afërt Vasilikën, (që më qetësonte me natyrën e saj të qetë), për të mos u gjendur te dritarja, përballë dritareve të zyrës së tij, ku shpesh qëndronte prapa xhamave. Kaluan pak ditë pas ndërrimit të bankës, kur drejtori vjen për kontroll mësimor në klasën tonë dhe pasi i thotë shoqes së bankës, Vasilikës, të ulet në një bankë tjetër, ulet në bankë me mua, ndërkohë që nuk ishim në bankë të fundit ku ulej zakonisht personi që vinte për kontroll. Sigurisht që ai ishte drejtor dhe kishte të drejtë të ulej ku të donte, por mua më shqetësoi ai gjest, pas ngjarjeve që sa vinin bëheshin më shqetësuese. Gjithashtu, ky veprim nuk kishte kaluar pa u vënë re nga shoqet e tjera të klasës, që do ta kujtonin më vonë si një gjest jo normal të tij.

Me besim në vetvete mendova që, nëse do të përsëriteshin ngjarje të tilla si shantazhe për të thyer vendosmërinë time, ndërrimi i shkollës do të ishte zgjidhja e vetme, megjithëse ishte e vështirë të realizohej.

Kaluan vetëm pak ditë kur dëgjojmë lajmin e gëzuar për largimin e P., që, nga drejtor shkolle, do të emërohej Sekretar i Parë i Rinisë së Rrethit Korçë. Mesa dukej, i plotësonte mirë *kriteret e kohës* për sekretar rinie në qytet...ndërkohë unë u ndjeva me fat dhe me besim të përforcuar te Zoti që po shpëtoja nga shqetësimi që më kishte kapur dhe po më terrorizonte çdo ditë. Ishte ankthi se çfarë do të më priste pas atyre veprimeve të ulëta, të palejueshme, jo për një drejtor institucioni arsimor, por për çdo qenie humane.

Gëzimi ishte kaq i madh, sa nuk mendova faktin që ai do të shkonte në një post më të lartë, me më shumë ndikim dhe që do të vazhdonte kalvari i përndjekjes edhe 3 vjet të tjerë. Vetëm një gjë nuk harroj që kam menduar në ato momente. Pyesja veten dhe shoqet që e dinin historinë, veçanërisht Ketin, që ishte dëshmitare e ngjarjeve dhe ndanim shumë biseda mes nesh: "*Si mund të ndodhte vallë, që në poste të rëndësishme të emëroheshin njerëz të kësaj kategorie?*" Për më tepër, ai ishte dëgjuar për *histori të kësaj natyre*, sepse fjalët qarkullonin shumë shpejt dhe merrej vesh çfarë ndodhte në qytetin e Korçës.

Njëkohësisht, po kuptoja që duhej të isha e përgatitur që Politika dhe Pushteti nuk ishin aq të drejtë sa paraqiteshin para popullit dhe sa ne i mendonim në atë moshë.

Ai largohet si drejtor dhe së bashku me atë edhe frika dhe ankthi, sepse edhe mësuesi kujdestar ndryshoi

sjellje, gjë që u reflektua në vlerësimin maksimal në lëndën e tij, por edhe jashtë saj. Kuptova që sjellja e tij kishte qenë e imponuar nga eprori.

Gjithçka dukej se shkonte normalisht, pa akuza për modernizëm, për prirje intelektualiste apo kërcënime të tërthorta, gjë që u kurorëzua me rezultatet më të larta të shkollës së mesme, me të drejtën e propozimit të Medaljes së Artë.

Pavarësisht rregullave strikte që i përshtateshin regjimit të diktaturës, investimi për arsimin ishte në shërbim të *miredukimit dhe përgatitjes së kuadrove* që do t'i shërbenin vendit në të ardhmen. Pjesë e këtij interesimi ishin edhe mësuesit në përgjithësi, të të gjitha lëndëve mësimore, të mirëpërgatitur profesionalisht dhe të interesuar për mbarëvajtjen e nxënësve. Kjo na bënte të ndiheshim mirë dhe në marrëdhënie normale mësues-nxënës, me mbresa dhe kujtime që na imponoin respekt për ata mësues. Kjo i dedikohet edhe traditës dhe historisë së asaj shkolle, që fillon me Liceun Francez të krijuar në vitin 1917, si shkollë laike ku të gjitha lëndët ishin në frëngjisht.

Në vazhdën e kësaj tradite edhe sot shkolla e mesme "Raqi Qirinxhi" në Korçë, është nga të paktat shkolla të mesme ku gjuha frënge studiohet si gjuhë e parë e huaj, ndryshe nga koha jonë kur në atë gjimnaz si gjuhë e huaj, studiohej vetëm gjuha ruse dhe më vonë do të shtohej gjuha frënge. Linte për të dëshiruar mënyra e mësimdhënies, si kudo, e trashëguar nga e kaluara, prej qëndrimit autoritar të mësuesit në katedër, që sa ulej do të hapte regjistrin dhe do të fillonte me ngritjen e nxënësve në dërrasën e zezë. Ishte shprehje e

autoritarizmit dhe e kërkesës së llogarisë, kjo mënyrë, ku nxënësit ishin të detyruar të riprodhonin mësimin dhe quheshin se ishin më të vlerësuar sa më besnik do t'i qëndronin tekstit në libër. Shpesh na acaronte kjo metodë, sepse binte ndesh me mënyrën tonë të të mësuarit me logjikë dhe jo riprodhim mekanik të tekstit. Megjithatë, ishim të detyruar t'i përshtateshim mënyrës standarde të mësimdhënies dhe kështu gjatë përgjigjes mbeteshim të kufizuar vetëm me tekstin shkollor.

Një kujtim i vlerësuar nga ish-nxënësit e tij, mbetet Profesor K.Stralla, jo vetëm për mënyrën e mësimdhënies, por në sensin e inteligjencës, qytetarisë dhe përkushtimit për të dhënë sa më shumë informacion. Mënyra komunikuese e mësimdhënies dhe dhënia e njohurive përtej tekstit shkollor ishte një risi në atë kohë, gjë që nuk do të kalonte pa lënë mbresa te nxënësit që e ndeshnin rrallë te ndonjë mësues i ri në moshë dhe mendësi; ky ishte prof. Klodi Stralla në atë kohë për ne.

Personalisht hasja vështirësi në lëndën e fizkulturës, ku veçanërisht në vrap nuk i arrija normat për rezultatet maksimale. Fizkulturën e nënvleftësonim edhe për shkak të mentalitetit të kohës, sipas të cilit duhej t'u kushtoheshim librave dhe marrjen me sport e quanim kohë të humbur. Mësuesja e fizkulturës, N.Bleta, priste të dilnin rezultatet e tjera dhe më pas më thoshte se, me gjithë përpjekjet, nuk e meritoja notën dhjetë për rezultatet e normave në vrap, por nuk e meritoja as të ma prishte dëftesën vetëm nota e fizkulturës. Më dukej një veprim shumë dashamirës dhe ndjehem mirënjohëse ndaj asaj mësueseje të mirë...më vonë do ndryshoja këndvështrim lidhur me meritën e Medaljes

në përgjithësi, sepse, po të ishte për fizkulturën, me të drejtë nuk do ta meritoja Medaljen dhe për pasojë edhe të drejtën që të kërkoja zgjedhjen e degës për të drejtën e studimit; por njëkohësisht do e konsideroja si shansin tim të mirë, sepse ndryshe dyert për të kërkuar të drejtën do të ishin të mbyllura. Jo vetëm kaq, por e ardhmja ime do të vihej në dyshim nëse do të vazhdoja studimet..

Situata ishte e vështirë, sepse ai që po vazhdonte të më përndiqte ishte në një nga postet më të rëndësishme në qytetin e Korçës. Për pasojë, e vetmja mundësi për të shpresuar ishte kërkesa ime në instancat më të larta për moszbatimin e rregullores së Ministrisë së Arsimit, në atë kohë, për të drejtën e zgjedhjes së degës së studimit.

Shkalla e parë e ankesës ishte Seksioni i Arsimit, ku shefi i Seksionit të Arsimit në atë kohë priste ankesat e nxënësve dhe prindërve të pakënaqur për të drejtat e studimit që u ishin dhënë. Kur hyj në zyrë, shoh që përveç shefit të seksionit ishte edhe P., si ish-kryetar i komisionit, që mbante përgjegjësinë e vendimeve të marra. I drejtohem vetëm shefit, duke i thënë që kërkoja të drejtën mbi moszbatimin e rregullores në rastin tim. Ndërkohë merr fjalën P., i cili më thotë që ky ishte një vit i veçantë, mbasi atdheu ka nevojë për specialistë bujqësie dhe prandaj unë *si më e mira isha caktuar të studioja në fushën e bujqësisë*.

- Nuk kam ardhur të flas me ju, sepse me ju kemi folur në të tjera rrethana, - përgjigjem unë. - Kam ardhur këtu, sepse më duhet të ankohem në instancat më lart, mbasi këtu nuk kam shpresë për zgjidhje.

- Është pikërisht kjo arsyeja që jeni caktuar në agronomi, - përgjigjet shefi i seksionit, në mbështetje të P.

Nuk vazhdova më tej, por hapa derën dhe dola nga zyra. Jashtë më priste Natasha, së cilës edhe asaj i ishte dhënë e drejta e studimit për agronomi dhe priste të hynte edhe ajo për t'u ankuar, por, kur më dëgjoi mua pasi dola nga zyra, mendoi që nuk ia vlente të hynte. Natasha e dinte që arsyeja e të drejtës së saj në Agronomi në Korçë ishte për *arsye biografie* dhe zgjidhja do të ishte e pamundur.

Për mua do të ishte fillimi i një rruge të gjatë këmbëngulëse për të gjetur të drejtën e mohuar, me qëllim vazhdimin e një dege tjetër. Isha me fat që kisha mbështetjen e plotë të motrës dhe prindërve të mi, që me një besim të jashtëzakonshëm ndaj meje më përkrahnin dhe miratonin vendimin që kisha marrë tashmë për ta çuar deri në fund kërkesën për të drejtën e mohuar.

Kështillohem për rrugën që duhej të ndiqja. Sipas procedurave normale, duhej t'i drejtohesha Sekretarit të Parë të Komitetit të Partisë, për të vazhduar më pas me Ministrinë e Arsimit dhe, nëse nuk do të zgjidhej, do të vazhdoja me Komitetin Qendror, deri te *shoku Enver*, siç e quanim atëherë. Nëse do të kishe fatin të vihej në dijeni, *udhëheqësi*, mendohej si e vetmja zgjidhje për kohën, sepse bëhej fjalë për shkelje të rregullores dhe *diktatori nuk të falte në këto raste*. Historia vazhdon me takimin me Sekretarin e Parë të Komitetit të Partisë, të rrethit Korçë, M.Z. Paraprakisht takoj sekretaren e tij personale. Efigjeni ishte një grua që mishëronte tipare tepër të zgjedhura në sjellje dhe komunikim, për atë post, për seriozitetin dhe rigorozitetin me të cilin i trajtonte problematikat. Kuptova që më dha plotësisht të drejtë, pasi më dëgjoi dhe nuk kishte nevojë për shumë sqarime,

për personin në fjalë. Mesa dukej, kishte dëgjuar edhe histori të tjera të kësaj natyre rreth tij.

Shumë shpejt më njofton për takim me shefin e saj, M. Z., i cili pasi më dëgjon më le të kuptoj që më jep të drejtë dhe më bën të shpresoj se diçka mund të bënte, megjithëse nuk më premtoi konkretisht. Isha në pritje të një përgjigjeje, e vendosur që, megjithëse po afronte dita e fillimit të shkollës, nuk do të shkoja edhe sikur të merrja përgjigje negative. Ideja që kisha plotësisht të drejtë, më shtonte gjithmonë e më tepër vendosmërinë për të mos u kthyer nga rruga që kisha nisur.

Rastësisht takoj ish-mësuesin kujdestar, i cili, para se të dilnin të drejtat e studimit, më kishte thënë që të *isha e qetë*, se një degë e mirë do të më jepej dhe nëse do të kishte bursa për jashtë shtetit, unë do të isha kandidate parësore. E besova, sepse nuk kisha pse të dyshoja për të kundërtën, ndërkohë që nuk mund të merrja me mend që ai vazhdonte lidhjet me P. në të njëjtën linjë që unë e quaja se i përkiste së shkuarës.

- Të rekomandoj të shkosh në shkollë dhe të mos e refuzosh degën që të është dhënë, sepse mund të përballesh me pasoja, - më thotë ai me një *ton dashamirës*, kur e hasa rastësisht pranë shtëpisë së tij, (ndodheshim shumë afër me shtëpi).

- Nuk pres këshilla nga ju, - i them unë me një ton mospërfillës.

- Pse, unë ta nxora të drejtën e studimit në agronomi? - më pyet paksa i nervozuar.

- Ke qenë në shërbim të shokut tënd prej kohësh, - i them dhe menjëherë pas kësaj largohem për të mos i folur më. Për t'u justifikuar takoi babanë më vonë, por

asgjë nuk vlente, sepse tashmë gjithçka ishte e qartë për mua dhe familjen time.

Nga bisedat e ndryshme pati edhe të tjerë që më këshillonin të shkoja në shkollë, sepse mund të kisha pasoja, pasi kishte filluar të diskutohej gjithandej si çështje e ditës. Përveç familjes që më kishte lënë të lirë në vendimin tim, ishte një nga miqtë e familjes, doktor dhe njeri tepër i respektuar si njeri i mençur dhe vizionar, i cili më këshilloi të mos shkoja në atë shkollë, por të vazhdoja të kërkoja të drejtën e mohuar.

- Nuk është vetëm universiteti që e kulturon njeriun, ishte së fundi këshilla e tij.

Isha shumë dakord që shkolla nuk do të zëvendësonte kulturën shumëdimensionale, por ishte *Sistemi* që na detyronte ta shihnim shkollën e lartë si të vetmen zgjidhje që hapte dyert e së ardhmes. Ndoshta në një *Sistem tjetër*, nuk do ia vlente ajo sakrificë që më priste të kaloja...por në një S*istem tjetër* edhe nuk mund të ndodhte ajo që ndodhi, nën maskën e sloganeve të regjimit.

Shkolla fillonte të hënën e ardhshme, ndërsa unë prisja përgjigje nëpërmjet sekretares së Sekretarit të Parë. Pak ditë më vonë, marr njoftimin se M. Z. largohet nga ai post dhe në vend të tij emërohej E. H., figurë politike e njohur dhe ky mes pushtetarëve të tjerë. Kjo donte të thoshte që do të vazhdonte kalvari i takimeve për të sqaruar edhe këtë të fundit rreth çështjes sime të lënë për zgjidhje nga i mëparshmi. Kjo ishte këshilla e sekretares, të cilën e besoja për sinqeritetin dhe përkushtimin e saj ndaj çështjes në fjalë.

Ndërkohë që isha në pritje për takimin, sekretarja më njofton që P. nga Sekretari i Parë i Rinisë ishte emëruar Sekretar i Dytë i Komitetit të Partisë së rrethit Korçë, për Sektorin e Arsimit dhe Edukimit; pra po ngjiste me shpejtësi shkallët e karrierës, ndërkohë që unë prisja të takohesha me shefin e tij, për të gjetur të drejtën time. Ironia më e madhe për situatën.

Problemi im po ndërlikohej dhe zvarritej dhe lajmi ishte tronditës. Ndërkohë një zë i brendshëm më fliste se isha në rrugën e duhur të së drejtës, që më shtonte besimin se ishte e vetmja rrugë që do të më nxirrte në krye, pavarësisht që njeriu me të cilin më duhej të përballesha ishte fuqizuar politikisht. Natyrshëm i jam bindur shpesh zërit tim të brendshëm dhe fatmirësisht nuk jam ndier e zhgënjyer.

Vendimi për të mos vazhduar në Agronomi ishte i pakthyeshëm për mua, kur një ngjarje tjetër bëri të merrja kthesë në vendimin tim.

Shkolla fillonte ditën e hënë, kur të shtunën mbasdite, një shoku im shumë i mirë i klasës, Viktori, vjen në shtëpinë time. Çuditem kur e shoh te porta, sepse ishte hera e parë që vinte tek unë. Me dëshirën e mirë për të më ndihmuar, më tregon se babait të tij (që punonte piktor në qendrën e pikturave të qytetit) i kishin çuar nga Komiteti i Rinisë së rrethit tekstin e një *fletërrufeje,* që do të vihej në adresën time të hënën në tabelën e emulacionit në qendër të qytetit. E pyes për përmbajtjen dhe me të drejtë, pak i rezervuar për sekretin që po i nxirrte t'et, më thotë që akuzohesha në *fletërrufe si dezertore e vendimit të Partisë*, duke mos shkuar atje ku kishte nevojë Atdheu. Autori i fletërrufesë ishte e gjithë

Rinia e Qytetit, e indinjuar që unë po kundërshtoja *Vendimin e Partisë*..!!!

E falënderova me mirënjohje, duke i premtuar që do ta ruaja sekretin që më besoi, për të mos e harruar kurrë nderin që më ka bërë ai shok i mirë. Pa u menduar më tepër, ndjeva rrezikun që po më kërcënonte dhe mora vendimin që duhej të paraqitesha në IB për të shmangur fletërrufenë që do të vihej në qytet ditën e hënë, nëse unë nuk do të paraqitesha.

Tashmë ishte e qartë, që si njeri i pushtetshëm me ngjitje në karrierë, ai do të bënte gjithçka për të mbrojtur veten nga akuza që ishte ngritur nga unë dhe për këtë duhej të ulte figurën time.

Flas me Lidën, që ishte jo vetëm motra më e madhe, por edhe shoqja dhe këshilluesja ime më e mirë për çdo gjë që do të më shqetësonte. E diskutojmë më pas me prindërit dhe vendosim familjarisht që duhet të paraqitesha patjetër në IB ditën e fillimit të shkollës, për të shmangur vënien e fletërrufesë, pa humbur shpresën që mund ta fitoja të drejtën një ditë. Atë ditë motra do të nisej për në Tiranë, sepse fillonte edhe ajo vitin e katërt shkollor në Institutin e Lartë të Arteve, por zemërthyer prej gjendjes që po më linte, para një beteje të vështirë dhe të pabarabartë me të pushtetshmit e pamoralshëm. Unë gjithashtu do ta ndieja mungesën e saj më tepër se kurrë, megjithëse prindërit, tetoja, njerëzit e afërm të familjes dhe shoqet i kisha aleatë të përhershëm dhe të duhurit për mua.

Isha gati 19 vjeç, e parrahur deri në atë kohë me vështirësi të kësaj natyre, por me armën mbrojtëse më të fuqishme, me të Drejtën, të Vërtetën dhe Besimin

në Zot. Paraqitem të hënë në mëngjes në sekretarinë e Institutit Bujqësor për t'u regjistruar, ku më thonë që viti shkollor fillonte me punën prodhuese, siç ndodhte rëndom në atë kohë. Do të shkoja me grupin e kursit në fshatin Sovjan, ku do të shkonte i gjithë instituti dhe puna që do të kryenim ishte të pastronim panxhar sheqeri.

Mendova se, si të gjithë, do të filloja punën në pastrimin e panxharit, kur pa pritur më afrohet sekretari i rinisë së IB dhe më thotë:

- Para se të fillosh punën, duhet të japësh sqarimet e duhura për paraqitjen me vonesë, para të gjithë studentëve të IB në mbledhjen që sapo ishte njoftuar. Asgjë nuk më bënte përshtypje pas asaj që kishte ndodhur, për më tepër që unë ndihesha vetëm fizikisht aty. Vendimi im vazhdonte të ishte që, unë isha aty sepse më duhej të vazhdoja rrugën pa kthim në kërkimin e së drejtës.

Ndihesha e huaj në qëndrim dhe në veprimet e mia, sikurse dhe në fjalën që mbajta para studentëve që ishin ulur para meje këmbëkryq në tokë me uniformën e punës prodhuese. Mbaj mend që mbizotëronte ngjyra blu e uniformës...kujtoj vetëm disa studentë korçarë që i njihja që më parë dhe e dija që, me gjithë inteligjencën dhe rezultatet e tyre të mira në mësime, ata gjendeshin aty për *arsye biografie*.

E papërgatitur për atë mbledhje spontane, me pak fjalë më duhej të justifikoja paraqitjen me vonesë në sekretarinë e IB për arsye që, sikurse theksova aty, do të vazhdoja t'i kërkoja sepse ishte e drejta ime. Njëkohësisht më duhej të sqaroja që kjo nuk kishte lidhje

me përbuzjen për bujqësinë, për të cilën akuzohesha dhe se për sa kohë do të isha aty, do të ndihesha e barabartë dhe miqësore me të gjithë shoqet dhe shokët që më rrethonin.

Në fakt ndihesha e huaj dhe mbaj mend që më shoqëronte shpesh në imagjinatë *I huaji i A. Camus* në librin me të njëjtin titull, të cilin e lexonim fshehur, të përkthyer në fshehtësi, sepse hynte në librat e ndaluar. E pranishme fizikisht, por e huaj mes të huajve, përveç shoqes sime të afërt Natashës, me të cilën u ndjemë mirë së bashku, si dikur në shkollën e mesme, për sa kohë vazhdova aty. Natasha e la përfundimisht atë shkollë, duke i humbur me dëshirë provimet në fund të vitit, për të mos vazhduar më aty. Nuk mundi të vazhdonte as ndonjë shkollë tjetër, Natasha edhe pse i plotësonte të gjitha kushtet, përveç arsyes së *biografisë*, që e detyronte të studionte në atë shkollë.

Kështu kaloi normalisht muaji i punës prodhuese, përveç një incidenti të vogël ditën e parë, që duke punuar, aksidentalisht, plagosa gishtin me draprin e madh që na kishin dhënë për pastrimin e panxharit... do të më ngelej shenjë në gisht, si për të më kujtuar atë ditë të shëmtuar, kur sigurisht, dhimbja fizike nuk ishte asgjë para asaj shpirtërore.

Takimi i premtuar me Sekretarin e Parë të Komitetit të Partisë po vononte dhe, duke qenë se shpresat po zbeheshin për përgjigje, sekretarja që po më mbështeste asokohe, më këshilloi të mos prisja më, por t'i drejtohesha Ministrisë së Arsimit dhe, pse jo, edhe "*udhëheqësit të madh*", me besimin që "*Ai*" mund ta zgjidhte të drejtën.

Ishte normale të mos shpresoja më tek *drejtuesit e Korçës*, që e kishin mes tyre kolegun e akuzuar si shkaktari kryesor; ishte absurditet të besoja tek ata që sigurisht do ta mbronin kolegun...koha do ta vërtetonte këtë.

Dërgoj dy letra me ankesën për mos zbatimin e rregullores në rastin tim, njëra drejtuar *Udhëheqësit* dhe tjetra Ministres së Arsimit në atë kohë, T.Cami. Të dyja përgjigjet fillimisht ishin si shumica e përgjigjeve standard të kohës, që kërkesa do të shqyrtohej, në përputhje me procedurat. Ndërkohë unë vazhdoja normalisht shkollën në IB, deri sa, pas rreth një muaji, më njoftojnë të paraqitem në Komitetin e Partisë për të marrë përgjigje nëpërmjet sekretarit të Komitetit të Partisë të rrethit, njëkohësisht kolegu i zyrës së P. Më pret me shumë *dashamirësi dhe keqardhje*, për sa kishte ndodhur, duke pohuar se kjo ishte një padrejtësi, që nuk ishte zbatuar rregullorja në të drejtën time të studimit për zgjedhjen e degës. Më pas vazhdoi duke thënë se me gjithë të drejtën që kisha, nuk mund të bëhej gjë në këtë kohë, sepse ishte vonë dhe nuk kishte asnjë të drejtë studimi të lirë për të m'u mundësuar. Ndërkohë unë isha e gatshme të pranoja çfarëdo dege tjetër studimi, mjaftonte që të më jepej mundësia të largohesha nga IB në Korçë.

Tani kishte kaluar në plan të parë domosdoshmëria e largimit nga IB, për shkak të përndjekjes. Lufta ishte e hapur. P. ishte në dijeni të gjithçkaje që po ndodhte dhe nuk vihej në dyshim hakmarrja e tij, të cilën tashmë e kishte pohuar hapur te njerëz të tij të besuar; por më e keqja ishte që nuk po përballej hapur në mbrojtje të akuzës që i bëhej.

Ndërkohë ishte bërë një hap pozitiv, që ishte pranuar si padrejtësi dhënia e të drejtës sime të studimit në IB Korçë. Në këto kushte isha e detyruar të vazhdoja studimet normalisht për momentin, por e gatshme t'i ndërprisja për të vazhduar vitin tjetër dhe ndërprerja e justifikuar e studimeve ishte e vetmja zgjidhje.

Ndërkohë që vazhdoja studimet, kisha shkuar për pak ditë me pushime te motra studente në Tiranë dhe papritur pësoj një krizë me dhimbje mesi. Shtrohem me urgjencë në spital në Tiranë, ku u konstatua çrregullim i funksionit të veshkave. Pas një konsulte me mjekët, të cilëve u shpjegova situatën mbi shqetësimet që kisha kaluar, por edhe me ndërhyrjen e një miku të familjes, ata u treguan të arsyeshëm dhe u dërgojnë rekomandim mjekëve në Korçë për ndërprerjen e studimeve atë vit shkollor.

Ishte gjëja e duhur për mua që mund të justifikonte shkëputjen nga shkolla.

Me rekomandimin nga Tirana edhe mjekët e Korçës nuk ngurruan të më jepnin raportin mjekoligjor për ndërprerje të studimeve për një vit. Ishte momenti kur ndjeva se kisha pranë Engjëllin Mbrojtës, me besimin se isha në rrugën e duhur drejt shkëndijës në fundin e tunelit të errët; ndjeva që po më buzëqeshte fati, tek i cili besoja po aq shumë sa edhe tek e vërteta dhe e drejta ime.

Nuk ishte e thjeshtë për mua të pranoja këputjen në mes, të ëndrrës më të bukur të viteve të asaj moshe, ndërprerjen e studimeve të mëtejshme. Do të ishte fatkeqësia më e madhe që të mos kisha mundësinë të vazhdoja studimet. I vetmi ngushëllim ishte që nuk isha

e vetme, por ishin të shumtë ata që, për arsye absurde të sistemit, ishin të detyruar të mos vazhdonin studimet. Megjithatë, mendoja që secili në këto pozita duhej të përpiqej për t'ia dalë në një farë mënyre, sikurse po veproja unë.

Të pamundur e kishin ata që sakrifikoheshin për *arsye biografie*, apo rregullit më absurd të asaj kohe që ua mohonte të drejtën e studimit fëmijëve të tretë. Një nga viktimat e këtij absurditeti ishte shoqja ime Irisi, me të cilën e kujtojmë këtë histori të asaj kohe në shoqërinë e kafes, tani në liri të plotë (ajo dhe familja e saj ka ndier barrën e rëndë të problemeve të kësaj natyre në atë kohë). – Të gjithë gishtat e dorës dhembin njëlloj, do më thoshte ish mësuesi dhe qytetari i nderuar M.Zavalani, i trishtuar që vajzës së tij dhe shoqes sime Zanës, nuk i kish dalë e drejta e studimit, sepse ishte fëmija e tretë e familjes, dhe ligji absurd nuk e lejonte të studionte. Fatmirësisht unë po vazhdoja të mbështetesha te ligji për të drejtën time.

Pasi marr raportin mjekoligjor për ndërprerjen e studimeve, e paraqes në sekretarinë e IB dhe që të nesërmen u shkëputa nga ajo shkollë. Ndjeva që u çlirova nga prangat që më kishin kapur fort, fitova *lirinë e humbur* ato pak muaj dhe kuptova për herë të parë ç'do të thotë të ndihesh *e lirë* për të shpresuar; por ishte liri e përkohshme, sepse një betejë tjetër akoma më e vështirë më priste.

Njoftova sekretaren në Komitetin e Partisë për sa kishte ndodhur dhe premtimi nga Sekretari i Parë, E. H. ishte që vitin tjetër shkollor do të zgjidhej drejt çështja. Meqenëse në atë sistem nuk lejohej të mos ishe

i punësuar kur nuk ishe në shkollë, u regjistrova në zyrën e punës në Lagje, sipas rregullave, me kërkesë për punë. Kërkova çfarëdo lloj pune dhe fillova punë në fermën e qytetit të Korçës. Shumë shpejt u mësova me ato procese pune që i provoja për herë të parë, si mbledhja e domateve, patateve, seleksionim perimesh etj. si këto. Ndihesha e kënaqur, për të mos thënë e lumtur dhe kisha arsye për këtë, sepse më në fund po shpresoja që do të realizohej ëndrra ime për vazhdimin e studimeve vitin e ardhshëm..

Kënaqësi e veçantë ishte edhe përvoja e re e punës, që po e konsideroja të përkohshme dhe po e shijoja si diçka të re dhe të panjohur deri atëherë, gjithashtu, edhe pagesa që e kujtoj si rrogën time të parë. Sa herë më duhej të shkruaja CV-në time mbas vitesh, gjithmonë do të më shfaqej në mendje që puna ime e parë, faktikisht, kishte qenë në fermë si punëtore.

Punëtoret aty ishin të kategorive të ndryshme. Midis tyre aty punonin gra që e kishin profesion punën në bujqësi, por kishte edhe nga ato që, edhe pse nuk e kishin profesion, ishin të detyruara për arsye të ndryshme të punonin aty.

Ishte një mikja ime, me profesion mësuese, që e kishin detyruar të punonte aty, si dënim që ishte divorcuar nga burri i saj, të cilin e kishte njohur në fshatin ku ajo jepte mësim. Divorci shihej si herezi dhe rasti në fjalë u konsiderua si përbuzje për jetën në fshat nga ana e mësueses. Ishte koha kur Udhëheqësi promovonte jetën në fshat dhe kishte deklaruar që *po të ishte 20 vjeç do të jetonte në fshatin e bukur socialist* dhe mbas kësaj të gjithë duhej ta donin fshatin. Me sa kuptohej, mësuesja që

e kishte *braktisur* fshatin pas divorcit, ishte konsideruar si shkelëse e porosisë së *Udhëheqësit mbi dashurinë për fshatin, megjithëse mësuesja nuk ishte 20 vjeç*.

Përgjegjësit e punës dhe punëtorët përreth na quanin aty si *të dënuara*, madje kishim filluar të ndiheshim edhe vetë si të dënuara (pa faj), prandaj rrinim paksa të veçuara nga të tjerat, kur në kohën e pushimit, në fshehtësi, pinim edhe ndonjë cigare. Pirja e cigares ishte kënaqësi e veçantë jo vetëm për mikeshën time, që tashmë e pinte nga sikleti që po kalonte, por edhe për mua, që po e shijoja për herë të parë, megjithëse tani e kisha kaluar kohën e adoleshencës kur provoheshin në fshehtësi kënaqësitë e ndaluara. Që prej asaj kohe e kisha kënaqësi edhe më vonë ta shoqëroja kafen me një cigare, me mikeshat e afërta, sepse ishte *e pahijshme për femrat të pinin cigare në ambiente publike*.

Kështu kalonin ditët dhe muajt deri në gushtin e ardhshëm kur prisja me shumë shpresa të drejtën e studimit, aty ku do të mendonin *shokët e partisë*, përveç Agronomisë në Korçë. Në ditën e shumëpritur nuk e shoh emrin në listën e të drejtave të studimit për maturantët e atij viti, por marr njoftimin që duhej të shkoja në Komitetin e Partisë për të marrë përgjigje.

Më pret në takim Sekretari i Parë E. H., (i informuar më së miri për çështjen time), i cili më thotë të mos shqetësohesha. Dega për mua ishte rezervuar për në Fakultetin Juridik, me propozimin e tij, meqenëse studimet zgjatnin tre vjet dhe kompensohej një vit që unë e kisha humbur ndërkohë.

- Pooor…, - vazhdoi ai, para se të më jepej e drejta e studimit, më duhej të paraqitesha në IB ku do të

zhvillohej një mbledhje me rininë e Institutit. - Qëllimi i mbledhjes, - vazhdoi E. H., për të më mbushur mendjen, *është për të sqaruar të rinjtë e IB mbi arsyen përse kërkon të largohesh. Të rinjtë ndihen të indinjuar, sepse u duket që ti e nënvleftëson degën e bujqësisë dhe atë fakultet*.

Për sa kuptova, *rinia që më priti me ceremoni* duhej edhe *të më përcillte me ceremoni.* Në fakt ndjeva që nuk mund të ishte kaq i thjeshtë organizimi i një mbledhje për të marrë vendimin e fundit. Mbledhja do të zhvillohej të nesërmen në orën 13.00 në një nga sallat e IB.

Atë natë në mes të një gjumi të shqetësuar shoh një ëndërr të cilën e kujtoj shpesh kur diskutohet mbi misterin e ëndrrave. Çuditërisht aty më dalin disa nga fytyrat e atyre personave që në fakt ishin të pranishëm të nesërmen në mbledhje. Shihja vetëm kokat e tyre, sepse trupin e kishin të zhytur në llum balte, duke u përpjekur të dilnin nga balta, por që nuk mundeshin. Ndërkohë unë qëndroja në këmbë midis tyre, mbi një pjesë shumë të vogël trualli të fortë, duke i parë nga lart me keqardhje..

Në vazhdim të ëndrrës, çuditërisht shoh një nga vajzat që studionte aty në vitin e katërt, një vajzë e bukur (Afërdita, por Ditka shkurt), që dallonte nga të tjerat për sharmin e saj, duke vrapuar ngadalë në mes të një fushe të mbushur me lule...shume shpejt në vend të saj shoh veten time si në një ekran filmi, në mes të luleve.

Ekzistenca e botës misterioze, përveç asaj reales që jetojmë, më ka tërhequr gjithmonë...ëndrra atë mëngjes ishte domethënëse dhe njëkohësisht qetësuese para se të shkoja në IB. Parandjenja ishte që Engjëlli Mbrojtës nuk

do të më braktiste. Me bekimin e prindërve dhe motrës dhe me besimin që më shoqëronte në çdo moment, nisem për të arritur në orën 13.00 të mesditës në mbledhjen e paralajmëruar. Po më shoqëronte mamaja, duke më porositur me zërin e saj të qetë, por duke mposhtur shqetësimin e brendshëm që nuk do t'i mungonte asnjë nëne: - Kujdes çupë, se ke të bësh me *të mëdhenjtë*...!

- Mos u bëj merak, mama, kam të Drejtën me vete.

Mamaja më përcjell me bekimin e nënës deri te dera e Institutit Bujqësor dhe largohet me lot në sy, me ata sy që do të ngeleshin të gdhendur përgjithmonë në memorien time.

Salla ishte mbushur plot me *të rinjtë e indinjuar për ikjen time*, në pritje për të më dëgjuar. M'u kujtua ëndrra e natës së mëparshme, kur pashë disa nga fytyrat që më ishin shfaqur në ëndërr, por e papritura, që më habiti më shumë, ishte prania e të dërguarit të Komitetit të Partisë, Sekretarit të Dytë të Partisë së Rrethit S.Dh., aktualisht, kolegut të zyrës së P.

Kjo mund të konsiderohej si komedia e radhës, por edhe një tregues, që *Partia e kishte marrë seriozisht çështjen dhe së bashku me P. brenda saj, duhej të vihej në dijeni për çfarë do të ndodhte në mbledhje*.

Mbledhjen e hapi sekretari i rinisë së IB, një i ri nga Kukësi, i cili më kujtoi ngjarjen kur sapo kisha filluar aty studimet. Një ditë ai më pati thirrur në zyrën e Komitetit të Rinisë, për të më tërhequr vërejtje se kishte *shfaqje të huaja* në veshjen time, sepse unë vishesha sipas *modës së huaj*.

- Je veshur me kadife të zezë, që është veshje e modës së huaj, - më tha kur e pyeta se ku qëndronte moda në

veshjen time. Sekretari dukej shumë i shqetësuar që kjo modë *mund të infektonte edhe të rinj të tjerë*.

- Kam edhe rripin e zi kadife që kam mbledhur flokët, iu pata përgjigjur unë, duke vazhduar kështu komedinë e radhës.

- Akoma më keq, - vazhdoi ai me seriozitet prej sekretari rinie.

Ishte po ky person që kishte thirrur në zyrë shoqen time Natashën, kur dikush e kishte informuar që kur ishin në zbor e kishin parë Natashën të fshinte lugën me pak bukë, në mungesë të letrës, për ta pastruar para se ta fuste në çantën e zborit.

- Kam informacion që ke fshirë lugën me bukë, për ta pastruar, prandaj ke vërejtje, sepse ke shpërdoruar bukën, që kemi porosi ta kursejmë sa më shumë, - i kishte thënë sekretari me shumë seriozitet Natashës, e cila edhe pse kishte vendosur ta linte atë shkollë, nuk mund t'i harronte ato skena komike edhe mbas vitesh.

Filloi të fliste *sekretari i këtyre historive*, si drejtues i mbledhjes. Midis të tjerash ai shprehu *indinjatën e tij dhe të rinisë për largimin tim nga ajo shkollë*. Nga të tjerët mbështetës të tij, kujtoj një ish-student grupi, që *rastësisht* kishte ndenjur në bankë me mua dhe që e kisha ndihmuar disa herë në provimet e kolokiumeve, që *për mirënjohje*, edhe ai u shpreh i indinjuar për largimin tim nga ajo shkollë.. kurse unë kuptova që janë momente, kur njeriu mund të njohë karakterin e vërtetë të njerëzve.

Më pas e merr fjalën drejtori N. P., i njohur deri në atë kohë si shërbyes besnik i Partisë dhe normalisht jo dashamirës me studentët.

- Na thuaj, - më drejtohet me një ton të ashpër dhe keqdashës, - përse kërkon të largohesh nga kjo shkollë? Studentët ndihen të ofenduar që ti, për arsye të rezultateve që ke arritur, e nënvleftëson këtë profesion, ndërkohë që *bujqësia është sektori ku ka nevojë më shumë atdheu*. (fjalët e fundit i kisha akoma në vesh nga P.)

- Nuk keni pse të ndiheni të shqetësuar që unë po kërkoj të largohem, - përgjigjem unë. - Unë po kërkoj të largohem jo sepse përbuz këtë profesion. Ka një rregullore të Ministrisë së Arsimit dhe unë kam të drejtën time të zgjedh degën e studimit, - vazhdova unë. Fakti që unë këtu vazhdova studimet për katër muaj me vlerësime maksimale në seminare dhe kolokiume tregon që nuk e nënvleftësova si profesion dhe si shkollë. Arsyeja e vetme që kërkoj largim tani, është sepse këtu ndihem e përndjekur nga i njëjti person që më përndoqi deri në vendimin për të drejtën e studimit në këtë shkollë.

- Nëse është kjo arsyeja, për të na bindur plotësisht, shko dhe vazhdo në Fakultetin e Agronomisë në Tiranë, - përgjigjet rrufeshëm drejtori, me pamjen e një njeriu që çdo gjë mund të ishte, por jo mësues, pedagog dhe as prind.

Kuptova që përgjigjja ishte përgatitur në të tjera zyra dhe ai ishte personi më i përshtatshëm për ta zbatuar. Kishte përballë një vajzë të re, që nuk kërkonte asgjë më tepër se t'i jepej mundësia të studionte e qetë, larg së keqes, larg përndjekjes, larg injorancës me të cilën po përballej, për më tepër atë ditë që po i vihej vula gjithçkaje.

– Dakord, përgjigjem unë, - pa u menduar aspak dhe e çliruar nga një barrë e rëndë që po më rëndonte

prej kohësh, pavarësisht që këtë vendim nuk e kisha parashikuar.

Menjëherë kuptova që gjithçka ishte e përgatitur për çdo përgjigje nga ana ime. Nëse do të këmbëngulja që me rregullore meritoja degë tjetër, sikurse dëgjova më vonë, vendimi do të ishte që meritoja të mos shkoja as në atë shkollë, por të dënohesha me punë korrektonjëse në fshat për edukim.

Fakti që përmenda vetëm arsyen e përndjekjes, me pasojë shëndetin tim, i vetmi dënim mbetej të mos ndryshoja degë, por vetëm shkollën. E çliruar për vendimin e marrë dhe, me një lloj përbuzje për qëndrimin e të gjithë pjesëmarrësve të zgjedhur aty, mora drejtimin për t'u larguar, kur drejtori vazhdon: - Sa për raportin mjekësor, do ta verifikoj personalisht.

Hedh vështrimin e fundit si në një hapësirë boshe, ku dallova vetëm Sekretarin e Partisë, duke vazhduar të mbante shënime që duhej t'i raportonte së shpejti te Sekretari i Parë, por edhe tek i dyti, kolegu i tij i zyrës, P., roli i të cilit ishte i padiskutueshëm në këtë skenar të turpshëm.

- Keni të drejtën tuaj të verifikoni çfarë të doni, por ju lutem të mos vononi dërgimin e dokumenteve të mia në Tiranë, - përgjigjem unë dhe largohem me shpejtësi për të mos u kthyer më në atë ambient keqdashës.

E gëzuar, e çliruar së fundmi, vrapova drejt e te puna e mamasë për t'i dhënë lajmin e gëzuar, megjithëse të paparashikuar. Pas kësaj shkova në shtëpi, ku lajmi u prit me kënaqësi për të vetmen arsye që do të shpëtoja nga e keqja e pashmangshme që do të më shoqëronte në atë ambient dhe që unë ndihesha mirë.

Së fundi, po më jepej mundësia të studioja e qetë në lirinë dhe qetësinë time.

Viti shkollor kishte filluar, por do të më duhej të prisja edhe tri javë të tjera, deri sa të dërgoheshin dokumentet e mia, pasi drejtori të merrej me verifikimin e raportit mjekësor. Më vonë dëgjova që nuk pati kohë të merrej më gjatë, pas një incidenti të një studenti që kishte bërë vetëvrasje, dhe ai, siç diskutohej, kishte përgjegjësi në atë rast.

REALIZIMI I ËNDRRËS

Nisem për në Tiranë pas njoftimit për transferimin e dosjes dhe shkoj të regjistrohem drejt e në Fakultetin e Agronomisë në ILB, Kamëz. Me shumë dashamirësi më pret sekretarja e administratës, një grua elegante, veshur me rroba të zeza, që shprehte thjeshtësi, mirësi dhe përkushtim, e cila i bëri pa vonesë veprimet në mënyrë që të filloja mësimin sa më parë.

Filloj të marr leksionet e para në Fakultetin e Agronomisë, ku më duhej të jepja edhe disa seminare që shokët e kursit i kishin dhënë gjatë kohës që unë kisha munguar. U ndjeva shumë mirë në atë grup, ku shumica ishin studentë nga Tirana, sepse të tjerët i merrte Korça. Ishin studentë të mirë, me të cilët u përshtata shumë shpejt dhe ambienti ishte i tjetër niveli në krahasim me atë të Korçës.

Këtu, mendova, përfundoi ëndrra për ndërrimin e degës. Isha e kënaqur që shpëtova nga kthetrat e *personit* që nuk do ta harronte qëndrimin tim dhe diskriminimin e tij në opinion. Megjithatë, ai vazhdoi ngjitjen në karrierë, sepse pas pak kohe u dëgjua lajmi i emërimit të tij Sekretar i dytë Partie në Komitetin e Partisë, në Tiranë, përgjegjës për Sektorin e Arsimit dhe Kulturës. Me sa dukej, Partisë i duhej në botën e *artistëve* një njeri i *atij profili*, në atë post ku do të qëndronte për shumë vite deri në kohën e ndryshimit të Sistemit.

Nuk kisha më as vëmendjen dhe as kohën të mendoja për atë histori që e quaja të kaluar. E merituar

ishte mbyllja, kur rastësisht, pas shumë vitesh, do të më takonte dhe do të më zgjaste dorën për të më përshëndetur. Nuk mund të merrte përshëndetje, përveç fjalëve të mia:

- Ju nuk meritoni t'ju jap dorën! - Nuk pati asnjë reagim veç heshtjes, me gjithë praninë e disa miqve përreth.

E rikujtova atë ngjarje, kur në një bisedë me një mikun tim, më tregon se si ish drejtori i kish pohuar pa asnjë lloj ndrojtje, se vendimi i tij për degën time të studimit, kishte qenë hakmarrja për shkak të refuzimit tim, e konsideruar prej tij si ngjarje e rrallë mes të tjerash. Imoraliteti nuk mund të mos pasohet nga vese të tjera, të cilat kishin kompletuar figurën e një *anëtari të dedikuar të Partisë së Punës*, në atë kohë, që morri përgjigjen e merituar nga unë jo vetëm nga refuzimi, jo vetëm nga ofendimi gjatë përshëndetjes, por edhe nga rehabilitimi i së drejtës sime.

Qëllimi mbetej të vazhdoja me ritmin tim studimet në atë degë që tani më në fund e quaja si fatin tim e që duhej t'i bindesha. Vendosa të përpiqesha të harroja çfarë kishte ndodhur deri në atë moment dhe të përqendrohesha në fillimin e një jete të re për mua.

Së pari, të filloja ta doja atë profesion që për arsye të ndryshme nuk e kisha pranuar deri në atë moment. Së dyti, të shijoja faktin që aty isha si të gjithë studentët e tjerë dhe të vazhdoja të ruaja atë mënyrë qëndrimi, për të shmangur të rënit në sy, pasojat e të cilit i kisha vuajtur deri në atë kohë. Ky lloj ripozicionimi kishte filluar të jepte efektet e para në ndjesitë e reja pozitive, në atë mjedis të ri me të cilin ndieja se u familjarizova shpejt.

Kishin kaluar dy javë të ngarkuara, duke dhënë detyrimet e prapambetura dhe ndihesha shumë e kënaqur me rezultatet, kur befas përballem me një të papritur. Isha duke dalë nga auditori i leksioneve, kur më takon sekretarja, për të më njoftuar se kërkonte të më takonte zëvendësrektori i ILB, S. Hysi.

E çuditur dhe paksa e frikësuar pas ndodhive të mëparshme, shkoj në Rektorat, ku me shumë takt dhe dashamirësi më shfaqet një burrë rreth të pesëdhjetave, me flokë të thinjur, që ia shtonin fisnikërinë një portreti serioz. Pamja dhe sjellja e tij më qetësuan paksa. Pasi më ofron një karrige për t'u ulur, më thotë:

- Pashë dosjen tënde të transferimit dhe dua të di se çfarë ka ndodhur me ty që shpërngulesh këtu në të njëjtën degë studimi. Nuk e di nëse ka qenë zgjedhja jote kjo, sepse me Rregullore të posaçme, me rezultatet që shoh, meriton Medalje të Artë dhe zgjedhje të degës.

- E vërteta është që po vij e detyruar pas shumë përpjekjesh për të ndryshuar degën, gjë që rezultoi e pamundur. Tani ndihem shumë e lodhur, sepse është histori e gjatë, paksa e ngatërruar edhe për ta shpjeguar. E rëndësishme për mua tani është të ndihem e lirë dhe e qetë për të vazhduar studimet këtu.

Ishte e vërtetë që në ato momente nuk doja të kujtoja *odisenë* e ngjarjeve që kisha kaluar dhe ai që e kuptoi këtë, respektoi dëshirën time dhe nuk nguli këmbë për të ditur më tepër.

- E di që ke të drejtën të zgjedhësh këtu tjetër degë studimi, sipas rregullores? - më drejtohet me një buzëqeshje që shprehte dashamirësi dhe paksa keqardhje.

- Po, e di, por më duket e pamundur të realizohet tani, - përgjigjem me ndrojtje dhe dyshimin nëse mund të më jepej kjo mundësi.

- Është e mundur, nëse do të bësh një kërkesë për degën që dëshiron, por duhet të kesh parasysh vetëm fakultetet brenda ILB, për të cilat ne si Rektorat kemi të drejtë të vendosim, - vazhdon të më sqarojë, duke më lënë të shpresoj që për Rektoratin do të ishte një vendim miratues.

E çuditur, e ngazëlluar, e emocionuar që po provoja se ekzistojnë edhe njerëz të mirë dhe të arsyeshëm që mund të të ndihmojnë. E falënderoj me shumë mirënjohje për atë sjellje dhe gjest fisnik ndaj meje dhe duke u larguar i premtova që shumë shpejt do të vija të dorëzoja kërkesën.

Pa humbur kohë, marr të dhëna mbi degët e tjera, ndër të cilat ndjeva më të përshtatshme degën e inxhinierisë pyjore. Lëndët që zhvilloheshin në atë fakultet dhe që gjenin zbatim edhe në praktikë, në profilin e punës ku do të punoje, kishin të bënin me trajtimin e pyjeve, me gjelbërimin e qytetit dhe me përpunimin e drurit. Më intrigoi veçanërisht lidhja me Pyllin, që e kishte zanafillën në fëmijërinë time, në shëtitjet aq të këndshme në natyrë së bashku me motrën dhe babain që na shoqëronte; më pas në vitet e bukura të rinisë, në shëtitjet dhe ekskursionet me shoqet dhe shokët e shkollës në kodrat e veshura nga pyjet e gjelbëruar që formonin dikur kurorën e gjelbër të qytetit tonë të dashur. Lëndët mësimore përbënin një ndërthurje të lëndëve të shkencave të natyrës, ku e gjeja më së miri veten. Veçanërisht Silvikultura dhe Gjelbërimi ishin

ato që më ngjallën menjëherë dëshirën për të vazhduar në atë fakultet.

Ndërkohë më erdhi në kujtesë ëndrra ku e pashë veten në mes të luleve dhe mendova me vete që më në fund po më buzëqeshte fati. (Që prej kësaj kohe kisha filluar t'i vëzhgoja me vëmendje të veçantë ëndrrat si mesazhe paralajmëruese për sa do të më ndodhte më pas). Të nesërmen shkoj në Rektorat për t'i dhënë kërkesën zëvendësrektorit S.Hysi, i cili më priti me po atë dashamirësi si herën e parë dhe pasi morri letrën në dorë, më premtoi që vendimi do të merrej që të nesërmen në mbledhjen e Rektoratit.

- Vetëm duhet të kesh parasysh një gjë, - shtoi - që vendimi hyn në fuqi për zbatim, pasi të miratohet nga Ministrja e Arsimit.

Nuk do të harroj përgjatë gjithë jetës respektin që më imponoi ai njeri, aq dashamirës me mua, ndërkohë që opinioni për atë ishte si një person tepër i rreptë, lidhur me ndryshimin e degëve midis fakulteteve brenda ILB. Në fakt, më la të kuptoja që duhej të ishte i rreptë kundrejt padrejtësisë dhe këmbëngulës për të mbështetur të drejtën dhe ligjin. Në shenjë mirënjohje, kërkova ta takoja pas shumë vitesh dhe ndjeva shumë keqardhje kur dëgjova që kishte ndërruar jetë. Ndodh shpesh që koha pamundëson realizimin e dëshirave tona..

Odiseja vazhdonte. Njëkohësisht unë vazhdoja rregullisht studimet në atë fakultet, sikur nuk prisja të ndryshoja degë, gjë që e tregonin vlerësimet maksimale. Kalonin ditë që po bëheshin javë dhe më pas muaj pa përgjigje, aq sa shpresat ishin venitur dhe

nuk po shpresoja se mund të merrja ndonjë përgjigje pozitive.

E vetmja shpresë ishte se nuk ishte kthyer as përgjigje negative dhe një zë i brendshëm më thoshte që duhej të prisja.

Ishte data 18 dhjetor e vitit 1977, ditë e shtunë, (në atë kohë edhe e shtuna ishte ditë mësimi dhe pune) dhe duhej të shkoja në leksion si zakonisht. Nuk ndodhi kështu, sepse fati ruan edhe surpriza të lumtura, që ndryshojnë krejtësisht rrjedhën e ngjarjeve. Një ëndërr e çuditshme më zgjon në orën pesë të mëngjesit. Në ëndërr gjendem pranë një oxhaku, ku më shfaqet një grua me shami në kokë dhe me një filxhan kafeje në dorë, që po shihte fatin tim; fshin filxhanin e kafes me dorë, nxjerr llumin e kafes prej andej dhe e hedh në prushin flakë të kuq të oxhakut, përreth të cilit ishim ulur të dyja.

- *Këto janë të këqijat që ke hequr, moj bijë, tani prit vetëm të mira!* - Këto ishin fjalët e saj dhe tingëllimi i një kambane më zgjon nga gjumi. Ishte herët në mëngjes, por nuk munda të flija pas kësaj ëndrre që më bëri të shpresoja se diçka do të ndodhte atë ditë.

Filxhani i kafes në ëndërr më kujtoi një mikeshë që na kishte ardhur për vizitë në shtëpi një ditë gushti, para se të dilnin të drejtat e studimit, vitin e kaluar dhe më thotë ta ktheja filxhanin e kafes pasi të pija kafen. Nuk e besoja fallin e filxhanit, megjithëse shpesh herë fjalët profetike na joshnin dhe nuk ia prisha mikeshës. Duke parë filxhanin, midis të tjerash, më thotë që do të merrja një lajm *me kokë të prerë* dhe do të kisha ndërprerje të shkollës. E vërteta është që nuk e besova, por nuk kaloi

pa e kujtuar, kur vërtet lajmi ishte si prerje koke dhe e kujtuam më vonë me shoqen time të afërt Vasilikën, që ishte ndodhur në shtëpinë time dhe mbante mend çfarë mikesha na kishte thënë të dyjave.

Ndieja se isha bërë supersticioze, por tashmë nga faktet dhe jo nga dëshpërimi. Me parandjenjën që diçka mund të ndodhte atë ditë, nuk shkoj në leksion, por përgatitem të marr urbanin për të shkuar në Ministrinë e Arsimit, nga pritej përgjigjja e vonuar. Mendova se kisha të drejtën të pyesja për përgjigjen mbi kërkesën e Rektoratit mbi miratimin e ndryshimit të degës sime të studimit.

Shkoj te nëpunësi i shërbimit, të cilit i them emrin dhe arsyen për çfarë kisha shkuar, i cili pasi flet me dikë përtej receptorit, duke i thënë emrin tim, më drejton për të shkuar te Drejtoria e Arsimit të Lartë. Nuk mbaj mend si i kam ngjitur shkallët. Më në fund do të merrja një përgjigje nga ato zyra, nga njerëzit që punonin aty, nga të cilët do të varej gjithçka do të ndodhte pas kësaj. Kishin kaluar një vit e tre muaj dhe tri javë dhe ndjeva se kishte ardhur momenti kur problemi im do të merrte zgjidhje.

Me emocione nga më të jashtëzakonshmet e jetës sime, trokas në derë, ku një zë gruaje më thotë të hyja. Një grua simpatike, me flokët ngjyrë gështenjë të mbledhura prapa kokës, (Valentina më kujtohet emri i saj), pasi më shikon me vërejtje nën syze, më pyet nëse unë isha vetë Zh. Vreto. Më pas vazhdon të pyesë:

- Është e vërtetë që të pëlqente për zgjedhje dega që ke kërkuar?

- Po, përgjigjem unë e ndrojtur, me frikën se mund të

mendonte edhe kjo *punonjëse e rëndësishme e ministrisë*, që e urreja profesionin e agronomisë.

- Të pyes, sepse është bërë një gabim nga Seksioni i Arsimit në Korçë. (faj..! mendova unë në çast). Çështja jote është adresuar që vitin e kaluar nga ministrja vetë dhe për ty ishte rezervuar dega Juridik. Një komision ka shkuar në Korçë për të verifikuar çfarë kishte ndodhur, prandaj dhe u vonua përgjigjja. Dega juridik e autorizuar për ty këtë vit, i është dhënë një nxënëseje tjetër. Kjo ishte arsyeja pse u vonua përgjigja për ty. Çfarëdo dege, edhe jashtë ILB të kishe kërkuar, do të miratohej nga ministrja. Tani shko të marrësh përgjigjen në ILB, është dërguar dje me postë. Suksese! - vazhdoi ajo, me një shikim që nuk e kuptova çfarë fshihej mbas tij, ndërsa unë, duke e falënderuar me shumë emocione, nxitova të dilja.

Me vrap arrita të kap urbanin për në Institut dhe më pas nxitova për në postë, ku pyes postierin nëse ishte shpërndarë posta e djeshme. - Tani do ta shpërndaj, - përgjigjet ai dhe unë i lutem që të shkojmë së bashku në Sekretarinë e Administratës për të çuar zarfin e dërguar nga Ministria e Arsimit.

Emocione të jashtëzakonshme në momentin e hapjes së zarfit, ku lexoj direkt miratimin për ndryshimin e degës nga Agronomi në Inxhinieri Pyjore, firmosur nga vetë ish-ministrja T. C.

Bashkëngjitur me këtë ishte edhe një tjetër vendim, që nuk e miratonte kërkesën e bërë për një vajzë, e cila për arsye shëndetësore kishte kërkuar të ndryshonte degën nga veterinari në ekonomik. Ndjeva keqardhje për atë vajzë që e kisha njohur rastësisht dhe më kishte

thënë që edhe ajo priste të ndryshonte degën, sepse vuante prej problemesh shëndetësore në zemër; por unë e dija sa vështirë ishte të plotësohej dëshira për të studiuar aty ku dëshiroje.

Së fundi, u ndjeva e plotësuar pas shumë ngacmimesh, shqetësimesh, intrigash dhe rreziqesh njëkohësisht. Arrita të mbijetoj në mënyrën më të mirë të mundshme për kushtet. Kënaqësia ishte e përmasave të papërfytyrueshme, pas të gjitha atyre peripecive dhe stërmundimeve, që tani do t'i takonin së shkuarës.

Veprimi i parë ishte dërgimi i një telegrami për të njoftuar familjen për vendimin e sapomarrë. Më pas shkova për të blerë ëmbëlsira në dyqanin më të afërt, me të cilat falënderova Anifen, gruan e mirë të sekretarisë dhe qerasa shoqet. Në realitet nuk isha e kënaqur, por isha e lumtur. Ndoshta më e lumtur sesa po të kisha fituar me të drejtën e zgjedhjes degën e inxhinierisë elektronike, që kisha preferuar paraprakisht.

Më kishte pëlqyer dikur edhe mjekësia, por kisha ndryshuar mendim që prej përvojës së konkursit të dikurshëm të anatomisë. U ndjeva e lumtur që më në fund, pas një beteje të pabarabartë, triumfoi e drejta dhe merita...u ndjeva e lumtur që m'u dha mundësia të studioj në atë degë që më bën të ndihem krenare sot për çka studiova dhe kontribuova...isha e lumtur që në mënyrë dinjitoze u ndjeva katërcipërisht e plotësuar. Shumë shpejt kuptova se po studioja në një nga degët më të bukura, më të dashura, më afër jetës njerëzore dhe në shërbim gjithëdimensional për njerëzimin. Nëse do ta filloja nga e para, me siguri do të zgjidhja të studioja Shkencën e Pyjeve. Kuptova se që të studiosh Shkencën

e Pyjeve do të thotë të fitosh njohuri mbi bazën e jetës së njeriut dhe ta duash më shumë Natyrën, si pjesë e rëndësishme e Jetës.

Jo të gjithë e kuptojnë në brendësi rëndësinë e Shkencës Pyjore. Të gjithë e shijojnë ajrin e pastër, ujin, fuqinë e tokës, shtëpitë, ngrohjen pranë oxhakut, mobiliet gjithandej në shtëpi, zyrat e kudogjendura, frutat e pyllit.. të gjithë marrin medikamente popullore dhe farmaceutike, prodhime të kozmetikës, shijojnë kënaqësinë e një shëtitjeje në pyll, kafshët, shpendët e pyllit, bimët e shumëllojshme të pyllit. Të gjithë gëzojnë të mirat ekonomike nga pasuritë e shumta që zotëron pylli, por jo të gjithë e kuptojnë se në mungesë të tyre, domethënë pa Pyll do të mbizotëronte shkretëtira dhe nuk do të kishte Jetë mbi Tokë.

Edhe unë, me gjithë dashurinë dhe afërsinë që ndieja deri atëherë për Natyrën në përgjithësi dhe Pyllin në veçanti, nuk e kisha parë Pyllin me atë vizion që më rrëmbeu shumë shpejt për të më mbajtur fort përgjithmonë.

Fillova e lumtur studimet në Fakultetin e Pyjeve më 20 dhjetor, në një kurs me 16 djem dhe vetëm unë vajzë, një veçanti me të cilën u përshtata shpejt. M'u desh të përgatisja me shumë kënaqësi seminaret dhe kolokiumet që kishin dhënë tashmë bashkëstudentët e kursit. I vura qëllim vetes që deri në fund të dhjetorit të shlyeja të gjitha detyrimet e prapambetura, ku dëshira dhe pasioni ishin shtysat kryesore për t'i mbyllur të gjitha detyrimet sipas parashikimit dhe me vlerësime maksimale.

Në atë fakultet më dukej gjithçka ndryshe, duke filluar nga ndërtesa që ishte një ndërtesë e hershme dhe

me histori, e ruajtur më së miri në atë kohë. Pedagogët gjithashtu, ku një pjesë e mirë e tyre kishin studiuar jashtë shtetit dhe mbartnin njohuri dhe sjellje të botës ku kishin studiuar; ambienti gjithashtu, me shokët e kursit, ku ndihesha e respektuar nga të gjithë dhe sigurisht respekti ishte i ndërsjellë.

Duke qenë e vetme, ndihesha edhe paksa e privilegjuar dhe mirënjohëse për sjelljen e mirë të atyre shokëve ndaj meje, deri në mbarim të Fakultetit dhe më pas. Isha kaq shumë e kënaqur, sa nuk u tundova as kur në fund të vitit të parë më takoi dekani i fakultetit, profesori i respektuar A. Reka, i cili pasi më përgëzoi për rezultatet e provimeve, me dashamirësi më pyeti:

- Nuk pate ndonjë mik të ndërhynte për një bursë jashtë shtetit? (atë vit pati bursa për studentë që kishin mbaruar vitin e parë me rezultate shumë të mira, por që *nuk mjaftonin*, besoja).

- Nëse do të kisha mik, nuk do të vija në Agronomi dhe për pasojë as këtu, ku jam shumë e kënaqur, - u përgjigja unë paksa me keqardhje, por e kënaqur për sa kisha arritur deri në atë moment.

Duke më përgëzuar shtoi në formë ngushëllimi se edhe në këtë fakultet do të kishte mundësi për ecuri në perspektivë. Nuk mund të pretendoja për ëndrra të pamundura.. më vonë dëgjova që kishin fituar bursë për jashtë shtetit bashkëmoshatarë me mesatare më të ulët, por që ishin nga *familje me biografi që Partia mendonte se meritonin që fëmijët e tyre të studionin jashtë shtetit*.

Pa asnjë lloj tundimi, kënaqësia e studimeve në atë fakultet më shtohej në vazhdimësi. Përveç studimit, një kënaqësi e veçantë ishin praktikat mësimore në pyje,

që na jepnin mundësinë të njihnim nga afër pyjet dhe natyrën e bukur të vendit tonë. Nuk mund të harroj kënaqësinë përballë pyjeve madhështore me drurët gjigantë të Pukës, që të çonin në një tjetër botë përtej reales (fatkeqësisht kanë mbetur vetëm në kujtesë, sepse ato pyje nuk ekzistojnë më në ditët e sotme).

Ishte bukur të njihje një peizazh të rrallë, marramendës për nga ndërthurja e rrallë e të gjitha nuancave të ngjyrës së gjelbër, që krijonin kombinimet e drurëve të ahut dhe bredhit dhe e gjithë bimësia që i shoqëronte.. ngrije kokën drejt qiellit dhe harroje që kishte qiell.. duhej vetëm ta përfytyroje pas kurorave të pleksura natyrshëm me njëra-tjetrën.

Ishte bukur të shijoje mrekullinë e natyrës së virgjër, por edhe një jetë ndryshe të njerëzve të thjeshtë, të lidhur përjetësisht me Pyllin, në atë kohë kur shpërnguljet e tyre ishin të rralla, për të mos thënë të pamundura. Të varfër, por jo nga shpirti...ngado na përshëndesnin me dashuri, të cilën e ndjemë deri në sofrën e tyre për tokë, kur na ftuan në familjen e një shokut tonë, me mishin e siguruar posaçërisht për ne, megjithëse bagëtitë personale *ia kishin dhuruar* kooperativës.

Kënaqësi e veçantë ishte edhe ushqimi në mensën e punëtorëve të sektorit pyjor në zonën e Pukës. Shpesh kur dëgjoj të flitet për *ushqimin bio* më vjen ndërmend vetëm ai ushqim në kuptimin e vërtetë të fjalës "bio"... prodhime të natyrës së egër, aq të dëshiruara dhe të papërsëritshme në ditët e sotme. Efektin e atij ushqimi, por gjithashtu edhe të ajrit dhe ujit të pijshëm, që nuk mund të harrohen lehtë, e vërtetonin komplimentet e miqve për pamjen e ndryshuar vetëm pas një muaji.

- Ishte mosha mbi të gjitha e bukur, - më thotë shpesh im shoq, kur përmend kujtime me kënaqësinë e provuar në mes të natyrës së egër sa të rrallë, aq edhe të bukur, gjithashtu edhe ushqimin e freskët dhe të këndshëm, të papërsëritshëm që na shtonte kënaqësinë.

Jam e bindur që ishte edhe mosha e bukur, gjë që shprehej deri në indiferentizmin tonë për kushtet e vështira të higjienës së mjedisit ku rrinim dhe flinim. Në praktika ndodhte të ishim dy vajza, meqenëse praktikat zhvilloheshin së bashku me vitin më lart nesh dhe atje ishte vetëm një studente. Mbaj mend që flinim me Vanthikën në një të ndarë të një barake, ndërtuar për punëtorët e sektorit pyjor, ku nuk kishte banjë dhe mundësi për dush. Laheshim me ndonjë enë me ujë që nuk më kujtohet se ku e ngrohnim ujin dhe si laheshim..Kujtesa bën seleksionimin e kujtimeve duke ruajtur mbresat më të thella, më të bukura, por edhe më të këqijat ndonjëherë. Fakti që nuk ka mbetur në memorie kjo pjesë, do të thotë se jetesa pranë pyllit, në gjirin e natyrës ishte aq marramendëse, sa vështirësitë janë fshirë nga kujtesa.

Përveç praktikave në pyll, që shtonin kënaqësinë e jetës studentore, dy vitet e fundit ishin edhe një lloj çlirimi nga ideja e ngulitur e dëshirës, por edhe e stresit, *për të mos lëvizur nga nota dhjetë*, të cilat kishin mbushur librezën e notave. E dashuruar me Pyllin dhe me idealizmin e moshës, nuk e doja prerjen e pyjeve, duke menduar se edhe një pemë e prerë pakëson oksigjenin që na dhuron (edhe pse isha e ndërgjegjshme për domosdoshmërinë e shfrytëzimit të pyllit). Kjo

ishte arsyeja që bëja diferencimin e lëndëve më të parapëlqyera nga ato më pak të pëlqyerat.

Gjithashtu, kjo ishte arsyeja që pas mbarimit të Fakultetit e prita me shumë kënaqësi emërimin në Ndërmarrjen e Pyjeve në qytetin tim të dashur në Korçë, si inxhiniere pyllëzimi.

Pas stazhit në këtë ndërmarrje, në ceremoninë e dorëzimit të diplomave për studentët e dalluar, për rastësi takohem me ministren e kohës,T. C., së cilës i takoi rastësisht të më dorëzonte diplomën. Doja ta përqafoja dhe ta falënderoja në veçanti për ndikimin që pati në atë drejtim që ndryshoi studimet dhe jetën time, por protokolli dhe pozicionimi im si një studente e thjeshtë, paksa e ndrojtur para ministres, nuk më lejonte që t'ia shprehja si duhet mirënjohjen në momentin e marrjes së diplomës. Njëkohësisht besova se ministrja në fjalë kishte kryer vetëm detyrën dhe nuk do mundte të kujtonte rastin tim.

Rreth ministrave të kohës së diktaturës ka pasur *komente* nga më të ndryshmet, por sjellja e saj në këtë rast tregoi për një titullare që diti të vinte në vend të drejtën time të munguar.

Ishte shans në atë kohë që emërimi në ndërmarrje të përkonte me dëshirën që unë të emërohesha së pari në qytetin tim të dashur, në Korçë dhe më pas të bashkëpunoja me specialistë, jo vetëm të përgatitur, por edhe qytetarë, që reflektonin dashuri dhe përkushtim për mbarëvajtjen e pyllit. Bashkëpunimi me inxhinierin e respektuar S.Plasa ishte një bashkëpunim tepër i frytshëm, që ndikoi shumë në hartimin e projektit të diplomës në fushën e pyllëzimeve dhe të mirëpërgatitur,

që u reflektua në vlerësim si një projekt i përditësuar me të rejat e shkencës pyjore. Ing. Plasës nuk do t'i mungonte humori kur unë sugjeroja ndonjë të re nga konsultimi me literaturën e kohës.

- Nuk do të vrasim mendjen për formulën e mbjelljes tani që do të na e nxjerrë kompjuteri, - shprehej me humor, kur për herë të parë do të futej në diplomën time një metodë bashkëkohore, (rezultat i një programimi informatik) në formulën e llojeve përbërëse në metodën e pyllëzimit. Kishte të drejtë ing Plasa të shprehej në atë mënyrë, sepse ai i kishte në mendje formulat e pyllëzimit në ato zona që i njihte mirë mbas shumë viteve eksperience dhe kontributi në pyjet e Korçës. Megjithë diferencën e moshës midis nesh, ishte kënaqësi e veçantë komunikimi me atë inxhinier të nderuar, (tani një kujtim i paharruar) që edhe humorin do ta bënte pjesë të pandarë të punës së përbashkët.

PRANË PYLLIT

Pas mbrojtjes së diplomës, fillova punën në po atë ndërmarrje ku bëra edhe stazhin, me emërim si inxhiniere në Sektorin e Pyjeve, me qendër në Rezervatin e Gjuetisë Cangonj. Ishte hera e parë që shkova në atë zonë dhe në ato pyje aq mbresëlënëse. Pylli i Cangonjit ishte Rezervat Gjuetie natyrore, ku përveç pyllit mirëmbaheshin edhe kafshët dhe shpendët e egra. Ishte kënaqësi e jashtëzakonshme të punoje dhe të shijoje atë natyrë të mrekullueshme, ku përvëç pyjeve do shijoje edhe botën e gjallë, për të cilat tregohej kujdes i veçantë për mirtrajtimin dhe shtimin e tyre. Edhe tani ndjej emocione nga kujtimet kur sodisja Samiun, rritësin e gicave të egër me biberonin e qumshtit në dorë që përpiqej të mos harronte asnjërin pa i afruar biberonin.. të paharrueshme skenat kur të vegjlit përpiqeshin rreth atij njeriu aq të dashur për ta, të kapnin biberonin dhe më pas ushqimin, të cilin ua shpërndante me shumë kujdes dhe dashuri. Ky ritual vazhdonte deri sa të bëheshin të aftë për t'u vetushqyer në pyll, që do të bëhej streha e tyre e ardhshme dhe do t'i shtonin vlerat atij Rezervati.

Diktatura, me gjithë dëmet që u shkaktoi pyjeve në reduktimin e sipërfaqes, në favor të bujqësisë, ishte e interesuar t'i mirëmbante pyjet, për të ardhurat financiare që merrte prej tyre. Kjo ndihej në kërkesën e llogarisë ndaj personelit dhe përkushtimin për mbrojtjen e kontrollin e ushtruar në veprimtarinë e Sektorit

Pyjor. Veçanërisht ndihej ngarkesa dhe përgjegjësia në punë gjatë muajve të fushatës së pyllëzimeve. Kishte mobilizim të veçantë për kryerjen e pyllëzimeve, sipas planit të ministrisë dhe fondeve të akorduara nga qeveria për atë qëllim, gjë që ndihej veçanërisht kur vinte kontrolli i ndërmarrjes, që ishte tepër rigoroz dhe nuk falte shkelje të asnjë lloji.

Nuk mund të harroj inxhinierin e nderuar S.Plasa me çizmet e përhershme në këmbë, që do të ishte prezent aty gjatë gjithë kohës së fushatës së pyllëzimeve. Po aq e përkushtuar ishte bashkëshortja e tij, Izmini, edhe ajo inxhiniere pyjesh, dikur pedagoge dhe më pas një kontribuese e shquar në sektorin e shfrytëzimit të pyjeve në qytetin e Korçës. Përveçse inxhinierë ishin qytetarë të përkushtuar ndaj natyrës dhe vlerave të saj.

Gjithashtu nuk mund të mos kujtoj përgjegjësin e kontrollit, A.Grabocka, njeri tepër korrekt, që nuk besoj të ekzistojë një i ngjashëm sot, për nga rigoroziteti gjatë kontrollit, deri në detaje.

Në kohë ngarkese, orari i punës mund të shkonte edhe dhjetë apo dymbëdhjetë orë dhe punohej në kushte të vështira atmosferike, sepse fushata e pyllëzimeve përkonte me periudhën e dimrit.

Ndodhte shpesh të hapja unë rrugën nga dëbora e pashkelur që herët në mëngjes, nga zyra ime buzë rrugës, drejt Stacionit të Pyjeve pranë pyllit. Nuk do t'i shpëtoja edhe ndonjë rrëzimi të rastit, që më bënte të qeshja me veten, në mes të kënaqësisë që më jepte pamja marramendëse e Rezervatit të Gjuetisë, ku dëbora mbulonte gjithçka dhe bardhësia sundonte me hijeshi përkohësisht mbi gjelbërimin e pyllit.

Ishte tërheqës ai sektor, jo vetëm për natyrën, por edhe për Stacionin e Pyjeve, në formën e një vile ngritur buzë pyllit para kohësh, falë kontributit të ish-drejtorit të asaj ndërmarrje, njëkohësisht shkrimtarit të nderuar M. Kallamata. Për z. Kallamata ish-kolegët e mi ruanin kujtimet më të mira për kontributin dhe përkushtimin e tij në mbarëvajtjen e pyjeve në atë ndërmarrje. Me nismën e tij, Stacioni i Pyjeve në Rezervatin e Cangonjit ishte kthyer në një qendër pritëse të mobiluar më së miri për vizitorët e rastit, që të çlodheshin këndshëm pas një shëtitjeje në pyll.

Por më vonë (në kohën e luftës kundër liberalizmit), kjo ishte konsideruar si *shenjë borgjezimi* dhe me *urdhër* nga lart ishin hequr të gjitha mobiliet dhe pajisjet, duke lënë veç oxhakut, vetëm një tryezë dhe disa karrige përreth. Me të drejtë ish-kolegët e mi e kujtonin me nostalgji atë qendër pritëse vizitorësh, së bashku me ish-drejtorin e respektuar M.Kallamata.

Ishte natyra e bukur përreth dhe në çdo kohë që më bënte të ndihesha mirë, së bashku me njerëzit me të cilët punoja. Në praninë e tyre ndihesha mirë dhe e kënaqur, pavarësisht lodhjes së punës, përgjegjësisë e të tjera vështirësi që ishin të pashmangshme. Një ditë, më thotë vjehrri i motrës (një burrë i respektuar, nga njerëzit e pushtetit, por edhe dashamirës ndaj meje dhe jo vetëm), se mund të më ndihmonte të shpërngulesha në zyrat e ndërmarrjes, në qendër, në Korçë. Ai u çudit paksa kur, pasi e falënderova, i thashë se isha e kënaqur të vazhdoja punën aty ku isha, kurse burri i motrës, Kiu, më pyet:

- Do të vazhdosh gjithë kohën me urban?

- Në urban kënaqem në shoqërinë e shoqeve, - vazhdoj unë dhe këtu mbyllet biseda, se Kiu nuk kishte nevojë për më shumë shpjegime.

Ishte e vërtetë kjo, sepse gjatë rrugës me urban, ishin të këndshme bisedat me Bertën (mësuese matematike, në Progër, tani një kujtim i paharruar), me Vjollcën ekonomiste që vinte më vizitonte shpesh, me Elin, Sofikën, (tani mësuese në SHBA), që bisedonim pa fund deri në stacionin e urbanit, ku më pas do të shkonim secila në punën e vet. Pastaj fillonte dita intensive dhe e përgjegjshme e punës me emocione. Fillimisht do të punoja si inxhiniere në mbarëvajtjen e pyjeve të sektorit dhe më vonë si specialiste në fidanishten pranë atij sektori. Ishte fidanishte që furnizonte me miliona fidanë gjatë sezonit të pyllëzimeve, jo vetëm sektorët pyjorë të Korçës, por edhe të shumë rretheve të tjera të vendit.

Gjatë fushatës së pyllëzimeve, veçanërisht, shumëfishohej jo vetëm puna, por edhe përgjegjësia për realizimin e objektivave. Ballafaqimi me jetën e fshatit ishte një risi e paprovuar deri atëherë. Ishte ballafaqim me njerëzit e thjeshtë, punëtorë të palodhur, që ndiheshin të privilegjuar me të ardhurat që merrnin aty, në krahasim me të tjerët që punonin në kooperativë. Shihja gra me shami në kokë, që e kisha të vështirë ta përcaktoja moshën e tyre.. ishin gra të lodhura, që, pas punës së vështirë aty, i prisnin punët e shtëpisë, gatimet për familjen e të tjera si këto, sepse burrat e fshatit, sipas traditës, i prisnin nga gratë shërbimet e tjera në familje, pavarësisht punës që ato bënin gjatë ditës.

Ditët e para të punës ishin ditë të vështira të mbushura me emocione. Ishte e paimagjinueshme për

mua dhe nuk mund të arrija të kuptoja që një grua të mbante një thes me fidanë dhe t'i ngjitej malit për mbjellje, sepse ashtu ishte praktika e punës. Reagimi i tyre më bënte të kuptoja që edhe ato e ndienin shqetësimin tim. Shpesh nuk dija si të reagoja, sepse më duhej të isha rigoroze në kërkesën ndaj punës, për hir të detyrës, por në brendësi nuk ndihesha mirë dhe më dukej sikur bëhesha pjesë e mëkatit të sistemit që i trajtonte në atë mënyrë njerëzit e thjeshtë, veçanërisht gratë.

Vjen një ditë drejtori i ndërmarrjes, një burrë autoritar, që më parë kishte punuar kryetar kooperative dhe, për rezultatet e kënaqshme në atë punë, e kishin ngritur në detyrë si drejtor i Ndërmarrjes Pyjore (arsimimi dhe profesioni i tij nuk kishte lidhje me pyjet). Vinte shpesh aty, jo vetëm për kontroll, por edhe sepse te Stacioni organizoheshin shpesh *dreka me të ftuar nga Partia* dhe të tjera institucione të pushtetit dhe duhej të ishte i pranishëm për t'i *mirëpritur vizitorët*. Një *person i rëndësishëm* do të vinte edhe atë ditë për drekë. Në oxhak po piqej mish derri i egër, nga ata që rriteshin në Rezervatin e Gjuetisë, ndërkohë që dëbora kishte zbardhur gjithë mjedisin përreth. Ishte ditë e ftohtë dimri dhe unë u kisha dhënë leje punëtoreve të iknin në shtëpi, sepse nuk mund të punonin në ato kushte. Rregullisht duhej të qëndronin aty deri sa të mbaronte orari i punës, edhe kur nuk mund të punonin për shkak të kushteve të motit, por me dëshirën time shpesh i lija të iknin para orarit të punës. Në shtëpitë e tyre, mendoja, do të ishin më të dobishme sesa aty, kur nuk mund të punonin në të ftohtin acar. Qëndron

makina e drejtorit, pranë fidanishtes, zbret drejtori dhe pasi hyn në zyrë pa trokitur, më drejtohet hijerëndë, me tonin e tij të zakonshëm:

- Ku i ke punëtoret?

- I lejova të iknin, meqenëse nuk mund të punonin në këto kushte, - përgjigjem me ndrojtje dhe paksa e frikësuar për përgjigjen që mund të merrja.

Më ndodh ndonjëherë të përgjigjem e ndrojtur, si e zënë në faj, edhe kur nuk jam e tillë, ndërkohë që drejtori, me sigurinë e titullarit të kohës vazhdoi:

- E bën shpesh këtë gjë më duket, - duke më lënë të kuptoja që duhej të isha më e kujdesshme në zbatimin e rregullave të ndërmarrjes. - Ke bërë gabim dhe dua që punëtoret t'i gjej këtu në çdo kohë. Dhe ato librat, (vazhdoi duke treguar librat e hapura mbi tryezën e punës), nuk të duhen shumë këtu, apo do të shkosh të japësh ndonjë provim tjetër në Tiranë? Jemi në kohë fushate dhe duhet puna në terren jo me libra - dhe sa mbaroi fjalën doli nga zyra; në moment m'u kujtua pamja e tij kur firmoste lejen, që unë të shkoja në Tiranë për provimin pasuniversitar të radhës.

Përflitej që drejtori kishte dijeni të plotë për gjithçka ndodhte aty, sepse nuk mungonte *informatori*. Ishte Myfiti, një teknik pyjesh, anëtar partie, që me devocion vinte në dijeni drejtorin për gjithçka dhe mbahej aty si person që ia kishin frikën të tjerët.

Kisha kuptuar që edhe përgjegjësi i sektorit, Shaqiri (njeri tepër korrekt në punë dhe shumë i komunikueshëm me mua si edhe me punonjësit e tjerë), mesa kuptoja, *për arsye biografie* e kishte frikë Myfitin.

- Je shumë liberal me inxhinieren, - i thoshte ndonjëherë Myfiti, Shaqirit; - ndërsa me ne tregohesh i rreptë.

Shaqiri vihej në siklet para tij, se e dinte ku do të shkonte kallëzimi. Unë nuk e përfillja, në fakt, madje e shihja me humor, sepse nga fizionomia që kishte më dukej sikur më shihte Kapedani në filmin komik shqiptar, kur shikonte gratë me përçmim. Uniforma e pylltarit i jepte akoma më shumë *autoritet teknikut komunist*, që nga frika respektohej më shumë se përgjegjësi.

- Të kujtohet, - më thotë një ditë Vjollca, ekonomiste e ndërmarrjes (duke folur një ditë në telefon nga SHBA) - kur donim të flisnim lirshëm, dilnim në pyll, nga frika që të mos na dëgjonte Myfiti dhe kriste gazi kur e shihnim si krekosej para nesh. Kishte të drejtë të krenohej, i them, se ishte *komunisti Myfit Kapedani*.

- Pse nuk pranon të bëhesh anëtare Partie? - më pyet një ditë ish-kolegu im i respektuar, ing. S. Pllaha, që kishte dëgjuar se më kishin propozuar për t'u bërë anëtare e Partisë së Punës, por nuk kisha pranuar.

- Që të jem në një organizatë me Myfitin? - përgjigjem unë duke qeshur.

- Pikërisht, - më tha ai, me humorin e tij të zakonshëm, - të jesh e pranishme që mos të të spiunojë.

Ndihesha mirë kur do të më duhej ndonjëherë të shkoja në zyrat në qendër për punë, por edhe për bisedat dhe humorin mes kolegëve, veçanërisht me Tatianën, Vjollcën, Lilën, por edhe Stavrin, që shpesh bëhej pjesë e bisedave tona me humorin e tij.

Ishte gusht, kur shumica merrte lejen e zakonshme prej 2 javësh që ishte në atë kohë, por ishte urdhër nga

Ministria e Bujqësisë të mos jepej asnjë leje, sepse duhej të ishim në gatishmëri për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri. Të gjithë ishin vënë në siklet nga ky urdhër, veçanërisht ne që kishim planifikuar të kalonim pushimet në plazh në Durrës. Të planifikoje pushime në Durrës, duhej të siguroje prej kohësh autorizim për marrjen e një vile apo kabine. Zakonisht këto shpërndaheshin në institucione dhe kategoria e banesave të plazhit ishte në përshtatje me hierarkinë e institucionit. Kjo i detyronte njerëzit që shpesh të ftonin edhe të afërm në banesat që kishin mundësi të siguronin për periudhën e plazhit, me gjithë hapësirat e vogla që ishin të planifikuara për një familje. Kështu edhe unë i kaloja pushimet me familjen e kushëririt, Rodolfit, i cili punonte në Ministrinë e Ndërtimit në Tiranë dhe kishte mundësi të siguronte autorizim për vilë në plazhin e Durrësit. Kalonim pushime të këndshme veçanërisht me vajzën e tij Rezanën, sepse ishim mësuar me shoqërinë e njëratjetrës në vite. Rodolfi nuk do të përtonte të na sillte buzë detit mëngjeset e përgatitura për ne nga Kristina dhe kur e pyesnin gjatë rrugës, do u thoshte që i kishte për vajzat.

- Një apo dy vajza ke? - e pyesnin kur dyshonin që ai kishte vetëm një vajzë.

- Kam dy vajza përgjigjej Rodolfi dhe kështu unë isha bërë vajza e dytë e pushimeve.

Gjithçka ishte e rregulluar deri në momentin që urdhri i ministrisë do të anulonte lejet e zakonshme për shkak të gatishmërisë në mbrojtjen e pyjeve nga zjarri. Drejtori nuk mund të përjashtonte as gratë nga ky urdhër, sepse edhe gratë quheshin *forcë e madhe*

fizike në punë si shprehje e *emancipimit të gruas socialiste*, prandaj edhe nuk ma pranoi kërkesën për leje pushimesh, kur i shkova në zyrë.

Planin e kishim së bashku edhe me shoqen time të fëmijërisë, Marjetën, që do të shkonte te një e afërme e saj, por plazhin do ta bënim së bashku. Çfarë të bënim që të mos prishnim planin? Pasi biseduam me Rodolfin në telefon, vendosëm që të bisedonte ai me drejtorin nga zyra e ministrisë (edhe pse nuk ishte ajo e Bujqësisë nga varej ai). Rodolfi i paraqitet drejtorit si punonjës ministrie, dhe më pas i kërkon të mos më pengonte për lejen e zakonshme. Pa ngurruar, drejtori i premtoi që do të më lejonte dhe pasi më thërret në zyrë ai jo vetëm që më lejoi të shkoja, por u soll shumë më xhentil se pak minuta më parë..paksa qesharake kjo sjellje, por normale për njerëzit e pushtetit sipas hierarkisë së kohës..

U nisëm të lumtura drejt Durrësit së bashku me Marjetën, e cila ishte shpesh e pranishme në shoqërinë tonë në plazh. - Shtoja edhe një lugë gjelle me ujë dhe ndonjë gjë tjetër dhe dreka bëhej gati dhe për një mysafir më tepër, - do të kujtonte shpesh me humor Kristina, gruaja e Rodolfit, për rastet kur unë i lutesha që të rrinte edhe Marjeta në drekë me ne.

I kishin këto kosto *ata që kishin privilegjin e autorizimeve të planifikuara*, por në të vërtetë mungesat dhe vështirësitë e detyruara prej kohës nuk i pengonin njerëzit të ishin më dashamirës dhe më miqësorë midis tyre. Ndoshta ishte edhe prania e humorit që lehtësonte dhe zëvendësonte atë pjesë të vështirë të jetës, ku mungesat e shumëllojshme ishin të pranishme për kohën.

Rruga me urban shpesh krijonte vështirësi, veçanërisht në kohë të keqe, kur binte dëborë dhe vonohej urbani; por nuk do të mungonin shoqet, të cilat në pritje të urbanit mblidheshin në zyrën time që ishte afër stacionit të autobusit, ku vlonte zjarri. Për të sajdisur shoqet e mia, Nesmiu, brigadier, burrë punëtor dhe xhentil, na sillte gështenja, na ndihmonte dhe për t'i pjekur në zjarrin bubulak dhe pastaj harrohej fare vonesa e urbanit.

Kënaqësia shtohej edhe kur vinte ndonjë shoqe nga Korça, për të shijuar natyrën, në ditët kur isha më e lirë nga puna. Kujtojmë me kënaqësi me Marjetën një udhëtim nga Cangonji në Bilisht, me karrocë, si *karrocë*/*taxia* më e mirë e kohës, në mungesë të urbanit që ishte vetëm dy herë në ditë. E vetme karroca në rrugën automobilistike, kali me vrap nën kamxhikun e karrocierit që, për të na kënaqur ne, i binte atij fort vazhdimisht, sepse nuk e dinte ai sa më dhimbsej kali, aq i dashur për mua që fëmijë.

- Sa gjynah kali, i them Marjetës.

- Thuaji të mos i bjerë kaq fort, më thotë Marjeta.

- Kali nuk ecën po të mos i biesh me kamxhik?, - pyes karrocierin, për t'i lënë të kuptonte që po i binte shumë fort kalit.

- Është mësuar ky, nuk do t'ia dijë, sa më shumë t'i biesh aq më shumë bindet - përgjigjet karrocieri, që e njihte mirë zanatin e tij dhe vazhdonte me të njëjtin ritëm.

U pamë sy më sy me Marjetën dhe duke nënqeshur u kuptuam në heshtje, sepse kujtuam shprehjen e njohur dhe kuptimplotë : - *Sa më shumë t'i biesh kalit, më mirë*

të mban. Kishte të drejtë karrocieri*, po mjerë kush e duron kamxhikun*..

Ka qenë një ditë fantastike, më kujton Bela një ditë që më shoqëroi nëpër pyll, megjithëse iu desh të lodhej pak. Ndërkohë, për mua, ishin të zakonshme ato ditë të mbushura edhe me punë, por edhe me shumë kënaqësi. Ecjet e mia vetëm nëpër pyll ishin të zakonshme edhe në distanca të gjata që ndanin njërin fshat nga tjetri, sepse pylli largonte lodhjen dhe shkurtonte distancat. Shpesh kur ecja përmes pyllit, ndihesha e humbur mes madhështisë së gjelbërimit të pyllit, me ndjesinë e shkëputjes nga bota reale në atë imagjinare, e destinuar të jetoja mes natyrës së qetë dhe të bukur, larg realitetit të egër të kërcënuar nga kufizimet e pamata të kohës.

Kështu vazhdoi puna ime për rreth tetë vjet, kur me ngjarjet që do të pasonin do të më duhej të shkëputesha me shumë keqardhje nga ajo kënaqësi mbresëlënëse. Ishte kënaqësi që kompensonte më së miri përgjegjësinë dhe vështirësitë e pashmangshme të punës, veçanërisht në periudhën e fushatës së pyllëzimeve, kur kishte lodhje dhe përgjegjësi më të madhe se në ditët e zakonshme. Kjo përgjegjësi bëhej akoma më serioze kur shfaqeshin probleme që mund të sillnin *pasoja të frikshme*, për më tepër kur mund të interpretoheshin në mënyra të qëllimshme nga *njerëzit e Partisë dhe të Pushtetit*.

Por pavarësisht vështirësive dhe paradokseve të kohës, ajo kohë do të kujtohet si kohë kur punohej dhe investohej me seriozitet në Sektorin e Pyjeve, veçori kjo e sistemeve diktatoriale në menaxhimin e burimeve natyrore. Ishte e rëndësishme, që kishin filluar të

zbatoheshin parimet e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, rezultatet e të cilave u dukën në rritjen e të ardhurave dhe në futjen e ekonomisë pyjore në rrugën e vetëfinancimit.

Fatkeqësisht, me ndryshimet që pasuan, nuk do të ecej në këtë rrugë që është rruga e duhur për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve. Përveç punës me dëshirë dhe pasion, kënaqësi e veçantë ishte mundësia në ato kushte për të lexuar rreth profesionit, një motivim më shumë për një punë të mundshme kërkimore në fidanishte.

Gjenetika ishte një fushë e palëvruar në shkencën e pyjeve, gjë që më nxiti dëshirën për studime në këtë fushë dhe përgatitjen për provimin pasuniversitar, pasi kisha shlyer provimet e gjuhës franceze dhe filozofisë, si provime paraprake. Puna në fidanishte ishte një plus në këtë zgjedhje, por edhe nxitja që më dha takimi me një specialiste finlandeze, e specializuar në gjenetikë, dërguar nga FAO(Organizata Botërore për Bujqësinë dhe Ushqimin) për një vëzhgim të situatës së pyjeve në Shqipëri.

U vlerësua si ngjarje e rrallë, si e para eksperte e pyjeve që vizitonte Shqipërinë në kohën e diktaturës dhe për këtë pati mobilizim të gjithanshëm të Ministrisë së Bujqësisë dhe asaj të Brendshme. Specialistja e huaj në fushën e pyjeve duhej të shoqërohej, përveç drejtorit të Institutit të Pyjeve në Tiranë, edhe nga një specialiste pyjesh, (femër), që të fliste një nga gjuhët e huaja që fliste ajo dhe nga ministria u propozova unë për ta shoqëruar. Ishte një përvojë e veçantë, sepse dhe vizitat e të huajve ishin të rralla në kohën e diktaturës, por ishte edhe një shenjë pozitive për ndryshim në Sektorin e Pyjeve, në

vitin 1987, kur pas vdekjes së diktatorit *shpresohej për ndryshime*.

U tregova e gatshme dhe e kënaqur për ta shoqëruar të huajën, me gjithë *rregullat strikte* dhe shpesh të bezdisshme të shoqërimit dhe të komunikimit, me të cilat u njoha që në fillim në Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve, në Ministrinë e Bujqësisë.

Emocionet ishin të jashtëzakonshme kur shkuam në Aeroport të prisnim të huajën, aq shumë të mirëpritur me shumë përgatitje prej kohësh. Hera e parë që shihja Aeroport me sy; hera e parë që u ndjeva si *person i rëndësishëm*, me autorizim të veçantë bashkë me Drejtorin e Institutit të Pyjeve për të shoqëruar të huajën deri tek avioni; hera e parë që pashë avion nga afër.

Në Aeroport nuk kishte udhëtarë. Kishte shumë pak njerëz, që dukeshin se ishin më tepër punonjësit e Aeroportit që vëzhgonin gjithçka përreth, midis të tjerëve edhe ne, si *vizitorë të rrallë*. Ndërkohë që prisnim *Christel*-in të shfaqej te porta e hapur e avionit, shohim papritur te një avion tjetër i vogël, që sapo ishte ulur, një grua të re, tepër elegante duke zbritur shkallët.

- Është nusja e shokut Enver, - më thotë drejtori që e dalloi, kurse ai me buqetë me lule që po e pret te shkallët e avionit është djali i shokut Enver.

Na e tërhoqën vëmendjen aq shumë, sa për pak po harronim *Christel*-in, që ishte shfaqur te porta e avionit dhe kishte filluar të zbriste shkallët.

- Kjo duhet të jetë *Christel-i* - i them drejtorit për t'i tërhequr vëmendjen nga çifti që në atë moment po përqafoheshin. Të entuziazmuar e përshëndetëm me

dorë, dhe me siguri *Christel* kuptoi që ishim ne që po e prisnim dhe që ajo po *trajtohej si delegacion qeveritar*.

Nisemi në drejtim të Tiranës, me veturën që na priste. U ndalëm te Hotel Dajti, ku na priste çdo gjë e bërë gati dhe në dispozicionin tonë. Të hyje te Hotel Dajti në atë kohë, ishte sikur të dilje jashtë shtetit. Aty mund të hyje vetëm me leje dhe ishte i lejuar vetëm për të huajt dhe për shqiptarë të pajisur me autorizim, sikurse ishim edhe ne për ato dy javë. (Ndiej keqardhje kur e shoh sot si një vlerë të humbur, të shndërruar në një ndërtesë me destinacion pa lidhje me atë që ka qenë, në arkitekturë dhe në historinë që mbartte.)

Edhe ne edhe *Christel* ishim të befasuar me atë mikpritje që sot mund ta shohim vetëm në pritjet e personaliteteve qeveritare, por jo për një specialist të një Organizate Ndërkombëtare. Në çdo moment kisha parasysh *porositë e dhëna* në Drejtorinë e Përgjithshme, ku, veç të tjerash, të mos pranoja asnjë dhuratë dhe, kur ajo më ofroi një çokollatë të madhe zvicerane, në pamundësi për të mos e pranuar, e morra dhe e dorëzova në Drejtorinë e Përgjithshme, ku e ndamë me personat që u ndodhën aty. Në darkën e organizuar po aty, në sallën luksoze të restorantit, me drejtorin e Përgjithshëm dhe të huajën, mori pjesë edhe një punonjës i Ministrisë së Jashtme (përgjegjës për frankofoninë), i cili do të vërtetonte komunikimin tim gjuhësor me të huajën. Gjatë darkës u fol vetëm frëngjisht dhe përfaqësuesi i MPJ vetëm dëgjonte, sepse ajo ishte detyra e tij. Kënaqësia i mundi emocionet që ishin të pashmangshme, si para një provimi ku u gjenda papritur, sepse ishte hera e parë që po komunikoja me

një të huaj në gjuhën franceze. Ishte pozitive që edhe ajo e fliste frëngjishten si e huaj, sepse ndryshe do të ishte shumë më e vështirë për mua. *Provimi* përfundoi me sukses, sepse përfaqësuesi i MPJ dha miratimin në fund të darkës (më tërhoqi mënjanë, duke më miratuar vazhdimin) dhe kam fjetur e qetë atë natë, gati për veprimtaritë që na prisnin në institucionet e caktuara paraprakisht sipas programit.

- Kur mbarova studimet e gjuhës franceze, shkova në Paris te motra për disa muaj, për të praktikuar gjuhën, - kujtoj të më thotë specialistja finlandeze *Christel*. - Po ju, ku e keni praktikuar frëngjishten?

- Me shokët e kursit të frëngjishtes, - u përgjigja unë, - por ka pak kohë që kam dhënë provimin dhe ndihem mirë që po e praktikoj me ju. Me keqardhje mendova, sa të kufizuar ishim ne në krahasim me të huajt. Megjithatë ndihesha e kënaqur që kisha rastin të flisja frëngjishten, atë gjuhë që e kisha studiuar me shumë dëshirë mbasi kishte qënë ëndrra ime që prej kohës kur lexoja kolosët e letërsisë franceze, apo dhe asaj ruse që e konsideronin gjuhën frënge si gjuhën e salloneve.

Ngelën dy javë të paharruara në kujtesë, si për nga komunikimi dhe përftimi profesional, ashtu dhe për nga kënaqësitë e udhëtimit, pritjet dhe përcjelljet në hotelet dhe restorantet e rezervuara kudo ku shkonim, ngjarje të paprovuara më parë. Gjatë gjithë kohës ishte i pranishëm shoqëruesi kryesor, drejtori i Institutit të Pyjeve, që vazhdimisht sillte momente humori në bisedat gjatë udhëtimit.

- Duhet të martohesh, - i tha një ditë, pasi e pyeti për moshën dhe mësoi që *Christel* ishte 30 vjeç. - Apo të të

gjejmë ndonjë burrë shqiptar? - Nuk kishte si të mos qeshnim me të madhe me *Christel-in*.

Skena më humoristike ka qenë kur drejtori u ngatërrua në gardërobën e Hotel Dajtit dhe veshi gabimisht pardesynë e një personi tjetër, shumë të ngjashme me të tijën. Ndërsa vetë ende nuk e kishte kuptuar ngatërresën, (me të drejtë ngatërresa, sepse pardesynë drejtori e kishte huazuar, në mungesë të një pardesye të mirë të vetën), vjen një person me të shpejtë, që i thotë se kishte veshur tjetër pardesy. - Ishte personi që e kishte atë pardesy? pyet *Christel*.

- Jo, i them unë, që kuptova se ishte një nga vëzhguesit e kujdesshëm, që nuk u shpëtonte asnjë detaj nga veprimet lidhur me të huajt, vëzhgim që e ndjenim kudo.

Pas kësaj, duke dalë nga Hotel Dajti, krisi e qeshura me të madhe, megjithëse duhej kujdes edhe në limitet e të qenit miqësor me të huajt, por ishte e pamundur të mos qeshnim në atë moment. Ndërkohë *Christel* nuk arrinte të kuptonte sesi punonjësi i Hotel Dajtit kishte qenë aq i vëmendshëm për të dalluar ngatërresën me pardesynë.

Udhëtimi ishte i këndshëm veçanërisht në jug të vendit, për të cilin Christel shprehu një admirim të veçantë. E pyes për një moment se ku qëndronte arsyeja e vlerësimit aq shumë të rivierës sonë në krahasim me vendet e tjera që ajo kishte vizituar dhe përgjigja e saj ishte:

- Është ruajtur natyra e virgjër pa ndërhyrje. (Asokohe ne vlerësonim plazhet me hotelet shumëkatëshe jashtë kufijve, në krahasim me plazhet tona që na dukeshin të varfër me hapësirat ranore pa fund.)

Ajo u ndje shumë e kënaqur, por edhe e befasuar njëkohësisht, nga trajtimi gjatë qëndrimit dyjavor, ku çdo gjë ku shkonim ishte e porositur paraprakisht nga *lart*, që të ishte e përkryer. Opinioni i të huajve për Shqipërinë ishte më i rëndësishëm se gjithçka, dhe kjo ishte një nga porositë kryesore që duhej ta kishim parasysh në çdo moment...ndërkohë kjo më bënte të ndihesha në siklet, kur më duhej të shpjegoja situata pak të vështira për t'u kuptuar, duke u sjellë *sipas porosive*.

Një ditë të diel, kur po kalonim në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" në Tiranë, në mes të turmës së xhiros së zakonshme të së dielës, *Christel* më pyet se përse kanë dalë kaq shumë njerëz dhe vazhdoi: "Për solidaritet?" (*Christel* e dinte që në një vend socialist si i yni nuk mund të bëheshin protesta).

- Kjo është shëtitje e zakonshme në ditët e pushimit, - iu përgjigja unë dhe vura re që më miratoi, por që nuk po arrinte ta kuptonte atë lloj *argëtimi* në ditët tona të pushimit.

Pas dy javësh të ngarkuara me aktivitete, por edhe të këndshme, erdhi dita e ndarjes, ku së bashku me drejtorin do ta shoqëronim *Christel*-in për ta përcjellë në Aeroport, përsëri të autorizuar ta shoqëronim deri tek avioni. E përshëndetëm me keqardhje për largimin, pas emocionesh dhe kujtimesh mbresëlënëse që la pas, por edhe ajo na la të kuptonim që kishte mbetur shumë e kënaqur. Kjo ishte shumë e rëndësishme, jo vetëm për ne, por edhe për *porositë* që kishim marrë paraprakisht, sepse ishte detyra jonë që e huaja duhej të largohej me opinion shumë të mirë për Shqipërinë.

- Më keni trajtuar si një mbretëreshë, u shpreh *Christel* para se të ndaheshim, - por ajo që kujtoj shpesh në ditët e sotme nga ai shoqërim dyjavor mbresëlënës, ishte këshilla:

- Ruajeni Natyrën kështu si e keni ruajtur, sepse kështu do të ruani vlerat e saj, një pasuri unike për vendin tuaj!

Nuk di si do të shprehej tani *Christel*, nëse do të bënte një vizitë në ditët e sotme, duke parë ndryshimet dhe mënyrën e trajtimit pa kriter të natyrës, bregdetit, veçanërisht të pyjeve, në vitet që pasuan.

Takimi me *Christel*-in pati veç të tjerash të mirën se, me gjithë censurën e kohës, e ruajtëm letërkëmbimin së bashku për disa kohë. Korrekte me premtimin, më dërgoi disa materiale të rëndësishme që do të më ndihmonin për punën kërkimore që dëshiroja të filloja në fidanishte. Paraprakisht, fillova të studioja leksionet e Gjenetikës për pyjet, si lëndë e re që e jepte prof.Th. Lako, i cili u tregua i gatshëm për të më ndihmuar. Ishte provimi që do të plotësonte provimet e nevojshme, para se të filloja punën kërkimore që po prisja të filloja në fidanishte.

Por ëndrra mbeti në sirtar, fatkeqësisht, sepse pas kërkesës në Institutin e Pyjeve për miratimin e një teme shkencore, pas shumë përgatitjesh në fushën e Gjenetikës, përgjigjja e drejtorit të atëhershëm të Institutit të Pyjeve, D.H., ishte:

- Nuk kemi plan studimesh në fushën e Gjenetikës, por mund të zgjedhësh tjetër temë nga këto që janë planifikuar. - Në vazhdim më tregoi një listë temash të planifikuara për punë shkencore, por nuk mund

ta kuptonte drejtori që qëllimi im nuk ishte thjesht mbrojtja e një teme shkencore..

Pavarësisht ndërprerjes së punës kërkimore, me *Christel*-in vazhduam letërkëmbimin për përshëndetje në raste festash dhe jemi takuar shumë përzemërsisht pas 12 vitesh në një Konferencë në FAO/Romë. Kuptova se ruante mbresat më të mira nga vizita në Tiranë. Më pyeti gjatë për gjendjen në Shqipëri dhe shprehu dëshirën për ta vizituar përsëri vendin tonë.

Ndërkohë unë mendova që Christel nuk do të gjente atë që ajo përfytyronte nga kujtimet që tani i përkisnin të kaluarës..

FEJESA

Përparësia e realizimit në fushën e profesionit do të vazhdonte për shumë vite edhe pas mbarimit të shkollës, vetëm se tani babai, i bindur në formimin tim, shfaqte më tepër anën e tij liberale, duke më këshilluar që të mos shihja vetëm librat, por edhe të dilja të argëtohesha me shoqe dhe me shokë. Ndërkohë, mamaja e shprehte më hapur shqetësimin se vitet po kalonin dhe duhej të vendosja në ndonjë nga *propozimet e kohës*. Më kujtonin nganjëherë që motra *nuk i lodhi*, sepse vendosi shpejt të fejohej, pak kohë pas mbarimit të shkollës dhe ndiheshin të kënaqur me zgjedhjen e saj. Në fakt, ata kishin ngurruar në fillim, për faktin që bashkëshorti i saj Kiu nuk i përkiste fesë sonë.

Ishte një ditë pushimi, ditë e bukur me diell, kur si gjithmonë bulevardet dhe rrugët e Korçës gumëzhinin nga njerëzit që do të bënin xhiron e zakonshme. Hyn në shtëpi babai, më shikon me libër në dorë dhe më thotë paksa i pezmatuar:

- Dil dhe ti, me çupë, si shumë të tjera që dalin me shoqe dhe shokë. Tani je në moshë që duhet të mendosh të lidhesh me dikë, që të krijosh edhe ti familje.. kënaqem, - vazhdoi ai, - kur shoh vajza që shëtisin nëpër rrugica me djemtë që pëlqejnë.

Babai ishte sa rigoroz ndaj detyrave, aq edhe liberal në trajtimin tonë dhe hapësirat që na krijonte në raport me lirinë. Për herë të parë ndjeva shqetësimin e tij, që nuk duhej të kalonte më shumë kohë për të ndërmarrë

vendimin aq të pritur prej tyre. Tetoja, gjithashtu, ndieja që ishte e shqetësuar, megjithëse ishte e vetmja që në ndonjë diskutim për ndonjë rekomandim, siç ndodhte rëndom, ishte më afër mendimit tim.

- Çupa do të martohet me atë që do dhe që meriton, - më dilte në mbrojtje kur unë përpiqesha t'u mbushja mendjen se personi në fjalë nuk ishte i duhuri për mua; megjithatë, shqetësimin e saj e kuptova kur u sëmur nga një *ischemie* cerebrale e papritur. Mjeku që e vizitoi na tha se gjendja ishte e pakthyeshme. Nuk doja ta besoja dhe i thosha të na ndihmonte të bënim çfarë mund të bëhej në ato momente. - Vetëm serume, thoshte mjeku dhe disa ilaçe nëpërmjet serumit, të cilat ia filluam menjëherë në shtëpi; - megjithatë, është shumë rëndë, - vazhdoi ai dhe është mirë të përgatiteni për këtë.

Nuk mund të pranoja ndërprerjen e parakohshme të një dashurie pa fund, që na e kishte ushqyer në vite dhe nuk mund të mos përpiqeshim familjarisht për të bërë çfarë ishte e mundur, bashkë me fqinjat që nuk na ndaheshin për të na ndihmuar. Edhe për ato, teta ishte një mike shumë e dashur në vite. Ishte në gjendje gjysmëkome kur i them që duhej të shërohej, se së shpejti do të fejohesha. Ma shtiu në mend këtë gënjeshtër teta Pandora, një fqinjë shumë e dashur dhe e afërt me ne, me tetën gjithashtu. Efekti ishte i duhuri, sepse teta menjëherë hapi sytë dhe më pyeti me zë të mekur:

- Kur? - Të shtunën - iu përgjigja unë. Kaq ishte dhe ndodhi mrekullia që quhet kthim nga vdekja. U shërua vërtet dhe jetoi edhe dy vjet të tjerë, por unë ende nuk e kisha gjetur *Princin e Kaltër*; keqardhje që nuk arrita të bëja të lumtur atë që e doja aq shumë.

Ishte ngjarje që ndjeva se, pavarësisht *qetësisë* me të cilën e kisha marrë këtë çështje, shqetësimi i tyre më bënte të filloja të mendoja ndryshe, të paktën të merrja në konsideratë ndonjë kandidaturë që ata e kishin për zemër. Rekomandimet nga njerëz të vlerësuar ishin normale në atë kohë në Korçë, sidomos kur shiheshe si e shkujdesur në këtë drejtim dhe kështu ndodhi vërtet.

Rastin e parë që m'u propozua nga një person i respektuar nga familja jonë, u tregova e gatshme për ta takuar. Sapo e pashë, më kujtoi *Koçin* në filmin "Zonja nga qyteti". Ishte shumë e ngjashme situata, përveç *teta Ollgës* që mungonte. Me kaq mbaroi historia; arsyet e mospranimit ua shpjegoj kur kthehem në shtëpi dhe sigurisht që nuk vazhdoi më ajo bisedë.

Nuk kaluan shumë ditë dhe babai e sheh atë person në një familje ku u ndodhën rastësisht për vizitë së bashku me mamanë. Mamaja i kishte treguar kandidatin në fjalë dhe babai (që e kish pëlqyer në pamje), sapo hyn në shtëpi më thotë:

- Kur nuk ke pëlqyer edhe këtë djalë, vështirë se do të vendosësh për ndonjë tjetër. Ndërsa mamaja që e pasonte:

- Djalë më të mirë se atë nuk ke për të gjetur.

- Më të mirë se *Koçin* nuk do të gjej?! Patjetër që do ta gjej! - përpiqesha t'i qetësoja me humor.

Nuk e kisha parë asnjëherë aq të pezmatuar babanë, ndërsa teta që dëgjoi bisedën, me gjithë dëshirën e madhe që të më shikonte *të rregulluar*, mbetej përsëri aleatja ime e përhershme në këto lloj bisedash. Ndieja shqetësimin e tyre që vlerësohej normal për kohën... megjithatë, asnjëherë nuk u ndjeva e bezdisur lidhur me

këtë çështje deri sa erdhi momenti i aq shumë pritur... vetëm se tani mungonte teta.

Një ditë, Lola, komshia jonë dhe mikeshë prej kohësh, më tregon për një diskutim që ishte bërë në shtëpinë e A. Polenës, midis Adhonit dhe Arqilesë, të dy shokë të hershëm të Nestit, që prej fëmijërisë dhe në vazhdim. Pas diskutimit së bashku me gruan e Adhonit, Licën, kishin rënë dakord të na rekomandonin për njohje, si një lidhje që e shihnin të përshtatshme. Lola, e prirë si gjithmonë për të folur pozitivisht, ma përshkroi me superlativa:

- Është absolut në zgjuarsi.. ka mbaruar shkëlqyeshëm 5-vjeçarin për Fizikë.. e quajnë koka e Fizikës.. ka fituar Bursën Zholio Kyri në konkursin e studentëve më të mirë të Fizikës 5- vjeçare.. pedagog në Fakultetin e Shkencave.. i specializuar jashtë shtetit në Itali, Kinë (atëherë jo të gjithë e kishin atë shans).. i stabilizuar me shtëpi... - e të tjera që thuhen në këto raste..dhe më tej:

- Mendojmë që do të jeni të përshtatshëm për njëritjetrin.

- Faleminderit- i përgjigjem Lolës me mirënjohje për interesimin që e karakterizonte. Nuk mund t'i thosha më tepër, sepse nuk e njihja dhe nuk dija asgjë rreth personit në fjalë, pavarësisht fjalëve shumë të mira që dëgjova dhe, më e rëndësishmja ishte se mesazhi vinte nga njerëz që i njihja dhe i respektoja.

Kisha hyrë shpesh në shtëpinë e A. Polenës, ose siç njihej në Korçë dhe më gjerë Shtëpia e dr.Polenës, sepse shkoja për vizitë te motra e Adhonit, Ida, me të cilën kishim miqësi të hershme. Babai i tyre, dr.Sotir Polena ka qenë një nga mjekët më të njohur për nga kontributi i

tij si mjek në qytetin e Korçës e më gjerë; ndërsa shtëpia e tyre është e njohur si një nga shtëpitë më të bukura dhe të veçanta në Korçë, për nga arkitektura, por edhe nga historia e familjes, me tradita të vyera qytetare dhe patriotike. (sot monument kulture).

Propozimi më ngeli në mendje, megjithatë nuk e bëra këtë bisedë me asnjeri, përveç motrës, e cila më thotë se Nesti po i kujtohej si fytyrë, sepse e kishte shtëpinë shumë afër nesh. Gjithashtu njihte të vëllanë Gaqo, që kishte mbaruar Institutin e Lartë të Arteve për kanto. Edhe unë e njihja Gaqon, si person i njohur që ishte në Korçë, por jo të vëllanë.

- Kujtoj, - më thotë Lida, - që vëllai i Gaqos është i njohur në opinion si *tip shkencëtari*.

- Thua të mos jetë *tip Koçi*?, vazhdoj unë duke qeshur.

- Jo, besoj të të pëlqejë, se hyn në tipat e pëlqyeshëm nga ti (pak si *Al Pacino* që pëlqen ti).

Kuptova që motra ishte e interesuar për këtë rast, ndryshe nga rastet e tjera, për më tepër që tani mendohej se ishte koha e duhur për vendim. Kiu, gjithashtu, (mendimin e të cilit e vlerësoja), më la të kuptoja se edhe ai mendonte pozitivisht në këtë rast. Lida e njihte shijen time dhe kërkesat e mia, gjë që nuk do ta harroja, por nuk u interesova për më tepër, siç ndodh normalisht në këto raste.

Do të më kujtonte Lica, gruaja e Adhonit, kur takohemi rastësisht, duke më thënë që do të bëja gabim nëse nuk do të pranoja ta takoja, duke më treguar hollësira edhe për shtëpinë e tij. - Ka shtëpi - më tha - të mirë me të gjitha të mirat..edhe fshesë me korrent ka blerë..po e dëgjoja jo me shumë interes, por kur dëgjova

fshesën me korrent, kam qeshur aq shumë, sa nuk do të harrohej kurrë ajo bisedë e këndshme.

Edhe sot gjendet në sirtarin e kujtimeve të Nestit letra që Lola (mësuese letërsie), me talentin e një letrareje, nuk kishte ngurruar (*si teto Sofka*) t'ia dërgonte Nestit me rekomandimin mbi kandidaturën që kishin menduar shokët e ngushtë. Jo vetëm kaq, por pas pak ditësh, kur kishte shkuar në Tiranë për vizitë me kolektivin e shkollës ku jepte mësim, në mes të vizitave të shumta Lola nuk kishte përtuar të shkonte në Fakultetin e Shkencave të takonte Nestin. Kishte vendosur Lola t'i shkonte deri në fund muhabetit, prandaj nuk mund të rrinte pa e kujtuar Nestin për letrën dhe për t'i përsëritur edhe një herë të mirat që e prisnin po të merrte në konsideratë propozimin në fjalë.

Iu desh ca kohë Nestit (Nekes siç e quanin shokët), të interesohej, veç të tjerash, edhe për mundësitë e punësimit, (nëse çdo gjë do të shkonte sipas parashikimit), para se të nisej për të parë *aq të lavdëruarën* e shokëve. Ishte hera e parë, kujton Nesti, që Adhoni miratonte një propozim të tillë.

E shtunë, 29 prill 1989. Ishim duke biseduar me Koçon, kushëririn që na vizitonte shpesh, të rehatuar në dhomën e ngrohtë ku rrinim zakonisht. Papritur hapet porta dhe nga dritarja shoh Lolën duke kaluar me nxitim nëpër oborrin e shtëpisë. Nga pamja, kuptoj që po vinte me *mision*:

- Eja shpejt Zhankë, se në shtëpinë tonë ka ardhur Nesti për t'u takuar! - më thotë me shumë ngut dhe me bonsensin që e karakterizon.

- Cili Nesti? - e pyes Lolën, ndërkohë që e kuptova për kë bëhej fjalë.

- Nesti që kemi biseduar, eja shpejt!

Ngelem e shtangur, nuk bëhej fjalë për kundërshtim, megjithëse mendova se jo vetëm nuk kisha pyetur, por edhe nuk dija rreth këtij personi më tepër sesa kisha dëgjuar prej tyre. Isha para faktit të kryer. Duhej të shkoja bashkë me Lolën, që po priste me padurim.

E hutuar paksa, vishem shpejt me ç'm'u ndodh për lehtësi në moment dhe duke i thënë Lolës se nuk e kam idenë për këtë person, nuk kam pyetur njeri..

- Nuk ka nevojë të pyesësh, i dimë ne të gjitha, është i përkryer..- dhe me këto fjalë gjendemi te shtëpia e Lolës, para të *shumëpriturit* prej shumë viteve, por jo të asaj dite.

Pamja në shikim të parë nuk përkonte me foton e para 20 vjetëve që më kishte treguar Lola paraprakisht. Përshtypja e parë pozitive ishte sportiviteti në veshje, pa ndonjë përkushtim të veçantë për atë takim. Pasi e takoj, ulem përballë në praninë e Lolës dhe të Arqilesë, që ndonjëherë dilnin dhe ne gjendeshim vetëm. Po kalonte kohë, rreth tri orë biseda nga më të ndryshmet, por të gjitha jashtë temës përse ishim takuar. Në kujtesë na ka mbetur diskutimi rreth disa librave, më tepër në prizmin e mesazheve që jepnin; më të rëndësishmet mbeteshin të qenit vetvetja, jashtë kompromiseve, sinqeriteti, qytetaria etj., të kësaj natyre, ku u ndjemë në të njëjtat valë komunikimi.

Po shkonte ora 9.00 e darkës, kur na kujtojnë të zotët e shtëpisë se mund ta vazhdonim bisedën të nesërmen. Nuk ngurruam të dy njëherësh që të vendosnim

të takoheshim të nesërmen para dreke, sepse të pasnesërmen Nesti duhej të ishte në Tiranë. Kthehem në shtëpi, ku gjej Lidën e Kiun me vajzat, që kishin ardhur për të festuar tek ne Pashkët (sigurisht në fshehtësi). Kiu na respektonte vazhdimisht në këto lloj festash, edhe pse i përkiste tjetër besimi fetar. Çdo fundjavë do të gjente mundësinë e një makine (kishte vetëm makina shtetërore në atë kohë), për të sjellë motrën dhe vajzat, që vinin me shumë dëshirë të takonin gjyshërit ku ishin rritur. Po më prisnin me padurim, për më tepër që sapo kishin dëgjuar nga prindërit mbi arsyen e takimit.

- Fillim i mbarë - u them, dhe vazhdoj t'u tregoj për përshtypjet e para..po më dëgjonin me shumë vëmendje dhe u pëlqeu kur u thashë se do të vazhdonim bisedën të nesërmen, ora njëmbëdhjetë; të gjithë u ndjenë shumë të kënaqur kur kuptuan se ishte rast ndryshe nga të mëparshmit. Me shumë gëzim shtrohet tryeza nga mamaja, që si gjithmonë e papërtuar, do të na kënaqte me gatimet e saj të mrekullueshme të kuzhinës përmetare. Me shumë kënaqësi ishim në pritje të orës 12.00, kohës së Ringjalljes së Krishtit, kur sipas zakonit trokitëm vezët e kuqe, (ngjyer bukur dhe me kujdes nga mamaja) me shprehjen: *Kristos Anesti*! (greqisht), Krishti u ngjall! (shqip).

Festimi në fshehtësi i jepte një kënaqësi të veçantë mbrëmjes së Pashkëve. Së pari do mbylleshin perdet që t'i shpëtonim ndonjë *vëzhguesi të padëshirueshëm* nga jashtë dhe më pas do kujdeseshim që lëvozhgat e kuqe të vezëve t'i hidhnim në fshehtësi tek mbetjet e ditës. Kështu do t'u shpëtonim *pasojave fatale* nëse do të konstatohej nga *të partishmit e kohës* se kishim ngjyer

vezët për të festuar Pashkët. Ndërkohë kishte edhe të guximshëm, që në formë revolte i hidhnin lëvozhgat e kuqe që natën para dyerve të *pushtetarëve*, si *një formë përshëndetje* ndaj tyre kur të hapnin portën e shtëpisë në mëngjez. Ishin veprime tepër të guximshme këto nga të krishterë kurajozë që donin t'u bënin të ditur *të fuqishmëve të kohës,* se megjithë presionin dhe ndalimet e kohës, besimi dhe shpirti kristian nuk mund të mposhtej lehtë.

- Gëzuar, - thotë mamaja, - festohet edhe Emri i Nestit sot.

- Shenjë pozitive kjo për Nestin, - i them unë duke qeshur, por ndoshta edhe për mua.

- Me sa duket, do të bëhet fejesa, më thotë motra. Lida ishte paksa supersticioze dhe kuptohej që e kishte me shumë dëshirë këtë rast; ndërkohë për mua, si gjithmonë, kishte shumë rëndësi mendimi i saj, që në përgjithësi përkonte me mendimin tim.

Atë natë kam bërë gjumë të shqetësuar; po më fliste më tepër subkoshienca se arsyeja, siç ndodh shpesh natën kur nuk ke gjumë. Ishte një lloj kimie që u ndje që me shikimin e parë (ndryshe nga çdo rast tjetër), në vazhdimësi të bisedës gjithashtu dhe së fundi po prisja me padurim të takoheshim të nesërmen.

Vazhdoi takimi në bulevardin e mbushur nga njerëzit, si zakonisht në ditët e pushimit. Ne, si gjithë të tjerët, bëmë xhiron e zakonshme të së dielës, duke biseduar mbi tema të përgjithshme, por më konfidentë se natën e kaluar. Biseda vazhdoi deri sa u kujtuam që kishte shkuar ora për drekën e Pashkës në shtëpitë tona, për të vazhduar më vonë, sepse çdo gjë duhej të

vinte natyrshëm në bisedat që ndihej se do të kishin vazhdimësi.

- Na duhet kohë të vazhdojmë të bisedojmë, - i them unë Nestit, kur pashë që po kalonte ora shumë shpejt.

- Unë nuk kam pyetur njeri dhe do të doja që gjithçka ta bisedojmë hapur dhe me sinqeritet ndaj njëri-tjetrit...

- Kurse unë kam pyetur Tomin, shokun tënd të klasës së gjimnazit, që është djali i kushëririt tim.

- Çfarë të tha Tomi?, e pyes me besim se ai vetëm mirë mund të fliste për mua, për shoqërinë që kishim pasur.

- Më tregoi një fotografi nga koha e shkollës dhe së fundi më tha që mjafton ajo të pranojë dhe mos e diskuto më tepër. Kurse vëllai, Gaqoja, më tha: - Jepi fund këtij muhabeti, se e njoh mirë familjen, babanë, Yllin, (dajën tim) dhe Lidën. Është njëlloj sikur ke fituar lotarinë. (fjalët e fundit ishin më të gjeturat për Nestin).

Më pas e pyes për kohën kur mund të ishte mundësia të takoheshim dhe më erdhi paksa keq kur më tha se ishte i detyruar që të hënën të nisej për në Tiranë. I duhej të shkonte në zbor për dy javë me studentët e Fakultetit.

Para se të ndaheshim për të shkuar secili në shtëpinë e vet, vendosëm që do të takoheshim atë ditë në orën gjashtë pas dite dhe pas dy javësh do të vinte përsëri në Korçë. Në shtëpi më priste dreka e këndshme e Pashkës e shtruar me shumë kënaqësi nga mamaja, sepse veç festës ndihej edhe gëzimi që kishin kohë që po e prisnin. Ishim si zakonisht me njerëzit e dashur të familjes (mungonte vetëm teta).

- Si shkoi biseda sot?, - më pyet babai me kuriozitetin për të ditur rreth takimit të mëngjesit.

- Deri tani mirë duket si fillim...e lamë të takohemi sonte në orën gjashtë dhe pas dy javësh do të vijë përsëri. Pastaj gjatë verës do të kemi mundësi për të vazhduar, se Nesti ka pushimet e shkollës dhe besoj se gjatë kësaj kohe do të merret edhe vendimi.

- Kam frikë, - vazhdoi babai me qetësinë dhe elegancën që e karakterizonte, - se po u zgjat shumë koha për të vendosur, do ta kesh më të vështirë vendimin, për sa të njoh unë.

- Këtë radhë është ndryshe, i them unë.

- Na uroi Pandora sot, - vazhdon mamaja, - se nuk e di kush i kishte thënë që ju kishte parë në bulevard.

Krisi e qeshura, kur papritur hapet porta e shtëpisë dhe hyn Lola me vrap drejt e në dhomë, ku na gjen rreth tryezës duke kuvenduar për ngjarjen e ditës.

- Ka ardhur Nesti në shtëpinë tonë, prandaj eja shpejt se do të bisedojë me ty! - më thotë me mënyrën e saj të natyrshme.

- E kemi lënë për në orën gjashtë, Lola, - i them unë e çuditur për këtë të papritur.

- E di, por ka ndryshuar plani, pasi ka biseduar me familjen e tij. Lola dukej e gëzuar, prandaj nuk mendova se biseda e papritur do të kishte ndonjë lajm të papëlqyer.

- Po ti, di gjë për çfarë bëhet fjalë?

- Eja shpejt, se po na pret, do të ta thotë vetë! - më thotë në një mënyrë që duhej të shkoja menjëherë, se nuk priste puna sa të mbaronte dreka.

Sigurisht që do të shkoja, duke lënë përgjysmë pjatën që po më shijonte aq shumë. Sa hyj në dhomë, atje ku ishim takuar një natë më parë, Nesti i ulur te divani,

me një afërsi ndryshe nga një natë më parë, më bën me shenjë të ulesha, duke vënë dorën pranë tij. Ulem tek vendi që më ofroi.

- E di si është puna?

- Si?, e pyes unë, duke pritur me padurim çfarë do të më thoshte ndryshe nga sa kishim biseduar dy orë më parë.

- Gjithçka është e vendosur që në takimin e parë.. zgjatja në kohë është për të justifikuar atë që është vendosur. Është parim i përgjithshëm ky. Me një fjalë, duan të na fejojnë.. - vazhdon me një nuancë të hollë humori që e karakterizon Nestin.

Kush? - e pyes unë.

- Familja ime, Lola, Arqilea, të gjithë që janë në dijeni të këtij muhabeti.

- Le të na fejojnë! - përgjigjem unë duke qeshur, pa ditur se ç'po thosha me atë përgjigje. Truri ishte në boshllëk të plotë, arsyeja nuk po funksiononte më..ishte subkoshienca që foli dhe bëri mirë në atë moment, që ishte momenti vendimtar.

- Atëherë, në orën gjashtë nuk do të takohemi vetëm, por do të vijnë dhe njerëzit më të afërt të familjes sime për t'u njohur.

- Mbaroi - tha Lola e gëzuar, - nuk do të kishte kuptim të zgjatej më tepër, se gjërat e zgjatura kanë rrezik të mos bëhen.

Që t'u thosha se duhej të pyesja edhe unë familjen, nuk kishte kuptim, sepse e dija që do të ishin të gatshëm ta prisnin me shumë kënaqësi lajmin e shumëpritur.

Babai e njihte familjen e Nestit si familje e vjetër qytetare dhe sipas tij (që kishte lexuar *Keepling*

mbi familjen), gjë që do të ma kujtonte atë ditë, në mbarëvajtjen e jetës së çiftit, faktorët më të rëndësishëm ishin: *origjina e njëjtë, shëndeti, dashuria*. Në rastin konkret qëndronte origjina, shëndeti, e diskutuam gjendjen e shëndetit gjatë bisedës, dhe dashuria premtonte shumë, sepse ndryshe nuk do të bllokohej truri Ditën e Pashkës.

Lidhur me shëndetin, së pari i tregova historinë për raportin shëndetësor, *çelësin shpëtimtar* të ndërprerjes së studimeve në Agronomi. Ishte në vazhdën e historisë së shkollës, por edhe për një arsye tjetër, që të dinte të vërtetën mbi raportin, sepse mund të ndodhte të dëgjonte ndonjë *interpretim ndryshe*. Ndodhi një herë, që një kandidati të radhës i kishin thënë që duhej të kishte kujdes, sepse kisha pasur dikur një raport shëndetësor për një *sëmundje të rëndë* dhe të shkretit djalë iu desh pak kohë ta sqaronte llojin e raportit, deri sa kur u sqarua mirë, ishte tepër vonë.

Thashethemet ishin pjesë e jetës së familjeve korçare, por nganjëherë mund të ndikonin për mirë. Mesa dukej, Nesti ishte i mirësqaruar për gjithçka...mjaftonte një "Po!" nga unë, që të merrej vendimi që do t'i lumturonte të gjithë...dhe i vetmi problem për zgjidhje mbetej pjesa logjistike e zhvillimit të ceremonisë. Nuk ishte e lehtë të gjeje në atë kohë në treg të lirë llokumet me arra dhe bonbonet. Zakonisht, në këto raste, duhej të porositeshin disa ditë më parë. Ishte ora dy e gjysmë e pasdites dhe kishte vetëm tri orë e gjysmë kohë kur duhej të kishin mbaruar përgatitjet. Këto çështje i zgjidhte vetëm Kiu, që si gjithmonë i gatshëm mori makinën dhe u nisën së bashku me Lidën për Pogradec, ku do t'i gjente patjetër

gjërat që nevojiteshin. Arqilea mori përsipër ëmbëlsirat që do t'i merrte te Hotel Turizmi.

Mamaja me komshiet, Pandorën, Marjetën, (gjithmonë të pranishme te njëra-tjetra në raste nevoje), do të merreshin me shtrimin e shtëpisë..kushërinjtë që i njoftuam, u gjendën menjëherë të gatshëm. Do të shtroheshin qilimat, velenxat, perdet që viheshin në rastet e veçanta, së bashku me punimet e dorës së mamasë, që kujtohet gjithmonë përveç të tjerash, për "duart e saj të arta". Kukulla gjithashtu do të ishte e pranishme në ceremoni, por tani ishin Zelina dhe Emi që do të gëzoheshin sapo të shihnin të nxirrej nga sënduku kukulla. Ato e dinin vendin ku do të vendosej kukulla dhe tani ishin ato që e merrnin nga duart e nënës për ta vendosur në vendin e saj të përhershëm.

Çdo gjë shkoi sipas parashikimit. Kiu me Lidën u kthyen në kohë rekord nga Pogradeci me gjithçka duhej, por edhe me kënaqësinë që kishin shpëtuar mrekullisht nga një aksident i mundshëm për shkak të rrugës së lagësht, por edhe të shpejtësisë mbi të lejuarën për të arritur në kohë. Kiu e kujton shpesh atë ditë, si rast unikal që është gjendur shumë afër aksidentit.

Ishte Ditë e Mbarë dhe Engjëlli Mbrojtës, si gjithmonë, nuk do të mungonte të ishte pranë nesh.

NDRYSHIMI

Kishte perde të hekurta, kishte mure të ngritura, kishte vëzhgim kudo dhe kurdoherë, por kishte edhe shpresë që një ditë do të ndryshonte diçka dhe më vonë ndoshta edhe gjithçka. Ndryshimi i sistemit në vitet '90-të do të bënte realitet ëndrrën e kahershme për të shpresuar demokracinë dhe lirinë e dëshiruar në vite dhe në breza. "*Liri, Demokraci*!" do të brohoritej me të madhe dhe me emocione të jashtëzakonshme në daljet nëpër mitingjet e para. Vetëm lajmi se do të vinin në qytetin e Korçës themeluesit e Partisë Demokratike nga Tirana, për të kryesuar mitingun, i nxirrte në shesh qytetarët korçarë të të gjitha moshave, kryesuar nga elita e intelektualëve korçarë. Entuziazmi na kishte përfshirë aq shumë, sa nuk donim të dyshonim, apo të arsyetonim, se cilët ishin ata themelues, ata drejtues të mitingjeve, veshur të gjithë me pardesy të bardha, që u ishte besuar drejtimi i ndryshimeve që do të sillnin demokracinë e pritshme.

Entuziazmin e shtonte fryma demokratike, që kishte filluar të ndjehej, artikujt e parë në gazetën "Rilindja Demokratike", poema e B. Londos, artikulli i Y. Popës, të pasuar nga artikuj të tjerë të intelektualëve të njohur (shenja të dobësimit të censurës), që po ngjallnin çudi, gëzim, ilaritet, si shenjat e para të erës demokratike. E donim demokracinë sepse donim lirinë e humbur. Ishte e natyrshme kjo, sepse përveç atyre që kishin pësuar humbje të jetëve apo të lirisë në burgjet e tmerrshme të

diktaturës, të gjithë të tjerët, madje edhe të privilegjuarit e kohës, jetonin me *liri të ndaluar*.

Të gjithë ishin të përjashtuar nga informacioni, nga liria e lëvizjes, e studimit, e fjalës, e besimit, e ushqimit dhe veshjes së duhur. Çdo gjë kishte funksionuar sipas modelit të caktuar nga Partia; gjithçka ishte caktuar brenda idealeve dhe mësimeve marksiste-leniniste, brenda kornizës së vendosur dhe të ruajtur me fanatizëm nga më të përkushtuarit ndaj idealit të Partisë. Gjithkush që mund të shfaqej paksa ndryshe, jashtë kësaj kornize, ishte i regjistruar në *listën e zezë* të njerëzve me prirje ndryshe, pse jo dhe armiqësore.

Rënia e Murit të Berlinit, që përbën edhe një nga ngjarjet më të fuqishme që tronditën rendin socialist në vitin 1989, dalja në skenë e Gorbaçovit me *Perestrojkën e famshme në krye të botës komuniste*, si edhe ngjarjet që do të pasonin me ndryshimet në Rumani dhe në vendet e tjera të Europës Juglindore, ngjallën shpresën që ndryshimi i sistemit edhe tek ne do të ishte i pashmangshëm. Sigurisht që si *kështjella më e pamposhtur e komunizmit në Europë*, nuk do të dorëzoheshim shpejt dhe do të vazhdonim të bënim qëndresë, të vendosur në *kauzën tonë*.

Ngjarjet që do të pasonin vazhdoja t'i përjetoja në Korçë, ku, bashkë me shpresën e epokës së re aq të mirëpritur, erdhi në jetë im bir, si një mbarësi dhe gëzim i jashtëzakonshëm i shumëpritur për familjen tonë dhe atë të Nestit. Djalë...djalë...djalë, kishte bërtitur babai, kur Donika i dha lajmin e lindjes së djalit të shumëpritur, kurse mamaja menjëherë nga gëzimi i kishte dhënë *shpërblimin e myzhdesë*, sipas zakonit. Të gjithë ishin të

lumtur që, pas dy vajzave të motrës, po shijonin rritjen e Tedit, në familje, në Korçë, veçanërisht babai që e kishte dëshiruar një djalë pasardhës në familje. Kur filluan të lejoheshin pagëzimet në kishë, e pagëzuam me emrin e tij Dhimitër, me kumbare Lolën dhe Arqilenë, gjë që e gëzoi shumë babanë.

Veç kujdesit dhe preokupimit për mirërritjen e Tedit, nuk do të mungonte interesi për ngjarjet që po rridhnin me shpejtësi. *Sytë katër* mbi ekranet dhe *veshët ngritur* drejt Perëndimit, që po përparonte me ndryshimet drejt një regjimi të ri në ish-vendet komuniste, ndërkohë që shtoheshin shpresat për ndryshimet që nuk mund të mos ndodhnin edhe tek ne. Prisja me padurim Nestin, që vinte në fundjavë nga Tirana në Korçë, për të na vizituar mua dhe djalin dhe që na sillte lajme që qarkullonin, veç atyre të medias.

Kujtoj që lajmet e para që i prisnim me habi, ishin ndryshimet brenda sistemit, se do të lejohej fillimisht aktiviteti i avokatisë, do të lejoheshin makinat private dhe më në fund lajmi i famshëm i pluralizmit. Lejimi i avokatisë ishte lajm joshës përsa i përket të drejtave të njeriut, pluralizmi e tejkalonte përfytyrimin, kurse lejimi i makinave, që m'u duk paksa i besueshëm, më turbulloi mendjen kur mendova pasojat e pariparueshme në ndotjen e mjedisit, një nga të mirat e pakthyeshme të asaj kohe. Në moment mendova se jo të gjitha ndryshimet mund të na lumturonin në përfytyrimin tonë, që filloi të na çonte edhe në situata të frikshme..

Nuk kisha gabuar për situatën që na priste së shpejti dhe që do të rëndohej e përkeqësohej pa fund në vazhdimësi. U hapën ambasadat..!!, ishte lajmi që

Nesti do të na e jepte gojarisht, me ardhjen e radhës në Korçë, më 2 Korrik 1990, ndërkohë që në Tiranë njerëzit po suleshin drejt ambasadave për të shkuar drejt *parajsës së ëndërruar prej vitesh*. - Po ti, pse nuk hyre?", e pyet teta Marjeta, komshie në shtëpinë ngjitur me shtëpinë tonë dhe mike e mamasë, që pinin kafen së bashku çdo mëngjes (teze i thoshte Kozeta, vajza e Marjetës, mamasë sonë). Nesti, si i habitur nga pyetja, pa në drejtimin tim. Pyetje me vend, i them unë, që s'po e mbaja të qeshurën, sepse nuk mund ta përfytyroja Nestin të ngjitej mureve të ambasadave.

- Më kishte marrë malli për ju -, përgjigjet ai dhe unë nuk e kuptova nëse edhe ai po bënte humor, apo po fliste seriozisht.

- Çfarë i thua, me çupë? Ku të linte nusen dhe djalin? - i drejtohet Marjetës, teta Niqi, që deri tani nuk kishte guxuar të vizitonte komshinjtë, nga ndrojtja për djalin ish-të burgosur. Tani ajo vinte më shpesh dhe syhapur të na vizitonte dhe të na pyeste për të rejat që sillte Nesti nga Tirana rreth ndryshimeve të pritshme.

Përfytyrimi për *botën përtej kufijve* i bëri njerëzit e etur për liri të kalonin mure, kangjella, të kacavirreshin me të gjitha mënyrat, për të kaluar pragun e *botës së përtejme*. Në asnjë moment nuk u tunduam për t'u larguar në atë lloj mënyre, por në fakt nuk na mungonte admirimi për ata që na dukeshin heronjtë e kohës, për guximin që ndërmerrnin për të realizuar ëndrrën deri tani të pamundur.

Modeli i parë për ikjen nga ky vend do të bëhej shkrimtari i mirënjohur i kohës, I. Kadare. *Ai, përveç lirisë që gëzonte për të shkruar vepra të realizmit*

socialist, që e kishin bërë të vlerësuar për penën e tij brenda dhe jashtë kufijve, kërkonte edhe lirinë fizike të munguar...e gjeti më shpejt ai atë, me *ikjen e jashtëligjshme për kohën*, pak para se të shpërthente lëvizja për ndryshimet demokratike. Ndërkohë, ndryshimet po vijonin aq shpejt sa njerëzit nuk kishin kohë as të mendonin se çfarë po ndodhte dhe në ilaritet të plotë me turmën bërtisnin:"Ismail Kadare, kthehu në atdhe!". Ishin situata normale dhe shpresëdhënëse në atë kohë, por që sot ngjajnë paksa komike, për mënyrën si rrodhën ngjarjet..

Të gjithë po ëndërronin epokën e re që po lindte pas ngjarjeve të njëpasnjëshme, të protestave që shoqëroheshin me rënien e busteve të diktatorit, fillimisht në kryeqytet dhe më pas në qytetet e tjera të kudogjendura. Ishin të pabesueshme pamjet në ekranin e Tv, të shihje si shembeshin bustet e diktatorit, të plotfuqishmit të gjysmë shekullit të shkuar. Nuk mund të merrej me mend kurrë sesi mund të dhunoheshin në mënyrën më përçudnuese ato buste, para të cilave njerëzit para pak kohësh faleshin si para Zeusit. Dhuna nuk do të përfundonte me bustet, por do të vazhdonte njëlloj, në mënyrën më absurde, ndaj institucioneve, ndërtesave, ku para pak kohësh ata njerëz e kishin për nder të hynin të punonin, apo të kërkonin shërbime të ndryshme..kështu *demokracia,* aq shumë e mirëpritur nga shumica, po shfaqej çuditërisht nëpërmjet dhunës, që nuk kuptohej pse dhe çfarë po ndodhte.

Rënia e bustit të diktatorit në kryeqytet do të shënonte dhe *çastin fatlum* kur shqiptarët do të ndienin *rënien e sistemit*, mbylljen e një epoke që dukej se nuk do të

mbaronte kurrë për sa kohë jetonte diktatori. Mjaftonte vetëm rënia e busteve, që të gjithëve t'u krijohej ideja se pluralizmi i shpallur do të bëhej realitet dhe të gjithë do të gëzonin të drejtën e votës, për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, ndryshe nga sa kishte ndodhur deri tani...të gjithë po besonin se kishte ardhur edhe për shqiptarët koha e *botës së lirë demokratike* të ëndërruar në vite. Sigurisht ky moment do të arrinte apogjeun e vet, nëse rënia e busteve të diktatorit do të shënontë edhe rënien e Diktaturës.

Thuhet që jeta e njeriut nuk varet nga vitet, por nga momentet e gëzuara apo të lumtura që përjeton. Ajo kohë, për aq sa zgjati, deri në zhgënjimet e para me ngjarjet që do të vijonin, për nga emocionet bën pjesë në *kohën e lumtur*, të jetuar me vërtetësi për ata që e donin me shpirt demokracinë e ëndërruar të Perëndimit. Nesti e përmend shpesh barsoletën e kohëve të hershme të diktaturës (si shprehje e pakënaqësisë së kohës), për një rast kur një shqiptar shkoi në Japoni dhe e çuan të vizitonte varrezat. Duke vizituar varret, lexonte epitafe të ndryshme: "Ka jetuar 100 ditë", "Ka jetuar 60 ditë", e të tjera si këto, shprehje të jetëgjatësisë në ditë. Shqiptari i çuditur që nuk po kuptonte, pyet shoqëruesin se ç'kuptim kishin këto mbishkrime. - Janë vetëm ditët e vërteta të lumtura që kanë jetuar gjatë gjithë jetës së tyre, - përgjigjet tjetri. - Pse s'thua që ne duhet të shkruajmë: "Ka lindur i vdekur"! - përgjigjet shqiptari, duke e mbyllur me humor bisedën.

Ishin barsoleta që shprehnin me humor realitetin e hidhur shqiptar të dikurshëm, në pamundësi për t'u shprehur hapur; por së shpejti do të kuptohej se të

numëruara do të ishin edhe *ditët e lumtura* që do të përjetonte ky popull në vazhdimësi me shpresën se do të gëzonte më në fund *lirinë dhe demokracinë e vërtetë* të mohuar në vite.

- Do të fitojmë apo jo? - pyeste teta Niqi, Tedin e vogël, që kishte pak muaj që kishte mbushur një vit dhe kënaqej kur Tedi i përgjigjej -Po, po, pooo..!, - sepse e ndiente që Teta Niqi e priste atë përgjigje. - T'u bëftë teta kurban! - i thoshte duke e puthur në të dyja faqet dhe largohej e lumtur, sepse vërtet do të fitonte ajo që teta Niqi priste prej kohësh.

Slogani ishte *i gjetur dhe shpresëdhënës* për ata që e donin ndryshimin e madh. Për fat të keq, zgjati shumë pak ajo kohë, kur sytë e etur për liri ishin drejtuar nga studentët e Dhjetorit dhe deputetët e zgjedhur si figura të nderuara të kohës..dhe veshët ishin drejtuar nga *ata që lexonin gjithë pasion* poezitë e Kasëm Trebeshinës, që nuk u dëgjuan më. Ngjarjet pasuan me ndryshime në situatën ekonomike të popullsisë, nga njëra anë me inflacionin në rritje dhe varfërimin e shumicës së thjeshtë, që besonin se pushteti demokratik do të merrte masa për përmirësimin e gjendjes së tyre ekonomike; në anën tjetër, me pasurimin e një pakice që nuk pyeste për asgjë tjetër përveç pasurimit, me çdo mjet dhe mënyrë, duke shkelur çdo lloj ligji dhe norme, duke e konsideruar si anarki sistemin demokratik. Ndërkohë njerëzit e ndershëm vazhdonin të zbatonin ligjet si më parë.

Në këto situata më gjeti viti 1992, në të njëjtin pozicion pune në Korçë, në pritje të transferimit në Tiranë, pranë Nestit, që ndërkohë punonte dhe

jetonte aty. Kishte qenë fillimisht pedagog i fizikës në universitet, që prej mbarimit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Pas disa vitesh punësimi në Institutin e Fizikës Bërthamore, e kishin transferuar të punonte si fizikan pranë Ndërmarrjes Sizmike në Fier, sepse aty *kishte nevojë Atdheu*. Ishte kjo arsyeja që e detyroi Nestin të ndërpriste punën e filluar prej kohësh, në kërkim shkencor, dhe vetëm pas shtatë vjetësh punë aty do të rikthehej si pedagog në Fakultetin e Shkencave.

Kishin kaluar rreth dy vjet nga martesa dhe Nesti vazhdonte me ritualin, të na vizitonte kur mundej, mua dhe djalin, në pritje për shpërngulje, deri në gjetjen e një pune të përshtatshme për mua. Do ishte e vështirë për ne të përballonim jetesën nëse unë do të shkëputesha nga puna ime në Korçë, pa gjetur punë në Tiranë. Shpresat për shpërngulje rilindën së bashku me shpresën e ndryshimeve që sapo kishin filluar. Papritur marr njoftimin që pas një komisioni të ngritur për riorganizimin e Sektorit Pyjor, nisur nga rezultatet e fakultetit, isha në listën e personave të mundshëm që do të punonin në Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave në Tiranë, që do të ristrukturohej. Ishte fillimisht Prof.Thimaq Lako, ish profesori i respektuar në Fakultetin e Pyjeve, i cili më takon rastësisht dhe më jep këtë lajm të gëzuar, si anëtar i komisionit për vlerësimin e ish studentëve që falë rezultateve, do të meritonin të emëroheshin në institucionet e reja *të Regjimit të ri Demokratik*.

Shumë shpejt u njoftova se pritej miratimi nga ministri i Bujqësisë në atë kohë, si kandidate e mundshme për postin e përgjegjëses së Sektorit të

Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë në DPPK në Tiranë.

Ishte një propozim surprizë, që premtonte për mundësi të reja në ecurinë e punës, që deri tani ishte në rrjedhën e rutinës së kohës, pas disa vitesh punë, por pa mundësi zhvillimi të mëtejshëm. Ishin shenja të mbara të *Demokracisë së porsa lindur*, por edhe ky emërim nuk ishte i thjeshtë për t'u realizuar.

Ishte ditë e premte, 29 gusht 1992, ora shtatë e mëngjesit, kur shkova në Ministrinë e Bujqësisë, për të marrë përgjigje mbi emërimin që po vononte. Vonesa më kishte bërë të dyshoja dhe të parandieja që diçka po pengonte njoftimin për të filluar punë. Takoj Shpresën, sekretaren e ministrit, një vajzë e hijshme, me sjellje korrekte dhe pamjen tipike të një sekretareje të denjë për kohën. Në pamundësi për të takuar ministrin, i lë një letër sekretares, ku i bëj të ditur që isha në pritje të emërimit paksa të vonuar që nga dita e njoftimit, emërim që do të firmosej nga vetë ministri. Ndërkohë, shkova në Drejtorinë e Përgjithshme për të pyetur çfarë po ndodhte. Me vajtjen time aty, organizohet një takim i shpejtë me ish-drejtorin e përgjithshëm, M.Xh., një drejtor tjetër, K.S. dhe përgjegjësin aktual të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, P. V., që njëkohësisht ishte edhe miku ynë; por si anëtar partie ishte i detyruar të linte detyrën, sipas ligjit të sapodalë.

Fjalën e merr i pari Drejtori i Përgjithshëm, duke m'u drejtuar paksa me ndrojtje:

- Je caktuar nga komisioni për riorganizimin e Sektorit Pyjor, përgjegjëse për Sektorin e Burimeve Njerëzore

dhe Marrëdhënieve me Jashtë, 'pooor...', - duke ndaluar paksa, se diçka do të ndryshonte këtë vendim, vazhdoi:

- Mendojmë të emërohesh fillimisht sekretarja ime dhe më pas të kalosh në atë sektor. Kuptova që po ndodhte ajo që më frikësonte dhe që dikush më vuri më vonë në dijeni, se një tjetër person, jashtë vendimit të komisionit, ishte planifikuar të emërohej në atë post në vendin tim.

Ky propozim ishte i papritur për mua, por edhe i mundshëm, sepse, përveç meritës, nuk kisha asnjë mbështetje tjetër dhe fillova të flas:

- Qëllimi im është të punoj në këtë drejtori, ku të gjejë zbatim profesioni im, krahas punës administrative që do të kryej. Ky vend që po më propozoni nuk është posti për të cilin jam njoftuar dhe jam e interesuar njëkohësisht.

Në këtë moment bie zilja e telefonit dhe nga pozicioni që mori drejtori, kuptova se po fliste me një person *të rëndësishëm*. - Po shef, po, po, dakord shef, - përgjigjet dhe, duke fërkuar me dorë ballin e djersitur, ul receptorin duke m'u drejtuar me një zë paksa të dredhur: - Ishte ministri dhe më njoftoi vendimin për emërimin tënd si Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë. - Je me fat!- vazhdoi ai. *Fat është kur përgatitja takon mundësinë,* m'u kujtua në moment një shprehje e njohur dhe me sytë me lot ngazëllimi, bëj kryqin instinktivisht. Ishte vërtet një mrekulli e Zotit që sekretarja me korrektësinë e saj të natyrshme, por të dallueshme, të kishte vendosur letrën time në dosjen e ministrit dhe ministri të kish lexuar letrën time në momentin që ne po diskutonim dhe do të merrej vendimi në çast, pa asnjë ndërhyrje. Rastësia

shpesh sfidon gjithçka të planifikuar nga njeriu, për të bërë të mundur të Domosdoshmen, atë që ndryshe quhet Fat, ose Dora e Zotit, e çfaqur në mënyrë të mistershme.. ishin çaste gëzimi, kur njëkohësisht mendova se ishte shenjë pozitive që po ndihej era e Demokracisë së ëndërruar.

- Ishin ditët në kohën e Petraq Kolevicës, që nuk mund të përsëriten, - më thotë një ditë ish-ministri R. Uka, ministri i parë i Bujqësisë, pas ndryshimeve të sistemit, kur në një takim të rastësishëm, për mirënjohje e falënderova për emërimin tim të dikurshëm.

Në moment m'u kujtua takimi me P. Kolevicën në Korçë, kur ishte kandidat për deputet në zgjedhjet e para pluraliste...takim me një entuziazëm të papërshkruar, që me fjalimin e tij u dha shpresë dhe besim qytetarëve korçarë, që do ta votonin pa dyshim me shumicë të konsiderueshme votash. Kishte të drejtë ish-ministri i respektuar Uka, që më la të kuptoja se kish kryer vetëm detyrën, por që nuk do të kthehej më ajo kohë.

Më 1 shtator, ditën e hënë do të filloja punën, që fati ma kishte rezervuar ndoshta prej kohësh për të arritur deri këtu. Kënaqësi e veçantë të kontribuoje në profesionin aq të dashur tashmë, në institucionin më të lartë të pyjeve, në një sektor që premtonte jo vetëm për një ecuri në ngritje të nivelit profesional, por edhe një mundësi për një kontribut më shumë në kushtet e reja. Kishte lindur besimi se çdo gjë do të ndryshonte për më mirë...ishte kënaqësi dhe përgjegjësi të ishe pjesë e kontributit në hedhjen e hapave të para në riorganizimin e Sektorit Pyjor në frymën e *demokracisë së ëndërruar* prej vitesh.

Isha larguar nga Pylli i Rezervatit Cangonj, që e doja aq shumë, por tani do të isha përsëri afër 'Pyllit', me tjetër lloj kontributi, që do të më bënte të ndihesha përsëri pranë tij. Do të bëhej riorganizimi në mënyrën e re të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, me legjislacion të ri, rregullore të reja, personel të ri, ku krahas Marrëdhënieve me Jashtë, sektori që drejtoja për pjesën e Burimeve Njerëzore, ishte sektori përgjegjës për ndryshimet që do të ndodhnin.

Për sa u përket Marrëdhënieve me Jashtë, pritej një organizim i ri krejt ndryshe për sa u përket marrëdhënieve me të huajt dhe organizatat ndërkombëtare në fushën e pyjeve. Lidhur me ndryshimet në menaxhimin e Burimeve Njerëzore kisha rezerva, sepse ligji i ri që përjashtonte punësimin në ministri të ish-anëtarëve të Partisë së Punës, mund të përjashtonte njëkohësisht edhe specialistë me përvojë, që ishin të nevojshëm të vazhdonin detyrën që deri atëherë e kishin ushtruar me profesionalizëm. Në një farë mënyre, më dukej si një luftë e re klasash nën petkun e *Demokracisë*, me pasoja ekonomike dhe shoqërore, për ata që rastësisht do të mbeteshin viktima të asaj lufte... kurse unë, me firmosjen e urdhrave, edhe pse pa dashur, detyrimisht do të hyja te *zbatuesit e ekzekutimit*. Ishte kjo ndjesia që provoja veçanërisht kur isha e detyruar të firmosja largimin nga puna të ndonjë ish kolegu të njohur për vlera profesionale.

Nuk mund të harroj keqardhjen kur më duhej të firmosja midis të tjerash largimin nga detyra të ish drejtorit të Ndërmarrjes Pyjore në Korçë, K.Shore, me të cilin kishim bashkëpunuar vitet e fundit të punës sime në Korcë dhe më kishte imponuar respekt për

korrektësinë dhe aftësinë e tij në profesion dhe drejtim... por si ish anëtar i Partisë së Punës, në bazë të vendimit në fuqi për kohën, duhej të largohej nga detyra.

Në të vërtetë, më vonë rezultoi që për një pjese të mirë të të larguarve ishte një shans, një mundësi e re për të hyrë të parët në *ekonominë e tregut* dhe për t'u kthyer më vonë, së bashku me Partinë e tyre, më të fuqishëm se më parë.

Nuk di nëse ishte rastësi, por kështu ndodhi në të vërtetë. Rrjedha e ngjarjeve ishte e tillë që të entuziazmuar nga ideja e ndryshimeve që shpresoheshin, nuk kishte hapësira për dyshime.

Ishte një punë me ngulm, e ngarkuar edhe me vështirësi. Përveç njohurive profesionale dhe përvojës së terrenit, mungonte pjesa tjetër e përvojës së nevojshme për atë pozicion të ri pune. Në mungesë të kompjuterit dhe të makinave të shkrimit për të gjithë, në atë kohë punohej me shkrim dore dhe më pas i kaloheshin shkrimet daktilografistes për t'i shtypur. Për ngarkesën dhe intensitetin e punës që kisha, më duhej të punoja drejt e në makinë shkrimi; prandaj m'u desh të mësoja fillimisht makinën e shkrimit, që nuk e kisha përdorur asnjëherë më parë. Mbi të gjitha, duhej kujdes, sepse për gabimin më të vogël, më duhej ta hiqja fletën dhe të rifilloja nga e para, gjë që më ndodhte ndonjëherë.

Ndërkohë ishin të shumta shërbimet në Ndërmarrjet e Pyeve në të gjithë Shqipërinë, me ndryshimet e riorganizimit, që pasonin me ndryshimet e emërimeve fillimisht të drejtorëve dhe më pas të personelit tjetër, ku në tërësi përbënin rreth një mijë punonjës në të gjithë Shqipërinë.

Vështirësitë qëndronin jo vetëm në veprimet operative, por edhe në ndjesitë në përballje me njerëzit, që pa dashur binin pre e *politikës* që kishte filluar të vendoste gjithçka mbi gjithçka. Situata po dukej shumë e ngjashme me të kaluarën, por tashmë, në kushtet e *Demokratizimit të Ekonomisë dhe të Reformave Demokratike*. Ishin këta terma e të tjerë si këta që justifikonin edhe veprime paradoksale, me të njëjtat mënyra dhe me të njëjtin mentalitet të së kaluarës, por që si të domosdoshme për Reformat Demokratike, do të ndodhnin; dhe këto reforma do të përsëriteshin me çdo kosto sa herë *partitë do të ndërronin portat*.

Për sa i përket punës në fushën e marrëdhënieve me të huajt, ndryshonte gjithçka, sepse *partitë i mbanin portat të hapura ndaj të huajve* dhe nuk mungonte motivimi për bashkëpunim, nga i cili përpiqeshim të merrnim më të mirën e mundshme në drejtim të përvojës dhe mbështetjes së pritshme prej tyre.

Kontaktet me të huajt kishin vështirësinë e gjuhës së huaj, sepse në fillim mund të komunikoja vetëm në gjuhën franceze dhe italiane, por jo në më kryesoren që duhej, gjuha angleze. Shumë shpejt fillova të studioj anglishten si autodidakte, me ndihmën e Nestit fillimisht (qeshim kur kujtojmë fillimin), por shumë shpejt do të hyja privatisht në kursin e gjuhës angleze me pedagogen e mirënjohur A. D., socialiste e njohur për kohën dhe më pas. Më imponoi respekt, në tërësi si pedagoge, por edhe për korrektësinë e saj, kur më duhej të këmbëngulja për pagesën për orët kur mungoja, që ishte përgjegjësia ime, sepse kursi vazhdonte me personat e tjerë. Nuk harroj gjithashtu ndjesinë e saj *si e persekutuar* për kohën dhe

ndrojtjen për të mos na vënë në siklet ne që njiheshim si *nëpunës demokratë*. Ishte jo vetëm qëndrimi i kohës ndaj ish-komunistëve, por edhe fryma e trashëguar nga diktatura, që tani u kthehej *boomerang* atyre që ishin ushqyer deri tani me atë frymë.

Një herë që nuk kishim çelësin e zyrës ku shkonim zakonisht, pedagogia na propozoi me ndrojtje zyrën e saj në ndërtesën e PS-së, por ne na duhej të hynim në fshehtësi, (si ilegalët komunistë në kohën e celulave) për të mos u parë nga ndonjë *sy i keq demokrat*. Me gjithë vështirësitë e kohës, kursi vazhdoi deri në dhënien me sukses të provimit në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.

Takimet dhe lidhjet e shpeshta me të huajt do të më ndihmonin së tepërmi jo vetëm në përvojën e punës, por edhe në përvetësimin e gjuhës angleze, veçanërisht në gjuhën profesionale, sepse përvetësimi i gjuhës në të gjitha përmasat nuk mund të arrihej vetëm me mbarimin e kursit dhe dhënien e provimit. Ishte kjo arsyeja që udhëtimet jashtë vendit ishin një ndihmesë edhe në drejtim të përsosjes së gjuhës, si një mjet shumë i rëndësishëm në komunikimin profesional dhe jo vetëm.

Herën e parë që kam folur anglishten zyrtarisht, u detyrova nga rastësia, kur në mungesë të përkthyesit në takimin me zëvendësministrin Federal të Pyjeve, në Uashington, shoqëruesit amerikanë të delegacionit më drejtohen mua që të përktheja. Ndihesha fillestare në anglisht (pas pak muajsh kurs, kur nuk kisha dhënë akoma provimin dhe kisha folur shumë pak), por në përgjithësi amerikanët të japin zemër kur komunikojnë me të huajt në gjuhën e tyre dhe nuk i kursenin komplimentet, duke më thënë që flisja mirë. Ndërkohë

që unë vazhdoja të kundërshtoja, se nuk mund të merrja përgjegjësinë e përkthimit në atë takim të nivelit të lartë, ata që nuk donin të anulohej takimi këmbëngulën aq shumë sa u detyrova të pranoja. E quaj fat, që biseda u përqendrua vetëm në çështje me terma teknikë, me të cilët isha familjarizuar disi dhe, mesa u duk, takimi kaloi më mirë nga sa e mendoja, si *provim i parë* në përkthim anglisht. Shoqëruesit amerikanë mbetën të kënaqur, sigurisht në mungesë të përkthyesit, i cili erdhi pasi mbaroi takimi, së bashku me dy pjesëtarë të tjerë të delegacionit. - Ku ishit? - i pyesim të gjithë njëzëri nga kurioziteti, por edhe nga shqetësimi. U vonuam për të blerë diçka, u përgjigjën personat për të justifikuar përkthyesin, që i ishte dashur t'i shoqëronte gjatë kohës që do të bënin *shopping* te një dyqan gjatë rrugës. Ishte një incident i papëlqyeshëm për delegacionin tonë, për mua gjithashtu, që fillimisht u gjenda në vështirësi, por dhe kënaqësi kur besova që vërtet amerikanët që na shoqëronin u ndjenë të kënaqur nga përkthimi, gjë që do të më nxiste për të filluar të përktheja. E dija që mbetej edhe shumë punë, në raport me objektivin që i kisha vënë vetes; duhej kohë dhe praktikë, gjë për të cilën do të më ndihmonin edhe trajnimet dhe udhëtimet në vende të ndryshme sipas agjendës së veprimtarive me jashtë, ku unë përfaqësoja institucionin dhe vendin njëkohësisht.

Si çdo gjë për herë të parë, udhëtimi i parë jashtë ka mbetur në historinë e udhëtimeve dhe misioneve jashtë vendit. Ishte më tepër një udhëtim miqësor i drejtorit të përgjithshëm M.Xh. në jug të Italisë, i ftuar dhe i mbështetur financiarisht nga një Shoqatë Gjuetarësh,

që e shihnin Shqipërinë si një portë të porsahapur për gjueti. Ishte nëntor 1992 kur nisemi me traget në drejtim të Jugut të Italisë. Shumica e pasagjerëve ishin emigrantë shqiptarë, që për nga pamja të linin të kuptoje se ndiheshin të ekzaltuar për mundësinë e ikjes drejt Italisë. Ne, gjithashtu, ndiheshim të emocionuar që për herë të parë po kalonim kufirin shqiptar dhe do të vizitonim një vend që aq shumë e kishim ëndërruar për ta parë nga afër një ditë, atë që e kishim parë vetëm në ekranin e televizorit. Gjithçka shkoi normalisht, përveç një lloj zhgënjimi nga udhëtimi në traget, më pas vizita në Jugun e Italisë, ku shijuam më shumë picën napolitane...e kujtoj shpesh këtë herë të parë kur haja picë dhe më duhej të prisja të shihja italianët të fillonin të hanin, për të parë mënyrën si duhej ngrënë pica. Kënaqësia ishte në vazhdimësi të udhëtimit në Veri, që përkonte me përfytyrimin tonë për Italinë, për sa u përket vlerave të jashtëzakonshme të historisë, artit, arkitekturës, muzikës dhe gjithçka tjetër të lidhur me kulturën italiane. Isha në rolin e përkthyeses dhe nuk mund të harroj kënaqësinë e të folurit të gjuhës italiane, të bukur dhe melodioze, që e kisha studiuar, lexuar, dëgjuar, por për herë të parë m'u desh ta flisja në atë udhëtim të parë. Nuk mungonte humori për shkak të gjuhës, kur drejtori fliste edhe ndonjë fjalë italisht që i kishte mbetur në kujtesë nga Tv, si shumica e shqiptarëve në atë kohë.

- Kur të vini në Shqipëri do të pjekim *Agnelin* në hell-, që donte të thoshte *qengjin në hell* dhe vetëm fjalën qengji e tha italisht, kurse me shenjat e duarve u dha të kuptonin pjekjen në hell. Për italianët mori kuptimin e

Agnelit të famshëm të Fiat-it, që do të piqej në hell në Shqipëri dhe krisi gazi në tavolinë. E kujtoj për humor atë vizitë, që nuk e kuptoja përse ishim ne aty, por shumë shpejt kuptova që ishte *xhentilesa e gjuetarëve miq italianë që do të sajdisnin drejtorin.*

Ishte një ndjenjë keqardhje, se si u ndjemë në atë udhëtim të parë, që ndoshta ishte normale për njerëz që shihnin për herë të parë Perëndimin, pas një jete izolimi të pashoq. Duhej të na e kujtonte italiani vënien e rripit në makinë, që për ne ndodhte për herë të parë edhe pse kishim filluar të udhëtonim me makinat e punës, nuk kishim provuar të vinim rripin e sigurimit në makinë.

Pas vizitave zyrtare të organizuara posaçërisht për ne, na dhanë kohë edhe për *shopping*, për më tepër që kishin ardhur në Shqipëri dhe e njihnin situatën e tregut në vitin 1992. Mua më shoqëroi vajza e njërit prej anëtarëve të shoqatës, e cila më propozoi të hynim në një Qendër Tregtare (hera e parë për mua). Ishte shokuese, kur për herë të parë pashë se çfarë ishte ajo që quhej *Qendër Komerciale*, dhe pas kësaj, kur pashë çmimet dhe mendova që në xhep kisha lireta në vlerën e njëzet dollarëve, që nuk do të më mjaftonin as për një lodër të thjeshtë për djalin..u ndjeva aq keq sa i them shoqërueses të mos vazhdonim, por të dilnim jashtë. Ajo, që mesa u duk e kuptoi arsyen (e parapërgatitur nga i ati për gjendjen e asaj kohe në Shqipëri), më pyet për moshën e djalit. Mjaftoi ky moment që ndjeva se nuk mund t'i përmbaja lotët. U ndjeva shumë keq, të mos kisha mundësi të provoja kënaqësinë t'i blija vetë një dhuratë djalit tim; u ndjeva ngushtë kur ajo vajzë e re, këmbënguli të blinte një dhuratë që ma dhuroi me

shumë delikatesë. Më në fund edhe unë e gjeta një lodër me kurdisje, nga ato që shiteshin në rrugë, që kushtoi sa liretat që kisha në xhep, por me kënaqësi më të madhe se për lodrën dhuratë. Stresin e atij shqetësimi paksa të ndërlikuar e ndjeva edhe ditë më vonë pas kthimit në Tiranë.

Shqetësim ishte gjithashtu edhe njoftimi që mori drejtori nga ministri, një ditë para kthimit, për t'u kthyer urgjentisht në Tiranë. Bëhej fjalë për një firmë të tij në çështjen aq të përfolur të eksportit të druve të arrës, për të cilën u pushua nga detyra dhe më vonë kaloi para drejtësisë (ndoshta si fajtor pa faj). Sinqerisht ndjeva keqardhje për atë viktimë të kohës...mbresa jo të mira nga ai udhëtim tragjiko-komik do ta quaja më vonë, që për fat të mirë nuk u përsëritën në udhëtimet e mëvonshme.

Misionet në vazhdim, jashtë shtetit, përbënin pasurim përvoje dhe njohurish jo vetëm në fushën profesionale, por edhe në atë të komunikimit dhe në të gjitha dimensionet, përfshi ato kulturore. Kjo ndihej veçanërisht në vendet për të cilat kishim lexuar aq shumë, sa na dukej sikur i kishim parë në të vërtetë.

Të papërshkrueshme ishin emocionet e vizitës së parë në Paris, në vitin1995. Kënaqësinë e vizitave e shoqëronte ngutja për të bërë sa më shumë vizita, në pak kohë që kishim të mundësuar, që do të shuanin kuriozitetin e fjetur në vite dhe të ushqyer deri atëherë vetëm nëpërmjet librave. Nuk mund të mendoja në atë kohë që pas vitesh Franca do të bëhej atdheu i dytë i fëmijëve të familjes sonë dhe do të kisha mundësi në vazhdimësi për t'u ushqyer me kulturën franceze.

Për rastësi, vizitat turistike i bëmë me një zyrtare rumune, tek e cila vura re emocione dhe impresione shumë të ngjashme me ne, për çka vizituam. Kuptova njëkohësisht ndikimet e sistemeve të ngjashme nga vinim, megjithëse egërsia e diktaturës sonë nuk ngjasonte me atë të vendeve të tjera të kampit socialist.

Pjesëmarrja në eventet e ndryshme ishte jo vetëm përfaqësim protokollar, përvojë,komunikim, pasurim njohurish shumëdimensional, por emocion i veçantë ishin edhe udhëtimet në natyrë, në pyjet e mbrojtur dhe të mirëqeverisur, deri edhe ato të natyrës së virgjër, të ruajtur si zona të mbrojtura apo edhe monumente natyrore, shpesh të mahnitshme.

- E paharrueshme ka ngelur vizita në pyllin e famshëm *Białowieza,* në Poloni, një pyll i madh fushor, i mbrojtur nga *UNESCO*, si një pyll relikë i lashtë, strehë e kafshëve dhe shpendëve të shumëllojshme... thjesht duhet të ngrije kokën për të soditur zogjtë e mrekullueshëm shumëngjyrësh, të cilët me cicërimat e tyre krijonin një kakofoni tingujsh të rrallë e të paharrueshëm.

Interesant ka qenë fakti që këto do t'i ndeshnim jo vetëm në botën e zhvilluar, ku mbrojtja me ligj funksionon normalisht, por edhe në thellësi të natyrës afrikane. Nga njëra anë të befasonin radhët e gjata dhe të frikshme për ushqim, të njerëzve të uritur dhe nga ana tjetër natyra e mbrojtur më së miri, që tregonte se edhe ato qenie, përballë të cilave ndiheshe e keqardhur por edhe e frikësuar, e kishin të shenjtë pyllin. Aty kam ndier jo vetëm keqardhje për praninë e urisë në masë sot në shekullin e shkencës dhe të teknologjisë, por edhe

respekt për ata njerëz të mjeruar, të dënuar nga lakmia e më të fuqishmëve, që historikisht kanë sunduar më pak të fuqishmit. Duke shijuar peizazhet e rralla natyrore të pyjeve të virgjër të Afrikës, Tailandës e të tjera vendeve të kontrasteve të dukshme, të krijohej ndjesia se ato u përkisnin më tepër turistëve të huaj sesa atyre qenieve, që dukej se i përkisnin ndonjë planeti tjetër.

Kontrastin e kemi përjetuar edhe në SHBA, gjatë vizitës tepër interesante tek *Amishët*, siç quhet komuniteti që vazhdon të jetojë në mënyrën e tij tradicionale të shek. XVIII, (në mungesë të energjisë elektrike, makinave etj.) në mes të Amerikës; por në këtë rast jo për shkak të varfërisë, por të besnikërisë ndaj besimit të tyre fetar dhe mënyrës tradicionale të jetesës së të parëve të tyre. Mbresëlënëse nuk ishte vetëm mënyra e jetesës, punës, pastërtisë, por mbi të gjitha vlerat e respektuara prej tyre, si modestia, respekti, bashkëpunimi në komunitet, të gjitha në kontrast me botën e zhvilluar përreth. Kanë kaluar shumë vite dhe nuk e di si ai komunitet me vlera të veçanta mund të vazhdojë të përballojë egërsinë e Teknologjisë, që nuk ka të ndalur sot. Nuk e ve në dyshim stoicizmin e tyre, përderisa u kanë mbijetuar shekujve të kaluar, gjë që vërteton më së miri forcën e besimit te njeriu.

Mbresave të veçanta nga udhëtimet jashtë vendit, nuk do të mungonte t'u shtohej vlera e njohjes së kulturave të ndryshme jetësore dhe artistike. Nuk mund të harroj kurrë ndjesitë tronditëse nga emocionet kur u gjenda përballë pikturës origjinale të famshme të Shishkin-it, "Mëngjes në Pyllin e Pishës" dhe pikturave të tjera të tij të frymëzuara nga pylli, si edhe të piktorëve të tjerë të

mëdhenj rusë, që kanë përjetësuar Pyllin si madhështi e nënës Natyrë.

Ishin emocione të tjetër natyre, nga ato kur gjendesh në brendësi të pyllit, në magjinë e bukurisë mahnitëse, aromës së papërsëritshme që ndihet brenda tij, por të ngjashme për nga fuqia e ndjesisë së të bukurës magjepsëse që ndieje brenda teje. Ishte kjo ndjesi e magjishme që të përfshinte në Galerinë Shtetërore të veprave të artistëve të famshëm rusë në Moskë, që është një nga muzetë më të vlerësuar të artit në Rusi dhe më gjerë.

Ndiheshim mirë në kontaktet e takimet me të huajt, veçanërisht kur ndienim interesimin e tyre dhe mbështetjen e institucioneve ndërkombëtare për vendin tonë në fushën e mjedisit dhe të pyjeve, në veçanti.

Realisht të huajt shfaqeshin të interesuar për zhvillimet në fushën e pyjeve, ku u zhvilluan shumë studime paraprake. Ata ishin të entuziazmuar fillimisht, për sipërfaqen që zinin pyjet në Shqipëri dhe tregonin interes dhe këshillime për zhvillime të mëtejshme në këtë sektor. Nuk kaloi shumë kohë dhe nga Banka Botërore, në bashkëpunim me FAO-n, u propozua një projekt madhor që do të merrte përsipër ristrukturimin e Sektorit Pyjor në Shqipëri.

Ishte projekti i parë që hapi siparin e projekteve të shumta edhe në sektorët e tjerë, me *shpresën e madhe* që ky vend shumë shpejt do të shndërrohej, për të hyrë në rrugën e integrimit në BE. Në këto kushte ishte normale që investimet të fillonin në sektorët me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore të vendit, bazë për zhvillimin normal dhe në rritje të

vazhdueshme të ekonomisë së një vendi në zhvillim. BB dhe FAO ishin të njohura prej kohësh si institucione të ndaluara për ne dhe ofrimi i tyre në kushtet e ndryshimit dukej si shpëtimi i aq shumë pritur, që do të shndërronte gjithçka në Sektorin Pyjor dhe jo vetëm. Në këto kushte, projekti dhe asistenca në formë ndihmash të huaja ishin të mirëpritur pa hezitim, duke filluar nga ministrat dhe të gjithë të tjerët me radhë, që nuk ngurronin të jepnin miratimin e tyre. *Të huajt flisnin dhe shqiptarët dëgjonin dhe miratonin pa hezitim dhe me shumë entuziazëm* propozimet *që ofronin ekspertët e bankave, shumë xhentilë me vendin tonë*.

Situatat shpesh merrnin nuanca paksa komike, kur kuptoje që një pjesë e mirë e përfaqësuesve të institucioneve që jepnin miratimin nuk e kishin idenë se çfarë do të ndodhte me këtë projekt në realitet, cilat do të ishin benefitet dhe rreziqet, apo detyrimet që do të kishte shteti (taksapaguesit shqiptarë) në vite dhe shumë detaje të tjera për këto investime me kredi afatgjata.

Ishte koha kur pas shumë shkatërrimesh, që shoqëruan entuziazmin për ndryshimet që do të ndodhnin, projektet shiheshin si *çeku i bardhë* i premtuar që në mitingjet e para. Të huajt, ndërkohë, ndiheshin shumë *të kënaqur dhe komodë* të punonin me shqiptarët, aq sa shpesh të krijohej përshtypja se i shihnin në përgjithësi si njerëz të sapodalë nga primitiviteti i kohës së diktaturës, që prisnin *gojë hapur* gjithçka ata ofronin. Këtë përshtypje ua përforconte të huajve edhe njohja e jetës reale të shoqërisë shqiptare në atë kohë, si përballja me mungesën e ujit, të energjisë

elektrike, të ushqimeve të pakontrolluara që po hynin pa kriter nga shumë drejtime dhe me të gjitha mënyrat, e të tjera si këto. Nuk mund të harroj një moment, kur një specialiste belge A.Ligne, me të cilën kishim bashkëpunuar në kuadrin e Projektit të Pyjeve, në Tiranë, vjen të më takojë në hotel ku qendroja gjatë një misioni pune në Bruksel. Kishte marrë me vete edhe fëmijët e saj, të cilëve, pasi më prezanton, u drejtohet me fjalët: "Duhet të dini që Zhaneta përballet me një punë dhe jetë të vështirë në Tiranë, në kushtet ku shpesh mungon uji, energjia elektrike e shumë gjëra të tjera..". Fëmijët e saj më shihnin paksa të habitur dhe nuk e kuptova, nëse mund të imagjinonin atë realitet që mamaja e tyre e kishte përjetuar gjatë qendrimit në Tiranë në ato vite.

Gjendjen ekonomike e rëndonte papunësia ku u përfshinë me shumicë njerëzit e thjeshtë që dolën të papunë nga ish-ndërmarrjet prodhuese shtetërore, por edhe një pjesë e ish komunistëve që u pushuan nga puna me vendim të posaçëm si ish komunistë. Ishte kjo pjesë e shoqërisë shqiptare që e shihnin tregtinë si të vetmen mënyrë që i joshte për të përballuar jetesën, apo për t'u pasuruar me çdo mënyrë, pjesa tjetër.

Tregtia në atë kohë, por edhe në vazhdim, ishte një veprimtari fitimprurëse shumëpalëshe sepse stoqet e magazinave të përmbushura të Perëndimit po gjenin tregje të reja, në Lindje, një nga të cilët ishte edhe tregu shqiptar. Të gjithë besonin se po u buzëqeshte fati duke fituar me shkëmbime mallrash, por edhe monedhash, nëpërmjet kambizmit, që po bëhej një nga bizneset e lakmuara të kohës. Monedhat shqiptare dhe të huaja

po qarkullonin lirisht më tepër në tregun e zi. Lojërat e fatit, Firmat Piramidale, po lulëzonin me një shpejtësi marramendëse, duke gllabëruar një pjesë të mirë të fitimeve të njerëzve që donin të pasuroheshin shpejt, duke rrezikuar çdo gjë që kishin, deri edhe pronën më të dashur, banesën. Këto dhe shumë të tjera të ngjashme me këto panorama, mjaftonin që nga të huajt të kuptohej lehtësisht psikologjia e një populli të sapodalë nga izolimi, i gatshëm të përqafonte çdo ndryshim që do t'i mundësohej nga të tjerët.

Në këto rrethana shumë shpejt u miratua nga qeveria projekti shumëmilionësh që *do të ristrukturonte Sektorin Pyjor*. Si koordinatore e komponentit të projektit për Zhvillimin Institucional të Sektorit Pyjor, më duhej fillimisht të studioja projektin se çfarë do të arrihej së fundi nga ky investim madhor. Nuk ishte e thjeshtë, fillimisht përballja me një filozofi të re, në kushtet e zhvillimeve të reja të ekonomisë së tregut. Ishte ngarkesë, por mbi të gjitha ishte përgjegjësi që kërkonte përkushtim dhe kohë, përveç punës së zakonshme. Përgjegjësia ishte e shtrirë gjithandej, sepse, në kushtet e ristrukturimit, ishte përgjegjësi e sektorit që drejtoja, për riorganizimin e të gjitha ndërmarrjeve të vendit, jo vetëm të skemave të reja të riorganizimit, por edhe të stafeve të personelit.

E njohur dhe shfaqur lirshëm për pikëpamjet demokratike të kohës, (megjithëse nuk isha anëtare e PD-së), shihesha nga të sapoemëruarit e Ministrisë së Bujqësisë, por edhe të zgjedhurit e PD-së, si mbështetëse e ndryshimeve demokratike dhe në mirëbesim merrja për zbatim porositë e tyre. Nevojitej përfshirje, lëvizje

nëpër ndërmarrje në rrethe, kontakte, komunikime, që jo gjithmonë ishin të thjeshta për t'u realizuar, veçanërisht kur vendimet filluan të merrnin gjithmonë e më tepër *ngjyra politike*, që shpesh krijonin konflikt me vlerat e meritokracisë.

Rrjedhën e ngjarjeve e ndryshoi kolapsi i shkaktuar për shkak të falimentimit të Firmave Piramidale, ku njerëzit humbën kursimet, deri edhe shtëpitë e banimit dhe shoqëria shqiptare u përfshi nga një krizë e rëndë ekonomike dhe shoqërore. Nuk mund të harroj lotët e një mikut tonë të familjes që kishte humbur të gjitha kursimet e jetës, së bashku me shtëpinë që e kishte shitur, për t'i depozituar në një firmë piramidale që sapo kishte falimentuar.

- Humba gjithçka - më thotë një shoqe që e takoj rastësisht dhe vura re tek ajo trishtimin që shprehte gjendjen e saj jo normale.

- Nuk humba asgjë - më thotë një e njohur e rastësishme, që edhe pse ishte duke falimentuar firma ku kishte depozituar një shumë të konsiderueshme lekësh, kishte mundur t'i tërhiqte *me ndërmjetësi* në kohën e duhur.

Edhe ne, si shumica në atë kohë, kishim depozituar një shumë të vogël kursimesh, por Nesti, *që e njihte mirë prej kohësh pokerin,* përsëriste shpesh që në fund do të fitonin të zotët e firmave...prandaj luajti pak kohë dhe i tërhoqi lekët para se firmat të falimentonin. Kjo bëri që të mos pësonim goditjen që pësuan një masë e madhe e shqiptarëve dhe një pjesë e mirë e të njohurve tanë në atë kohë, pasojat e së cilës do të ndiheshin shumë shpejt në jetën e shqiptarëve.

- Ishim në një udhëtim studimor në SHBA, në vitin 1996, të financuar nga Projekti Amerikan për Pyjet, duke biseduar gjatë një takimi me palën amerikane. Midis të tjerash na pyetën për situatën në vendin tonë. Ishin në dijeni mbi Firmat Piramidale në Shqipëri, që në atë kohë *po lulëzonin*, por kur na panë *të entuziazmuar*, që mendonim se shqiptarët po pasuroheshin, njëri nga përfaqësuesit e palës amerikane, një burrë i thinjur me mjekër, fiziku i të cilit shprehte siguri dhe përvojë, na thotë:

- Jooo, mos besoni te firmat piramidale, - se këtë e ka pësuar populli amerikan në të kaluarën, kur humbën të gjithë ata që kishin investuar në kompanitë që rezultuan mashtruese. Ndërkohë, mua më lindi pyetja: "Si ka mundësi që Qeveria Shqiptare nuk merr parasysh përvojën e hidhur amerikane, para shumë vitesh, për t'i ndaluar në kohë Firmat Piramidale?!"

Partia Demokratike, aq shpresëdhënëse deri në atë moment, pas asaj situate kaotike që përfshiu të gjithë vendin, nuk mund të mos i humbte zgjedhjet, si përgjegjësja kryesore e situatës. Në pushtet kthehet Partia Socialiste, që njihej si *pasardhëse e rinovuar* e Partisë së Punës në kohën e diktaturës dhe që në zgjedhjet e mëparshme kishte humbur me një diferencë të konsiderueshme votash. Tani mund ta takoja lirisht ish-pedagogen e gjuhës angleze, por kursi kishte mbaruar dhe ajo mbeti vetëm një kujtim që më vinte shpesh ndërmend kur e shihja të aktivizuar në elitën socialiste dhe më pas të ngjiste shkallët e karrierës deri si ministre.

Pavarësisht situatës, puna vazhdonte me ngulm me riorganizimin e Sektorit Pyjor dhe Projektin. Ndryshimet

politike u shoqëruan fillimisht me ndryshimin e drejtorëve të përgjithshëm. Drejtori i mëparshëm F. Hoxha, që vinte nga një familje e persekutuar e regjimit komunist, i njohur për aktivitetin e tij në PD, zëvendësohet me K. Malaj, ish-drejtor në atë drejtori, por i larguar si ish-anëtar i Partisë së Punës në kohën e ardhjes në pushtet të PD-së. Për mua nuk do të përbënte problem ky ndryshim, (pavarësisht pikëpamjeve politike të kohës) sepse me Kolën njiheshim që në fakultet; K. Malaj (një vit pas meje) njihej si student i dalluar dhe besoja, ashtu sikurse ndodhi, që falë respektit të ndërsjellë nuk do të kisha ndryshim pozicioni në punën time, pas riorganizimit të institucionit.

Puna në kushtet e reja eci normalisht me zhvillime dhe realizime të objektivave të reja, si dhe ndryshime të efektshme në mënyrën e riorganizimit dhe statusit të DPPK, falë edhe impenjimit në atë kohë të K. Malajt dhe mbështetjes nga Partia Socialiste që ai përfaqësonte. Pati ndryshime edhe të stafit të Projektit të BB, (funksiononte jashtë nesh si institucion, por në funksion të riorganizimit të Sektorit Pyjor), që deri atëherë kishte hyrë në rrugë të mbarë...por këto ndryshime u ndjenë edhe në ndryshimin e mënyrës së menaxhimit të projektit, që me gjithë punën dhe përpjekjet, nuk mund të mos prekej nga probleme të shumta. Më vonë do të bëhej e qartë që këto ndryshime ishin për shkak të interesave, pse jo edhe të korrupsionit që kishte filluar të ndihej në atë kohë në institucionet shqiptare për t'u rënduar gjithnjë e më tepër në vazhdimësi...Ishte kjo një arsye më tepër, që një nga objektivat që do t'i shtohej Projektit nga

ekspertët e Bankës Botërore gjatë rrugëtimit të tij, ishte lufta kundër korrupsionit.

Kërkesa e parë që i paraqita drejtorit të ri, me fillimin e punës, ishte heqja e përgjegjësisë së licencave të shfrytëzimit, praktikë që më shqetësonte, sepse personalisht isha kundër licencimit pa kriter të atyre që donin të merreshin me veprimtarinë e shfrytëzimit të pyjeve. Miratimi i kërkesës sime nga Drejtori i Përgjithshëm donte të thoshte një rifillim të mbarë për mua dhe në vazhdimësi si drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

E kisha me shumë dëshirë atë punë që po më ndihmonte në ngritjen time profesionale, për të cilën isha përpjekur shumë. Megjithëse nganjëherë e mendoja edhe largimin nga ajo punë, për shkak të shqetësimeve dhe problemeve në rritje, e kisha të vështirë vendimmarrjen, sepse ishte punë e lidhur me profesionin dhe përvojën time profesionale në zhvillim. Linte paksa për të dëshiruar ana shoqërore, ndoshta për shkak të emërimeve, që shpesh bazoheshin mbi parapëlqime partiake dhe jo te niveli i duhur i kualifikimit profesional..kishte edhe qejfmbetje lidhur me udhëtimet jashtë shtetit, e të tjera si këto, që ishin bërë normale dhe të paevitueshme për kohën.

- Më ke munguar shpesh, - më thotë një ditë im bir, tani që është vetë baba, duke sjellë pas shumë vitesh kujtimet e tij të fëmijërisë.

Nëse do të më pyesnin për të kaluarën, e vetmja pendesë është prania ime jo sa duhej pranë djalit, shpesh, kur më duhej të merresha me punë edhe jashtë orarit të punës, apo të shkoja me shërbime pune brenda

dhe jashtë vendit. Ishte e dhimbshme që nuk mund t'i gjendesha pranë Tedit në ditën e parë të Vitit të Parë Shkollor, në shtator 1996, për shkak të shërbimit të detyruar në SHBA. As dhuratat që ai i priste me shumë dëshirë, nuk do të zëvendësonin mungesën time.. sigurisht pranë tij ishte Nesti dhe mamaja ime, të cilëve u jam shumë mirënjohëse për përkushtimin e tyre ndaj djalit, në rastet e mungesës sime, si për mbarëvajtjen në shkollë ashtu edhe për shërbimet e tjera.

Ndihesha shumë e kënaqur me rezultatet e Tedit në mësime, por u ndjeva shumë keq, në një takim me mësuesen, kur më tha se, pavarësisht rezultateve, Tedi ishte indiferent gjatë mësimit në klasë. Konkretisht më tregoi një rast që Tedi nuk e kishte ngritur dorën, edhe pse e dinte zgjidhjen e një ushtrimi në fizikë, dhe kur mësuesja e kishte ngritur me bindjen që mund ta dinte zgjidhjen, nuk kishte dalë e zhgënjyer. Mësuesen e fizikës e kishte shqetësuar fakti që kishte pasur drejtorin kontroll atë orë dhe nuk do të ishte ndier mirë nëse asnjë nxënës nuk do të dinte të zgjidhte ushtrimin. Ishte një fakt që më shqetësoi dhe më bëri të reflektoja, kur vura re që shqetësimi im pati efektin e duhur në sjelljen e mëpastajme të Tedit.

Puna vazhdonte me ulje-ngritjet e saj, por edhe me arritje pozitive, veçanërisht në komponentin e zhvillimit institucional, që ishte përgjegjësia ime personale, si punë shtesë e punës normale të Drejtorisë. Projekti përfundoi pas 10 vitesh punë. Shpërblimi i vetëm, përveç përvojës dhe kualifikimit profesional brenda dhe jashtë vendit, duhej të ishte zbatimi i asaj pune për të cilën kishim punuar gjatë atyre viteve, konkretisht së fundmi,

zbatimi i skemës së re të riorganizimit të Sektorit Pyjor në Shqipëri.

Kjo punë, si dhe të gjitha investimet shumëmilionëshe për ringritjen e Sektorit Pyjor, do të kishin pasur vlerë nëse do të kishin shkuar në funksion të tij, por fatkeqësisht rezultati nuk përfundoi sipas parashikimit. Kjo ndodhi kur pas zgjedhjeve të vitit 2005 partitë *do të shkëmbenin portat* dhe pas tetë vitesh në pushtet të Partisë Socialiste, rivjen Partia Demokratike. Tani ishte bërë praktikë, që partitë me ardhjen në pushtet mund të ndryshonin gjithçka, pavarësisht arritjeve të institucioneve të mëparshme. Kjo ndodhi edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave, ku, pa marrë parasysh që ishte punuar 10 vjet dhe investuar për riorganizimin e institucioneve të pyjeve, ndryshimet u bënë sipas direktivave partiake dhe aspak sipas parimeve dhe vlerave të meritokracisë.

Konkretisht, Projekti që ishte finalizuar edhe me skemën e re të riorganizimit, parashikonte që, për të realizuar ndarjen e politikave dhe të kontrollit, nga menaxhimi teknik dhe financiar (një nga parimet bazë të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve), vetëm sektori i politikave dhe kontrollit duhej të kalonte në Ministrinë e Mjedisit, ku ky sektor do të ishte përgjegjës për politikat dhe kontrollin e administrimit të pyjeve. Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave duhej të kthehej në një Agjenci që do të funksiononte me vetëfinancim nga të ardhurat që do të nxirreshin nga administrimi i pyjeve në mbarë vendin. Situata për këtë ndryshim ishte përgatitur nga projekti që kishte investuar pjesën e logjistikës, të pajisjeve të duhura, si

edhe për kualifikimin e personelit që duhej të vazhdonte të punonte në DPPK. Krijimi i Agjencisë së Pyjeve kishte për qëllim krijimin e të ardhurave financiare që një pjesë do të shërbente për mbulimin e shpenzimeve të institucionit dhe pjesa tjetër do të kalonte në buxhetin e shtetit, që do të justifikonte edhe shlyerjen e kredisë nga shteti shqiptar në vite.

Fatkeqësisht nuk u mor parasysh skema e sapopërgatitur për zbatim nga projekti në bashkëpunim me ne, por u hartua një skemë e re, që futi të gjithë DPPK në Ministrinë e Mjedisit, edhe me politikat, edhe me kontrollin, edhe me menaxhimin, pa krijuar Agjencinë që ishte qëllimi kryesor për të cilin investoi projekti. Ishte një ristrukturim që nuk premtonte asgjë për të ardhmen e kësaj pasurie me shumë vlera dhe sigurisht pati edhe viktima, sepse u shoqërua me largimin e 25 punonjësve, përjashtimi i të cilëve ishte i pa motivuar dhe jashtë të gjitha rregullave administrative.

Një prej këtyre do të isha edhe unë, që deri në momentet e fundit isha koordinatorja për riorganizimin e DPPK, veçse jo sipas skemës që po zbatohej...për pasojë do të konsiderohesha e tepërt të vazhdoja në atë pozicion. Nuk ishte e lehtë vazhdimësia, nëse do të ishe e palëkundur në zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe parimeve. Përballjet me kundërshtinë e eprorëve dhe interesat e tyre sa vinin bëheshin më të shpeshta...parandieja që do të ishte e afërt dita e largimit nga ai pozicion pune, sikurse ndodhi në të vërtetë. Njoftimin e mora në telefon, në vazhdim të komunikimit me ministrinë për riorganizimin, nga e cila, deri në atë moment isha konsideruar që do të vazhdoja punën në atë ministri.

Ishte ditë e hënë, data 6 shkurt 2006, kur bie telefoni nga ministria. Do të njoftoheshin listat e personave që do të qëndronin dhe atyre që do të liroheshin nga puna, me rastin e riorganizimit.

- Shkruaj listën e parë, - më thotë zëri nga ministria. I pari ishte Drejtori i Përgjithshëm K. Malaj, e dyta isha unë. Kuptova që isha në listën e të pushuarve nga puna, sepse Drejtori i Përgjithshëm do të largohej detyrimisht si i vetmi post politik nga PS-ja në atë Drejtori. Vazhdova të shkruaja emrat e 25 personave, viktimave të ndryshimit me riardhjen e *Demokracisë* në pushtet...midis tyre, një pjesë ishin të punësuar së fundmi, ndërkohë që largoheshin punonjës të punësuar më herët në atë drejtori..

Ishte jo vetëm e papritur, por mbi të gjitha e paargumentuar, pa asnjë arsye, pas një periudhe 13-vjeçare në atë post, mbi të gjitha pas shumë trajnimeve dhe kualifikimeve brenda dhe jashtë vendit. Skema e re e riorganizimit, jo sipas skemës së hartuar nga projekti, përbënte dështim, kur, pa marrë parasysh investimet në vite, do të mohohej gjithçka ishte arritur. Për pasojë, Sektori Pyjor do të gjendej në udhëkryq përsa i përket menaxhimit, legjislacionit, pronësisë, gjendjes së degraduar dhe të lënë në mëshirë të fatit të kësaj pasurie me vlera të jashtëzakonshme, nëse do të ishte menaxhuar si duhej.

Në planin personal, ishte shqetësim, ishte indinjatë, ishte padrejtësi të gjendeshe pa punë pa asnjë arsye, ndërkohë që burimi i vetëm i jetesës ishte paga ime dhe e Nestit. I vetmi ngushëllim në atë situatë ishte shkëputja nga një punë që sapo kishte hyrë në një kolaps

pa krye, ku mendoja se do të ndihesha shumë keq edhe nëse do të vazhdoja në atë punë. Së fundmi, mendova se përvoja e fituar në vite do të më ndihmonte për ta gjetur veten në një punë që do të më përshtatej, ndoshta edhe më mirë, për arsyet që kishin filluar të më shqetësonin.

Shkoj në ministri për të marrë Vendimin e lirimit nga puna dhe njëkohësisht t'i njoftoja që të nesërmen duhej të nisesha për në Francë, në një Konferencë Ndërkombëtare, për të cilën isha përgatitur me kohë. Takimi do të zhvillohej në datën 8 shkurt, në Nicë të Francës dhe pjesëmarrja ime nuk mund të anulohej një ditë para nisjes, për më tepër që isha përzgjedhur si reportere e Konferencës dhe gjithçka financohej prej organizatorëve.

- Vazhdo, nuk të pengojmë të shkosh! - më thotë Sekretari i Përgjithshëm në atë kohë, kurse drejtori i Burimeve Njerëzore, më jep Vendimin e Lirimit.

- Faleminderit! - i them dhe marr letrën në dorë.

- Nuk është për falënderim, - përgjigjet ai si me keqardhje. - Është një nga paradokset e kohës, - vazhdoj unë, si për t'i ngushëlluar, për pamjen e keqardhjes që kishin marrë të dy për lajmin që po më jepnin...marr letrën dhe largohem me drejtimin për në shtëpi.

- Nuk e besova çupën që e kishin hequr nga puna, sepse m'u duk e gëzuar kur më tha që nuk do të shkonte më në këtë punë, - u thoshte mamaja të afërmve.

Kishte të drejtë mamaja, sepse mjaftoi reflektimi gjatë rrugës së kthimit për në shtëpi, që të ndihesha e bindur që kjo do të ishte një e keqe për një të mirë më të madhe. Nuk isha gabuar, sepse vërtet ashtu ndodhi. E sjell shpesh ndërmend shprehjen e famshme dhe tepër

ngushëlluese në momente të veçanta që "Kur Zoti mbyll një derë, ti akoma nuk ke parë derën që Zoti ka hapur për ty". Ishte rasti më i mirë që e vërtetonte këtë më së miri, sepse më ishte mbyllur dera e ministrisë, por një tjetër derë do të hapej së shpejti..

Në fjalën e radhës në Konferencë i njoftoj pjesëmarrësit, para prezantimit, që do të ishte hera e fundit që merrja pjesë në atë lloj takimi periodik, sepse do të largohesha nga ajo detyrë. Ky lajm bëri të mundur që të më ofrohej papritur një bashkëpunim në një projekt me vendet mesdhetare, ku do të merrja pjesë edhe unë nga Shqipëria, tashmë si eksperte e pavarur. E harrova çfarë kishte ndodhur dy ditë më parë dhe ndjeva jo vetëm kënaqësi për vlerësimin dhe respektin e treguar prej tyre, por ndjeva vazhdimësi pune dhe komunikimi me kolegë të së njëjtës fushë.

E rëndësishme ishte, gjithashtu, vazhdimësia e të ardhurave nga Instituti që investonte, sepse sapo kishim dërguar djalin në Francë për studime dhe të ardhurat financiare ishin të domosdoshme për familjen. Për herë të parë në historinë e udhëtimeve të mia zyrtare jashtë vendit, ndjeva një kënaqësi të veçantë të shijoja ndryshe pjesën jashtë veprimtarisë zyrtare. Fliste më tepër ndërgjegjja, liria e fituar dhe e dëshiruar së tepërmi kohët e fundit, që mbizotëronte mbi çdo gjë. Kësaj i bashkohej pamja mahnitëse e detit që dukej nga dhoma e hotelit, fare pranë detit në *Nicë*; dilja në ballkonin e dhomës me pamje soditëse të rralla të perëndimit të diellit rrëzëllues, ndjesi për lindjen e një dite të bukur, më pas afrimin e Pranverës, por edhe një fillim të ri në karrierën time..

Pas kthimit në Tiranë dhe dorëzimit në qetësi të materialeve të zyrës, u mora me ankimimin e çështjes së pushimit të paligjshëm nga puna, pranë Komisionit të Administratës Publike. Komisioni e quajti të padrejtë vendimin e largimit tim nga puna dhe njëkohësisht më dha të drejtën e shpërblimit, sipas Ligjit të Administratës Publike, për një vit.

- Ke të drejtën e kthimit në detyrë, pse nuk kërkon të rikthehesh? - më pyet kryetari R. Përmeti, një burrë, qëndrimi i të cilit shprehte drejtësi, seriozitet dhe vendosmëri në vendimet që merrte (ndoshta nga të fundit e llojit të vet në ato pozicione të rëndësishme për Administratën Publike).

- Sepse nuk mund të shpresoj të bashkëpunoj me këta persona që vendosën pushimin tim nga puna, - përgjigjem unë duke u drejtuar nga përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit aty, sekretari i Përgjithshëm dhe përgjegjësi i Burimeve Njerëzore për kohën.

- Sipas Ligjit të Administratës Publike, për kërkesën që paraqet, ke të drejtë të shpërblehesh gjatë një viti me pagën aktuale të pozicionit që keni pasur si drejtore Drejtorie, - më sqaron kryetari i Komisionit.

- Nëse do të paguhet kjo, do të paguhen edhe 24 të tjerë që janë pushuar si kjo dhe do të jetë kosto e madhe për shtetin, - ndërhyn ish sekretari i Përgjithshëm, *shumë i merakosur* për koston e shtetit.

- Ne marrim vendim për personin që bën ankesën dhe jo për të tjerët, - përgjigjet i vendosur kryetari.

Në fakt, pas këtij vendimi, përfituan edhe të tjerët, pavarësisht që nuk kishin bërë ankesë, kurse mua përgjigjja që dhashë më kushtoi humbjen e financimit

përgjatë viteve që nuk u punësova. Dinjiteti ka kosto, megjithatë u ndjeva e qetë me shpërblimin monetar, për një vit, me shpresën që do të vazhdoja veprimtarinë kudo që të mundesha. Pavarësisht kësaj, isha e zhgënjyer për 13 vjet punë, për aq shumë vështirësi dhe përpjekje për të arritur rezultatin e duhur në ristrukturimin e Sektorit Pyjor, që fatkeqësisht mbeti i parealizuar.

Ku ishim? Asgjëkundi! Çfarë bëmë? Asgjë! Ishte kjo retorika që nuk mund të më ndahej pas këtyre zhvillimeve, që detyrimisht do të shoqëroheshin me zhgënjim dhe keqardhje, për arsye që po bëheshin gjithmonë e më të njohura.

Lufta kundër korrupsionit që ishte një nga objektivat e rëndësishme të projektit, (ndërkohë korrupsioni ndihej edhe në sektorë të tjerë të ekonomisë), ishte pjesë e pashmangshme, sepse korrupsioni përbënte pengesë në arritjen e objektivave dhe të qëllimit të Projektit fillestar, por edhe të dy projekteve të tjera që do të pasonin, duke u konsideruar si vazhdim i të parit.

Lidhur me ekspertët e BB, për mua ishte e paqartë nëse nuk e kuptonin realitetin, apo e konsideronin që i takonte pjesës shqiptare dhe nuk mund të ndërhynin. Nuk arrita ta kuptoja këtë gjë, as mbas një diskutimi rreth Projektit Shqiptar të Pyjeve, që patëm në Forumin e OKB, për Pyjet, *në New Jork* në v.2017 me njerin nga ekspertët kryesorë që kishte bashkëpunuar me ne gjatë projektit. "Kemi qenë të suksesshëm në *Albania*", foli ai nga podiumi që drejtonte Forumin e OKB për Pyjet, duke u drejtuar nga unë. Se çfarë ndjeva në çast, e tregon një foto e imja e marrë në çast, nga operatori që ndiqte punimet dhe do ta shihja kur mbaroi

seanca.. Ishte udhëtimi i fundit në kuadrin e misioneve zyrtare dhe më erdhi keq që ngela më e paqartë se kurrë lidhur me konkluzionet e të huajve për arritjet e projekteve në Sektorin Pyjor Shqiptar..por kuptova që në përgjithësi, përfaqësuesit e institucioneve të huaja, janë të përgjegjshëm për detyrat e ngarkuara në interes të institucioneve dhe shteteve që përfaqësojnë, gjë që shpesh ndryshon në realitetin shqiptar, përballë atij të huaj. Realiteti i sotëm dëshmon më së miri këtë fakt, kur mbas shumë investimesh në formë kredish, apo ndihmash, mirëqenia e shqiptarëve le mjaft për të dëshiruar. Janë shqiptarët që e meritojnë këtë realitet, apo janë faktorë të tjerë që po ndikojnë në këtë realitet të dhimbshëm, i mbetet kohës të japë përgjigjen e duhur. Kam bindje për një gjë, që shpresa për ndryshim në këtë vend do të lindë vetëm atëhere kur të lindë shpresa për arritje në luftën kundër korrupsionit, që do të thotë shpresë për Drejtësinë e munguar.

POLITIKA

Në vazhdimësi të ngjarjeve, përfundimisht u ndjeva e kënaqur që nuk do të isha pjesë e atij stafi në Ministrinë e Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, që sapo ishte krijuar, por jo e qetë për sa po shihja drejtimin e zhvillimeve në Sektorin Pyjor që kishte filluar të tatëpjetën.

E revoltuar për ç'ka po ndodhte, provova të dërgoja artikuj në disa nga gazetat e kohës, por ishte shpresë e humbur të botoheshin. Politika vendoste për gjithçka dhe mbi gjithçka.

Rastësisht takoj ish-drejtoren e Administratës Publike, F. Kodra, me të cilën njiheshim prej kohësh dhe kishim bashkëpunuar në fushën e Projektit të Pyjeve, për pjesën që lidhej me Administratën Publike. Si pjesë e grupit drejtues të Partisë së opozitës së porsakrijuar, LSI(Lëvizja Socialiste për Integrim), me një reputacion pozitiv në luftë kundër korrupsionit të PS në atë kohë, Filloreta ishte e interesuar për ecurinë në Sektorin e Pyjeve. Më pyet dhe e sqaroj mbi problemet dhe shqetësimet për situatën, që me atë mënyrë organizimi rrezikohej e ardhmja e pyjeve në vend...më pas më sugjeroi të shkruaj artikull, rreth gjendjes në Sektorin Pyjor, për të cilin më ndihmoi të botohej në gazetën e partisë së saj. Fillimisht Artikulli pati efekt në opinionin e interesuar në çështjen mjedisore dhe të pyjeve dhe kishte kaluar pak kohë pas kësaj, kur F. Kodra më sugjeron të dilja në emisionin *Top Show*, ku do të ishte

i pranishëm Ministri i Mjedisit i kohës, L. XH, për të folur rreth situatës së Pyjeve në Shqipëri. Njoftimi ishte shumë pak para fillimit të emisionit dhe nuk më dha mundësinë as të dija detaje mbi çka do të diskutohej, por mjaftonte tema mbi situatën e pyjeve në vend, për të mos hezituar të merrja pjesë në emision.

Ishte kontribut i duhur për momentin, edhe si një mundësi për t'i bërë të ditur ministrit në fjalë, që rruga në të cilën kish hyrë Sektori Pyjor në Shqipëri nuk ishte e duhura. Ishte kjo arsyeja që, edhe pse ishte hera e parë që dilja në një emision televiziv, të mos hezitoja të flisja hapur mbi dështimin e Reformës në Sektorin Pyjor, përgjegjësi që rëndonte sigurisht mbi ministrin e kohës.

Kishim komunikuar me ministrin për çështje pune, me përshtypjen e një respekti reciprok, por këtë herë ndryshonte puna. Isha aty për të thënë të vërtetën që ishte paksa e hidhur për ministrin, që njihej për person autoritar (nuk i pëlqente kritikat), por ky fakt nuk më pengoi gjatë diskutimit në studio. Pasi shpjegova teknikisht se çfarë kishte ndodhur me pyjet, me projektin dhe vazhdimësinë, akuza e drejtpërdrejtë mbi ministrin ishte që drejtimi që po merrte riorganizimi i Sektorit Pyjor në kushtet aktuale ishte humbje e pajustifikuar e miliona dollarëve kredi, që do të paguheshin në vite nga taksapaguesit shqiptarë. Për çudi, me gjithë pakënaqësinë që shprehu ministri, nuk pati atë reagim të pritshëm që kishte pasur në raste të tjera debatesh, nëse do të kish ndonjë reagim të kundërt. Ndërkohë, mbizotëroi heshtje në sallë, ku ishin të pranishëm stafi që kishim punuar për shumë vite së bashku, por aty ishin

tashmë si mbështetës të shefit të tyre. Gjatë diskutimit nuk pati asnjë reagim kundrejt diskutimit tim, por as edhe ndonjë mendim mbështetës ndaj diskutimit të ministrit, që po përpiqej të argumentonte të kundërtën. Kjo donte të thoshte që argumentet për të vërtetën ishin bindëse dhe e vërteta, megjithëse e hidhur, po dilte në pah në mënyrën e duhur dhe me efektin e duhur.

E rëndësishme ishte të ndikonte në ecurinë në vazhdimësi për të reflektuar mbi rrugën e gabuar ku kishin hyrë dhe atë që duhej ndjekur realisht. Por është e pamundur të ndodhë kjo, kur e vërteta është e vështirë të pranohet prej atyre që bëjnë politikat dhe kanë në dorë vendimmarrjen. Të njëjtën gjë treguan investimet në vazhdimësi të dy projekteve të tjera të Bankës Botërore, sepse nuk pati reflektim ndryshe dhe nuk bënë më tepër se i pari. Nëse qëllimi në "parim" i projekteve do të ishte realizuar, kreditë do të kishin pasur vlerë për mirëqenien e shoqërisë shqiptare. Investimet e duhura mbi burimet natyrore të ripërtëritshme asnjëherë nuk e humbin vlerën, kur këto investime bazohen mbi parimet e zhvillimit të qëndrueshëm; për pasojë, ato jo vetëm justifikojnë shpenzimet, por rritin edhe të ardhurat.

Në vend të kësaj pritshmërie, Sektori Pyjor tani dhe në vazhdim do të ishte në gjendjen e tij më të keqe të mundshme, i paorganizuar, me pyje të degraduar, me një reduktim të pamasë dhe të pallogaritur të sipërfaqes me pyje të mbetur vetëm në majat e pa arritshme malore, ose siç quhen ndryshe *pyje të virgjër*...fatmirësisht, në sajë të mungesës së rrugëve, këto pyje, kanë shpëtuar dhe kanë ngelur si të vetmet pyje me vlera në këtë vend. Ishte një arsye më shumë kjo, që gjatë diskutimeve

midis palës shqiptare dhe BB, personalisht përkrahja idenë që të mos investohej për rrugë pyjore, që do të ndikonin në shtimin e dëmeve, për shkak të mundësive që u jepej keqbërësve për abuzime në pyje...ishte në fakt ide që nuk mund të përkrahej nga të gjithë, sikurse ndodh rëndom kur ka prekje interesash.

Shpresa vdes e fundit, thuhet dhe kjo të motivon për të vazhduar të kontribuosh në atë që ka mbetur e parealizuar dhe dëshiron të bëhet diçka, sado e vështirë të duket. Vazhdimi i punës si konsulente private, e mbështetur nga të huajt e interesuar për të bashkëpunuar me Shqipërinë, më nxiti të besoja që me këmbëngulje mund të bëhej diçka.

Ajo që do të shtonte sigurinë në këtë situatë ishte Partia Opozitare, në atë kohë LSI, drejtuesit e së cilës më ofruan mbështetje, veçanërisht pas emisionit të *Top Show*, që e konsideruan me efekt pozitiv në opinion dhe u krijoi besueshmëri. Pasi më përshëndetën për kontributin tim për pyjet, shprehën interesim dhe gatishmëri për të më mbështetur në çfarë unë do të propozoja për ecurinë e Sektorit Pyjor në kushtet e opozitës.

Përfshirja në politikë, aq më tepër aderimi në ndonjë parti politike, nuk përkonte as me traditën familjare, as me natyrën time. Ishte pozicionimi i LSI-së në atë kohë jo vetëm kundër korrupsionit, por edhe interesimi në ruajtjen e burimeve natyrore të vendit, si edhe mbështetja që më ofruan në fushën e mirëmenaxhimit të pyjeve, që ndikuan të mos hezitoja ndaj propozimit për të kontribuar pranë asaj partie, lidhur me Programin mbi të Ardhmen e Pyjeve në Shqipëri. Ishte një kontribut

profesional dhe ashtu ngeli deri në fund, me gjithë dëshirën për të kontribuar me të gjitha mundësitë në atë parti të re, të posaformuar, që në atë kohë, ngjallte shpresa për ndryshim.

- Mirë bën që merresh me programe dhe me artikuj në gazetë, po pse nuk përfshihesh më tepër politikisht? I ke mundësitë për më tepër! - do të më thoshte një miku im, i integruar prej kohësh në politikë.

- Më pengon raporti me të Vërtetën, që nuk më ndihmon të merrem me politikë, - i përgjigjem duke qeshur. –

- Vërtet, se ç'ke një gjë ndryshe ti kur flet, por mundohu të ndryshosh, se edhe kohët po ndryshojnë.., - më thotë ai duke nënqeshur dhe, me sa kuptova, donte të thoshte: - *Ke mbetur pak prapa kohës.*

Nëse të thuash të Vërtetën quhet "*old fashion*", si e kanë dëshirë ta përdorin *të rinjtë e sotëm* këtë term, për më të vjetrit në moshë, (kur nuk u shkon për shtat), për mua do të ishte kompliment dhe jo ofendim. U përpoqa të bëja më të mirën sa të mundja me mënyrën time dhe me vullnet të plotë për atë që shpresoja të ndryshonte, veçanërisht në Sektorin Pyjor. U mbështeta nga LSI-ja deri në zgjedhjet parlamentare të radhës, me shpresën e ndryshimit, nëse ajo parti do të vinte në pushtet. Me shumë dëshirë filloi një bashkëpunim me persona të tjerë të përkushtuar në fushën mjedisore të përfshirë në atë kohë në atë parti, gjë që u reflektua në seminare, takime, emisione në TV dhe artikuj të vazhdueshëm në gazetë.

E rëndësishme ishte mbështetja lidhur me propozimin tim për ndërmarrjen e një Moratoriumi

në Pyje, (ndalimin e shfrytëzimit të pyjeve me qëllim fitimi) i konsideruar i nevojshëm për kushtet në të cilat ndodheshin pyjet.

Efekti ishte i ndjeshëm në rritjen e ndërgjegjësimit të opinionit lidhur me mbrojtjen e Pyjeve dhe të Mjedisit në përgjithësi. Situatën e favorizoi edhe fakti i rritjes së një lloj ndërgjegjësimi në fushën mjedisore, që po ndihej në botën perëndimore lidhur me *Ndryshimet Klimatike* dhe që filloi të ndihej edhe tek ne.

Bashkëpunimi me Shoqërinë Civile, ishte një tjetër veprimtari që do të plotësonte aktivitetin në funksion të rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor. Veçanërisht veprimtaritë me të rinjtë e shkollave ishin një tjetër kënaqësi që do të plotësonte atë kënaqësi të munguar, që të rinjtë e jepnin pa kufij, me gatishmërinë për t'u përfshirë në veprimtari mjedisore.

Puna me shoqatat ishte një risi, ku veç të tjerash shijoje pavarësinë në administrimin e punës dhe kohës së lirë, bashkëpunimin me njerëz që i zgjidhje kur mendoje se ia vlente bashkëpunimi. Por kjo nuk ndodhte gjithmonë, sepse mjaftonte nevoja për një firmë miratimi nga *zyrat e shtetit* dhe duhej ta mendoje mirë se me çfarë mund të përballeshe.

Në bashkëpunim me Shoqatën EDEN po punonim me një projekt mbi menaxhimin e mbetjeve, që kishte për qëllim ndërgjegjësimin e të rinjve të shkollave për trajtimin e mbetjeve, në funksion të mbrojtjes së mjedisit. Duhej miratimi i Zyrës Arsimore të Tiranës, prandaj patëm takim me shefen e Zyrës Arsimore, A.; por shefja pa asnjë arsye nuk donte ta jepte miratimin për zbatimin e projektit në shkollat shtetërore.

Ishte fillimi i bashkëpunimit me Shoqërinë Civile dhe nuk mund ta kuptoja këtë sjellje absurde të një nëpunëseje shteti, të porsaemëruar, në kuadrin e ndryshimeve nga partia e saj. (PD-ja sapo kishte ardhur në pushtet me premtimin e *luftës kundër korrupsionit*). *Vështirësinë e bashkëpunimit* me këta lloj nëpunësish, do të ma sqaronte ing. F. Liçaj, (bashkëpunëtor, që kishte më tepër përvojë në veprimtaritë me Shoqërinë Civile) dhe me kaq vendosëm ndërprerjen e bashkëpunimit me atë zyrë. Rrugëzgjidhjen e gjetëm në bashkëpunim me tri shkolla private, të cilat i pritën me kënaqësi edhe veprimtaritë ndërgjegjësuese, por edhe të mirat materiale që përfituan. Ishte kënaqësi e veçantë bashkëpunimi me të rinjtë e atyre shkollave, por do të ishte më mirë që përfitimet materiale t'i kishin pasur shkollat shtetërore, po të mos i kishte refuzuar shefja e tyre.

- *Nuk mund t'i bihet murit me kokë*, - më thotë Elga, (duke diskutuar shqetësimin në fjalë) një bashkëpunëtore mbështetëse, tepër korrekte, miqësia dhe bashkëpunimi me të cilën do të kishte vazhdimësi.

Alma gjithashtu, me natyrën e saj humane, ishte një bashkëpunëtore mbështetëse dhe e kudogjendur gjatë veprimtarive shoqërore.

Do t'i mbetesha mirënjohëse Ferdinit, kujtim i paharruar, si një qytetar i përkushtuar me kontributin e tij dinjitoz, të pakursyer në veprimtaritë mjedisore. Ikja e tij ishte një humbje dhe mungesë jo vetëm si bashkëpunëtor, por edhe si një vlerë kontributesh që sot ndihen të munguara në Shoqërinë Civile. Këto dhe episode të tjera të kësaj natyre më vijnë sot ndër mend,

kur shpesh tundohem për ndonjë kontribut në fushën e Mjedisit, apo kur më pyet shpesh im bir: - Pse nuk aktivizohesh me ndonjë shoqatë? E mirëkuptoj pse e ka të vështirë të kuptojë pengesat e mia në këtë fushë sado për zemër ta kem përfshirjen në ndonjë aktivitet mjedisor apo social, sepse pensionin asnjëherë nuk e kam konsideruar ndërprerje të aktivitetit tim...sa për Tedin, shpresoj të vazhdojë të ndihet mirë me përfshirjen dhe besimin që ka veç të tjerash, te Shoqëria Civile në Francë, ku po ndihet i mirintegruar.

DURI

Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2009 do të sillnin në pushtet koalicionin fitues PD/LSI, që premtonte ndryshime, veç të tjerash, në fushën e Mjedisit dhe të Pyjeve, sipas Programit të LSI-së për Pyjet.

Filloi riorganizimi i institucioneve dhe njëkohësisht u ringjallën shpresat për ripunësim në ministrinë e titulluar Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave. Kaluan muaj dhe po kuptohej që nuk ishte e lehtë, sepse me ndarjen e ministrive sipas partive të koalicionit, Ministrinë e Mjedisit e kishte marrë pjesa tjetër e opozitës në koalicion. Sipas praktikës së njohur tashmë, kjo pjesë e opozitës do të *punësonte njerëzit e vet* dhe si e tillë nuk kishte as shpresa për zbatimin e reformës së duhur, që do të mbështetej nga LSI-ja, nëse nuk do ta kishte në përgjegjësi atë ministri.

Historia po përsëritej në të njëjtën mënyrë dhe shumë shpejt u kuptua që edhe opozita që kishte ardhur në pushtet me shumë premtime nuk po bënte gjë tjetër veçse po imitonte ish-pozitën në planin e interesave personale... për pasojë, emërimet bazuar në vlerat e meritokracisë po kalonin në plan të dytë.

Zhgënjim pas zhgënjimesh dhe pas një viti premtimesh dhe pritjesh për ripunësim në institucionet e shtetit, punësohem në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, përgjegjëse në Sektorin e Imigracionit. Rikthimi në institucionet e shtetit kishte përparësi, ndërkohë që fusha e veprimtarisë me shoqatat, me të cilat po

bashkëpunoja deri në atë kohë, po ngushtohej gjithmonë e më tepër dhe perspektiva dukej e zymtë. Me kalimin e kohës po ndiheshin shfaqje të humbjes së besimit te një shoqëri civile që mund të përfaqësonte denjësisht interesat e shoqërisë. Në këto kushte do të ndihesha më mirë e punësuar në institucion shtetëror dhe vërtet puna në MPÇS vazhdoi normalisht për tre vjet dhe pak muaj, përveç fillimit të punës, që ishte paksa stresant për një ndodhi që më ka lënë mbresa të paharrueshme. Në postin ku isha emëruar do të zëvendësoja Elonën, një vajzë e re, në moshë dhe profesion, e cila kishte zëvendësuar para pak kohësh Durim Hatibin, dikur drejtor në atë drejtori, më pas përgjegjës dhe së fundi specialist i thjeshtë. Me Durin, (siç e quanin shkurt), një burrë i imët, fisnik në pamje, por me një shprehje të zbehtë dhe paksa të lodhur në dukje, kur u takuam, munda të bisedoja vetëm një herë për rreth një orë në Kafen e Ministrisë. Ai nuk u kthye më aty, sepse ndërroi jetë pas dy muajsh.

Ikja e tij ishte një tragjedi, të cilën e përjetova shumë keq për rrethanat që u krijuan, që më ballafaquan me historinë dhe ikjen e tij të parakohshme.

Kur fillova punë, më bënë të ditur që Duri ishte një person shumë i përgatitur, me përvojë të gjatë pune në atë ministri, që kishte mbajtur një peshë të konsiderueshme të punës së sektorit dhe të asaj ministrie deri në atë kohë. Si e re në atë punë, e quajta pozitive të bashkëpunoja me një person me përvojë dhe të respektuar, që tani ishte emëruar specialist në atë sektor. Ishte paksa e çuditshme kjo, sepse normale do të ishte ngjitja dhe jo zbritja e shkallëve në karrierë pas

shumë vitesh pune, ku paraprakisht kishte qenë drejtor në atë drejtori. Këtë mendim ia shpreh edhe Silvës, drejtores, që na mbulonte si sektor, e cila më përgjigjet :

- Duri mund të mos kthehet më në punë, sepse është i sëmurë..

Në fakt, ai e pohoi edhe vetë që nuk ndihej mirë, gjatë bisedës kur folëm në Kafen e ministrisë; nuk e kuptonte çfarë kishte, sepse mjekët nuk i kishin dhënë diagnozë, por më la të kuptoja që mbi të gjitha ishte i stresuar. Dikush, në besim më thotë se ai kishte filluar të mos ndihej mirë që kur u ndërrua nga pozicioni i punës, pasi e kishin njoftuar, njëkohësisht, se përbënte problem dosja e tij, për shkak të mungesës së dokumentit të diplomës. Ministri i kohës, i sapoemëruar, një ditë kishte hyrë në zyrë dhe në prani të kolegëve i ishte drejtuar:

- Ju jeni ai që nuk keni diplomë?

Duri për pak kohë do të dilte në pension dhe në mënyrën më të pakuptimtë, i kërkohej diploma pas rreth 15 vjet punë në atë institucion!!! Ishte i njohur nga të gjithë për përvojën, gjuhët e huaja; zotëronte më së miri shtatë gjuhë të huaja, veçanërisht gjuhën angleze, (kishte zënë vendin e parë në konkursin me pjesëmarrje të gjerë për zotërimin e gjuhës angleze) falë së cilës, sipas opinionit të kolegëve, kishte dhënë kontribut të veçantë veç të tjerash, në përgatitjen e dokumentacionit të Asocimit në BE. Kishte qenë i kudogjendur Duri në përgatitjen e materialeve të veçanta në atë ministri, gjë të cilën, përveç opinionit që gëzonte, e kuptova sepse m'u desh të punoja me kompjuterin e tij, kur ai nuk u kthye më. Materialet e përgatitura prej tij ishin dëshmi e një pune të jashtëzakonshme (dihej nga të gjithë kjo),

e një përkushtimi pa kufi, e një niveli profesional dhe gjuhësor që nuk e kisha hasur kurrë më parë; e një niveli kulturor, që kishin qenë një vlerë për institucionin ku kishte punuar.

Duri kish lënë gjurmë të pashlyeshme të punës së tij shumëvjeçare në atë ministri, materiale me vlerë jo vetëm të sektorit që mbulonte, por edhe jashtë tij. Ai kish përgatitur materiale dhe fjalime për ministrat brenda dhe jashtë ministrisë dhe personalitete të tjera, në shqip dhe në anglisht...por më mbresëlënësja për mua ishte mënyra e të shkruarit dhe përkthimit, me shumë profesionalizëm dhe përkushtim.

Me të drejtë ish-kolegët e tij e kujtonin me mallëngjim si një person jo vetëm të përgatitur profesionalisht, por edhe të kudogjendur, si një vlerë që do t'i mungonte atij institucioni. Dhe Durit, në vend që t'i vlerësohej puna, pas uljes në përgjegjësi nga përgjegjës në specialist, duhej t'i vihej në dukje edhe që i mungonte dokumenti i diplomës në dosje. Ishte vërtet një ngjarje e çuditshme për ta kuptuar ç'po ndodhte, për më tepër duke u njohur me punën nëpërmjet materialeve të shumta me të cilat hasesha çdo ditë. Mbresëlënëse ishte edhe muzika e përzgjedhur, që kishte regjistruar në atë kompjuter, që e dëgjonim në kohë pushimi së bashku me kolegët e tjerë të zyrës.

Dy ditë pasi Duri ndërroi jetë, gjej në zyrë, mbi tryezën time të punës, një zarf me një shkresë (e përgatitur para pak kohësh, mesa dukej), ku i kërkohej Durit të dorëzonte sa më parë diplomën dhe nëse jo, do të largohej nga puna. Duri u largua nga puna duke u larguar edhe nga jeta, së bashku me shqetësimin

e largimit nga puna që ai e kishte dashur aq shumë. (Gjatë varrimit, nuk pati nderim zyrtar të merituar nga institucioni). Kjo shkaktonte keqardhje, shqetësim, por edhe shihej si një ngjarje e çuditshme..

Fillova të interesohem për më tepër dhe shumë shpejt mësova mbi historinë e jetës së tij. Kishte qenë familjarisht i persekutuar i regjimit të diktaturës, për arsye të dënimit të babait dhe më pas të nënës së tij me burg për shkaqe politike. Ky ishte shkaku që nuk i ishte dhënë e drejta e studimit, të cilën e kishte përfituar pas ndryshimit të sistemit. Përsa dëgjova nga ish-kolegët e tij, kishte mbaruar shkollën e lartë pa shkëputje nga puna dhe duke qenë se kishte filluar punë, e kishte neglizhuar marrjen e diplomës për arsye ngarkese në punë. Ishte një vendim i hershëm i kohës së partisë, që tani ishte rikthyer në pushtet, që u jepte në atë kohë mundësi punësimi edhe pa diplomë, ish-të persekutuarve, kur kishin një lloj kualifikimi. Ndoshta kjo mund të kishte qenë një arsye pse Duri e kishte lënë pas dore marrjen e dokumentit. Çuditërisht, ky dokument i kërkohej tani, në prag të daljes në pension, kur në pushtet ishte po ajo parti, partia e votuar në masë nga ish-të persekutuarit, pjesë e të cilëve ishte edhe Duri dhe që me punën e tij e kishte justifikuar plotësisht.

Kisha keqardhje, por edhe indinjatë, të cilën ia shpreha shefit të Kabinetit të Ministrit. Ky më dëgjoi në heshtje, paksa i habitur, pse unë isha e shqetësuar për atë çështje dhe besova që nuk arriti të kuptonte që përveçse për Durin isha e shqetësuar për *fenomenin*... e dija që nuk do të zgjidhte asgjë ai takim, sepse gjithçka kishte mbaruar dhe intrigat ishin të pashmangshme në institucione.

Duri mbeti një kujtim i veçantë shumë i respektuar i një historie të dhimbshme, tepër domethënëse, si i persekutuar i të gjitha kohërave...materialet e tij mbetën, gjithashtu një ndihmesë në atë ministri dhe udhërrëfyes në punën time, si vazhduese e punës së tij të mëparshme. Kështu nuk më mungoi mbështetja që prisja fillimisht nga Duri deri në ikjen nga ajo ministri pas tre vjet e pak muaj punë.

Ikja erdhi natyrshëm, kur me zgjedhjet e reja elektorale, që sollën në pushtet PS-në në koalicion me LSI-në, atë ministri e merr PS-ja me ministër E. V. Historia vazhdon përsëritet, lidhur me emërimin e njerëzve të partisë në pushtet. Me skemën e re, me propozimin e ministrit, do të eliminoheshin përgjegjësit e sektorëve në atë ministri dhe për rrjedhojë, unë humbja vendin e punës. Ishte koha kur e ndieja veten të sigurt me përvojën e fituar në atë pozicion pune, që u kurorëzua me hartimin e Ligjit të Ri për të Huajt, për të cilin punova personalisht, së bashku me vendimet përkatëse në zbatim të tij. Por kjo nuk përbënte problem për drejtuesit e rinj në atë ministri, sepse asnjë nuk mbetet i pazëvendësueshëm. Për arsye që vendi im i punës suprimohej, si kontribuese pranë LSI-së për çështjen e mjedisit dhe pyjeve, shumë shpejt njoftohem nga kreu i LSI-së, i njohur për mirënjohjen e tij ndaj kontribuesve, se do të filloja punë në Ministrinë e Mjedisit. Ishte ministria, përgjegjësia e së cilës i kalonte LSI-së në kuadrin e koalicionit në pushtet.

Ishte lajm i gëzueshëm sepse ripunësimi do të përkonte me profesionin dhe përvojën time të punës si pjesë e kabinetit të ri ministror në Ministrinë e Mjedisit.

U ndjeva e kënaqur për rifillimin e punës në profesionin tim, aty ku ishte dëshira e vërtetë, si shkalla e fundit e karrierës sime para daljes në pension, gjë që ia u shpreha edhe të rinjve simpatikë të zyrës para se të largohesha.

- Çfarë do të bësh kur të dalësh në pension? - më pyet Elona gjatë përshëndetjes së ndarjes me shumë emocione. – Kam dëshirë të mësoj të luaj në piano dhe do të shkruaj kujtimet, - i përgjigjem Elonës në prani edhe të kolegëve të tjerë të zyrës dhe instinktivisht pata parasysh kujtimin mbresëlënës të Durit në atë ministri.

Ndjeva keqardhje për ndarjen nga kolegët e zyrës, më të rinj në moshë, (Eva, Elona, Albana, Albani), së bashku me drejtoren, Silvën, për bashkëpunimin e frytshëm dhe mbresëlënës, mbresa që i risjellim kur takohemi, si një kujtim i bukur i paharruar i asaj kohe.

Më duhej të përgatitesha për një fillim të ri..

RIKTHIMI

Fillimisht mora takim me ministrin L. K. E dija që profesioni i tij nuk lidhej me mjedisin, por kjo kishte qenë dhe vazhdon të jetë e zakonshme për politikën shqiptare. Gëzonte opinion pozitiv si drejtues në menaxhimin e situatave dhe në marrëdhënie me personelin ku kishte punuar, gjë që e tregoi ndaj meje që në takimin e parë; u tregua i hapur për postin e punës që unë do të dëshiroja.

Pa u menduar shumë, bëra zgjedhjen për të qenë këshilltare e ministrit, në fushën mjedisore, veçanërisht të Pyjeve, që vazhdonte të menaxhonte ajo ministri. Isha plotësisht e ndërgjegjshme për atë zgjedhje, pavarësisht pozicioneve të tjera që m'u ofruan. Pas shumë vitesh përvojë pune, e qartë se çfarë duhej të bëhej me Sektorin e Pyjeve, që pas 7 vjetësh kishte degraduar në drejtim të gabuar, m'u duk një fillim i mbarë të gjendesha pranë ministrit që do të kishte pushtetin dhe mundësitë për të ndërmarrë reformën e duhur.

Debatet nuk do të mungonin, lidhur me Ligjin e Ri të Pyjeve, Projektin e ri të Pyjeve, të Bankës Botërore, por edhe me Ligjin e Zonave të Mbrojtura. Nuk mund të isha dakord që ndryshimet e kohëve të fundit në ligjet ekzistuese të krijonin hapësira për dëme dhe abuzime, gjë që e vërteton situata në të cilën ndodhen sot Zonat e Mbrojtura dhe Pyjet në përgjithësi...për sa i përket ristrukturimit, pas shumë diskutimesh u arrit vendimi për hartimin e një skeme reformimi që duhej bërë vite më parë. Ndërsa në atë kohë gjendja e Sektorit Pyjor u

përmirësua, veçanërisht në logjistikë, falë investimeve nga BB për zbatimin e reformës, tani ndodheshim në një situatë shumë më të vështirë prej rrugës së gabuar të ndjekur deri tani.

Në këto kushte, u vlerësua i domosdoshëm propozimi im për shpalljen e një Moratoriumi 10-vjeçar, për ndalimin e shfrytëzimit me qëllim fitimi dhe të eksportit të lëndës drusore...ndërkohë kishin filluar procedurat për ndërmarrjen e Moratoriumit për ndalimin e Gjuetisë.

Kisha bindjen që, në gjendjen në të cilën ndodheshin pyjet shqiptare, ishte e domosdoshme një pauzë biologjike në tërësi e pyjeve dhe bimësisë pyjore, së bashku me botën e gjallë të kafshëve dhe të shpendëve si pjesë e rëndësishme e atij habitati. Në këto kushte, Moratoriumi u quajt si hap i parë për reformimin e Sektorit Pyjor, ndërkohë që do të vazhdohej me procesin e zbatimit të reformës që kishte ngelur në letër deri në atë moment.

Lidhur me çështjen shumë të përfolur së fundmi të inceneratorëve, (djegësve të mbetjeve), si një nga aferat më në zë të korrupsionit që çoi para drejtësisë ministrin dhe disa punonjës të asaj ministrie, kujtoj vetëm dy momente: Momenti i parë, kur këshilltari, përgjegjës për median dhe marrëdhëniet me publikun, hyn në zyrë gjithë entuziazëm dhe na tregon për vendimin që ishte marrë mbi ngritjen e një inceneratori në Elbasan. Ndërsa ai po tregohej shumë entuziast për këtë vendim, që atij mund t'i dukej si lajm surprizë për mediat, (kjo ishte detyra e tij), pasi e dëgjova deri në fund i them:

- Djegia është metoda e fundit që përdoret për mirëmenaxhimin e mbetjeve.

- Edhe këtë na e kundërshtove? - përgjigjet i pakënaqur për vërejtjen time.

E dija që quhesha si opozitare brenda kabinetit, për arsye të oponencës që nuk hezitoja të bëja shpesh, kur kërkohej mendimi im, por nuk mund të veproja ndryshe, kur e mendoja të nevojshme.

- Duhet të keni parasysh që mund të keni probleme edhe me BE-në kur të diskutohet çështja në fjalë, sepse bie në kundërshtim me politikat e BE-së për mirëmenaxhimin e mbetjeve, - vazhdoj të sqaroj kolegun.

- Po pse ata vetë ndërtojnë inceneratorë? - pyet ai për t'u sqaruar më mirë.

- Sipas politikave të BE-së, (dhe jo vetëm), incenerimi (djegia) i mbetjeve nuk është metoda e duhur dhe e këshilluar për mirëmenaxhimin e tyre, - vazhdoj unë. Zakonisht këto ndërtohen në vendet e zhvilluara, atje ku ka besueshmëri në kontroll dhe zbatohet pas procesit të ndarjes dhe riciklimit. Djegia e mbetjeve konsiderohet si metoda e fundit pas të tjerave, që janë paraprakisht ndarja në burim, reduktimi, ripërdorimi, riciklimi dhe ndodh atëherë kur për shumë arsye nuk mund të realizohen të parat. Kjo është çështja më kryesore në funksion të së ardhmes së menaxhimit të mbetjeve në vendin tonë.

Nuk vazhdova më tej, sepse e dija që nuk do të kishte ndonjë ndikim ajo bisedë, për më tepër që ishte jashtë fushës sime të këshillimit. Isha e bindur gjithashtu, që nuk do të pyetesha për atë që tashmë ishte vendosur dhe kështu ndodhi. Këtu mbyllet biseda me kolegun e zyrës, që kuptova se u ndje paksa i zhgënjyer, për vazhdimësinë e punës së tij lidhur me komunikimin

dhe publikimin në media, si një e re e pritshme në veprimtarinë e asaj ministrie. Ai ishte shumë i apasionuar dhe i përkushtuar në punën e tij me median dhe komunikimin me publikun, gjë që më krijonte respekt për seriozitetin me të cilin përkushtohej në punën e tij. Më ka ardhur paksa keq kur u largua para kohe nga detyra e tij në atë ministri, me gjithë debatet midis nesh..nuk ofendohesha kur shprehej për mua: "Ajo do vetëm pyjet", sepse e mirëkuptoja sensin e të folurit të tij.

Momenti i dytë dhe i fundit që kujtoj lidhur me inceneratorët, ishte dita e përurimit të inceneratorit të Elbasanit, sepse për inceneratorët e tjerë nuk kisha dijeni. Shkoj në mëngjes për në zyrë si zakonisht dhe më çuditi fakti që ministria kishte rënë në qetësi. Pyes rojën te dera e ministrisë se çfarë kishte ndodhur dhe ai më sqaron që kishin shkuar shumica në Elbasan, sepse përurohej inceneratori, emrin e të cilit e shqiptonte pak me vështirësi. Në zyrë, gjithashtu, nuk gjeta njeri, sepse kishin shkuar të gjithë në Elbasan dhe për kuriozitet ndoqa lajmet e ditës në zyrë për të parë rreth përurimit, që nuk më la ndonjë mbresë të veçantë.

Pavarësisht problemeve të tij me drejtësinë, për çështjen e inceneratorëve, lidhur me ministrin do të vlerësoja mënyrën e komunikimit lidhur me mbrojtjen e pyjeve në atë periudhë, veçanërisht në gatishmërinë për ndërmarrjen e dy Moratoriumeve, kur u ndje një sensibilizim i veçantë dhe në rritje, lidhur me mbrojtjen e Pyjeve në vendin tonë. Këtë ma përmendin shpesh edhe miq dhe të njohur, të interesuar për mbarëvajtjen e Pyjeve.

Personalisht u ndjeva e përkushtuar në këtë pjesë, për më tepër që e shihja si shumë të rëndësishëm ndikimin në opinion për një rritje ndërgjegjësimi në fushën e mbrojtjes së pyjeve dhe mjedisit në tërësi.

Në të vërtetë, ishte detyrë e shoqërisë civile, e shoqatave mjedisore të krijuara dhe të shtuara vitet e fundit, që duhej të kontribuonin në rritjen e sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit të opinionit publik; janë të shumta në numër shoqatat, janë të shumta projektet e tyre, por nuk janë të duhurat rezultatet e punës së tyre voluminoze në dukje.

- Fole në emision si përfaqësuese shoqate, - më thotë një ish-kolege e medias, pas një daljes sime në një intervistë emisioni televiziv. Kjo ishte një vërejtje, që, si përfaqësuese e ministrisë, nuk duhej të shprehja kritika për gjendjen e pyjeve dhe të mjedisit në Shqipëri, por duhej të flisja vetëm për *anët pozitive* të situatës mjedisore dhe për pjesën tjetër të heshtja... por edhe "heshtja nuk është e lehtë kur ajo zëvendëson gënjeshtrën", thotë diku V. Hygo. - Nëse do të flisnin shoqatat, nuk do të flisja unë, dikush duhet të flasë, - ishte përgjigjja ime dhe këtu u mbyll biseda...ndërkohë daljet e mia në emisione televizive u rralluan.

Me ndryshimet në zgjedhjet e vitit 2017, ndryshimi i emrit të ministrisë (nga Ministria e Mjedisit do të quhej Ministria e Turizmit dhe Mjedisit), sigurisht që do të kishte lidhje me ndryshimin e përparësive. Turizmi i pari dhe më pas Mjedisi, aq më pak pyjet që nuk zihen më në gojë (dikur ishin të parat në përparësitë e asaj ministrie).

Paradoksi qëndron se nuk mund të ketë Turizëm pa Mjedisin e standardit të duhur, të cilit i përshtatet

Turizmi *Low Cost*, (turizëm i vlerësuar për standardin e ulët të çmimeve), që ka marrë përparësi tek ne kohët e fundit. Në këto kushte, nuk bëhet fjalë për turizëm elitar, që do t'i shkonte për shtat turizmit në vendin tonë, të paktën për natyrën e egër malore të lidhur ngushtë me pyllin, aq të parapëlqyer sot nga turistët e nivelit elitar.

Vazhdon të heshtet për Pyjet, ndërkohë që kriza mjedisore është e pranishme, si pasojë e pakësimit të kurorës së gjelbër...vazhdon të heshtet për Pyjet, kur po bërtitet gjithmonë e më tepër për çështjet të cilat e shqetësojnë deri në nivel global *Politikën për Klimën, Ndryshimet Klimatike dhe Mjedisin*. Në këto kushte pyjet janë deklaruar si një nga shtatë çelsat e zgjidhjes së këtij problemi madhor, por që në fakt zgjidhin një të tretën e problemeve; e mjaftueshme kjo për të kuptuar rëndësinë e jashtëzakonshme të mbrojtjes së pyjeve kudo në botë, po aq sa edhe pikëpyetjen e madhe për mungesën e përkushtimit sa duhet për mbrojtjen dhe mirëqeverisjen e kësaj pasurie të qënësishme sot deri në nivel global..

Duke u kthyer nga shëtitja e zakonshme në Parkun e Liqenit, rastësisht takoj një ish-kolegun tim të respektuar që vazhdon të punojë në institucionet e shtetit, në fushën e mjedisit:

- Çfarë po ndodh me Pyjet tani, se nuk po dëgjoj të flitet? - e pyes me kuriozitet, për të mësuar diçka të re rreth Pyjeve. Me shumë sinqeritet dhe në mirëbesim më përgjigjet me zë të ulët:

- Nuk ka më Pyje, çfarë mund të të them...?!

Të mendosh që Pyjet janë lënë në harresë, sepse janë

në zhdukje, do të thotë të kuptosh që ky vend është i paracaktuar të përballet me situata të papritura, ashtu siç po ndodh aktualisht, me katastrofa në fushën e mjedisit, të erozionit, për pasojë të rrëshqitjeve të tokave, përmbytjeve për shkak të mbushjes së lumenjve...së fundi, të mungesës së druve si burim energjie në zonat rurale. Për pasojë, ajo që po shihet tani është rritja e çmimeve, që do të thotë varfëri e mëtejshme, që i shtohet mungesës së frymëmarrjes dhe stresit të kudogjendur në mjedisin përreth.

QUO VADIS?

Nuk është e thjeshtë t'i përgjigjesh kësaj pyetjeje, që sot ka marrë formën e pyetjes shekspiriane për dilemën e madhe jo vetëm për botën rreth teje, por, gjithashtu, për vetveten edhe familjen. Në një lloj mënyre jeta është e ndërvarur nga shumë faktorë...jetojmë brenda një realiteti, që me gjithë pavarësinë dhe lirinë që mund t'i japësh vetes, arsyeja të detyron përshtatjen me realitetin, me dëshirë ose jashtë saj.

Një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve e kanë dhënë përgjigjen duke u larguar nga ky vend, ndoshta pa ditur se kjo pyetje do t'i ndjekë gjatë gjithë jetës kudo që të jenë larg vendit të tyre, ku, pavarësisht arritjeve, do të ndihen të huaj në mes të të huajve. Është e vërtetë që mund të zëvendësohen shpejt mungesat materiale, por nuk mund të zëvendësohet komoditeti i gjuhës amtare me gjuhën e huaj, identiteti me pasaportën e huaj, rëndesa e qenies dhe gjithçka e dashur e lënë pas në vendin tënd. Atdheu mbetet i vetmi vend i përjetimit të ëndrrave më të bukura të fëmijërisë, të rinisë, pse jo edhe shumë më tepër se kaq.

Emigracioni ka qenë bashkëshoqërues në jetën e shqiptarëve gjatë gjithë historisë (përveç kohës së regjimit të diktaturës, kur ishte i ndaluar me ligj), kurse sot përbën një nga termat më të lakuar të ditës në këtë vend.

M'u desh të merresha me analizën shumëdimensionale të këtij fenomeni gjatë kohës që punova në atë sektor

në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale. Detyra jonë si sektor ishte të punonim për strategji, rregullore, ligje, vendime e të tjera si këto rreth imigracionit dhe emigracionit. Dukej një punë pa fund, me statistika, evidenca, seminare, trajnime, bashkëpunime me ministri të ndryshme, me parlamentin, me konferenca brenda dhe jashtë vendit..

Kjo dhe shumë të tjera si këto tregonin për *interesimin e shtetit tonë ndaj kësaj çështjeje tepër shqetësuese*. Nuk e di se çfarë mund të arrihej nëse të gjitha këto energji do të shpenzoheshin jo vetëm për ta vëzhguar dhe paraqitur si fenomen, sesa për ta luftuar sa më shumë atë. Mbi të gjitha, për të minimizuar shkaqet e këtij fenomeni, që po pakëson jo vetëm popullsinë, por, mbi gjithçka, vlerat që ajo pjesë e popullsisë mbart.

Telefonoj një ditë Elonën, ish-kolege pune në Sektorin e Emigracionit, shumë e përkushtuar në detyrën e saj, shumë më e re në moshë, por që ruajmë kujtime dhe mbresa të këndshme nga koha që kemi punuar së bashku. Doja ta uroja pasi para pak kohe kishte celebruar lidhjen me njeriun e saj të dashur.

- E vure rrethin? - i thashë me humor.

- Po, - më tha - dhe do të takohemi së shpejti, të përshëndetemi, sepse kemi vendosur ta lemë Shqipërinë... - Mirë do të bëni, - iu përgjigja, (sepse tani është kthyer në lajtmotiv kjo shprehje); por në fakt përgjigjja ime nuk ishte miratim me zemër, sepse thellë ndjeva keqardhje për një mike të mirë më pak, që u shtohet miqve të munguar dhe jo vetëm kaq.

Elona, sikurse dhe Eva, që bashkëpunonin lidhur me detyrat që kishin në Sektorin e Emigracionit,

hynin në vajzat me kërkesa për jetën, për punën, për shoqërinë, në përshtatje edhe me profesionin kushtuar çështjeve shoqërore. Nga përgjigjja e vendosur që do të largohej, kuptova që ishte pa vlerë të diskutonim si dikur, nëse edhe këtu mund të jetohej me dinjitet dhe e vlerësuar, sikurse ishte dëshira e saj; prandaj nuk më mbeti veçse ta uroja t'i shkonte mbarë dhe t'i realizonte shpresat e humbura këtu. Pas pak kohe do të takoja Evën, gjithashtu një vlerë në atë sektor, në atë kohë dhe në vazhdimësi. Veç të tjerash, ajo punonte për kualifikimin e mëtejshëm në fushën e Emigracionit, për titullin Dr. Shkencash. Ndihej tepër e suksesshme dhe e kënaqur, ndërkohë që kishte lindur edhe një vajzë, gjë që më gëzoi pa masë. Jemi mirë bashkë me Gentin, më tha, megjithatë, e mendojmë edhe largimin. Vajza me vlera, të mirëpërgatitura për punën dhe jetën, të ndërgjegjshme, veç të tjerash rreth emigracionit, për të cilin punonin dhe tani mendonin të hynin edhe ato në radhën e gjatë të atyre që mendojnë të bëjnë gati valixhet për në *botën e lakmuar*. Ishin Eva dhe Elona, që punonin për projekte që kishin për qëllim ndalimin e të ashtuquajturës *rrjedhje e trurit* (largimin e trurit), apo për të nxitur *thithjen e trurit* tashmë të larguar, që zyrtarisht justifikohen me *të drejtën e lëvizjes së lirë*.

Me gjithë keqardhjen, kanë të drejtën e tyre si të rinj dhe meritojnë ta jetojnë jetën ashtu si të ndihen më mirë. Edhe ne në moshën e tyre nuk i shpëtuam tundimit të largimit, veçanërisht kur miqtë tanë, Rexhina me Besnikun, me të cilët ndanim kohë dhe biseda së bashku, kishin marrë vendimin e emigrimit në Kanada. Ishte viti 2000, kur miqtë tanë, Besniku fizikan, shok

i Nestit në vite, që prej fakultetit, (punonjës ministrie në atë kohë); Rexhina, matematiciene e specializuar në fushën e informatikës, që sapo kishte përfunduar edhe Fakultetin Ekonomik (ish-zëvendësguvernatore e Bankës së Shqipërisë), kishin vendosur të linin vendin, familjen dhe gjithçka kishin arritur. Do t'ia fillonin nga e para në Kanadanë e largët, por edhe premtuese për kërkesat e tyre të së ardhmes, të cilat fatmirësisht i përmbushën më së miri aty, familjarisht dhe profesionalisht. Largimin e tyre e pritëm me kënaqësinë që po u plotësohej dëshira e mirëpritur, po aq sa edhe me keqardhjen që do ta ndienim mungesën për miqësinë që kishim ne dhe fëmijët tanë.

Të ndikuar veçanërisht prej tyre, vendosëm edhe ne të aplikonim dhe, pasi plotësoj formularët, *për të hedhur edhe ne zaret e fatit*, i jap zarfin Nestit për ta postuar. Nesti, që ishte më i pavendosur se unë, (oponencë e përhershme para marrjes së vendimeve të përbashkëta), me zarfin në dorë, kishte takuar motrën time Lidën, që e dinte se ajo do të ishte kundër largimit tonë dhe nuk kishte gabuar. Motra e kishte dhënë zgjidhjen, fare thjesht, duke grisur zarfin dhe duke e shpëtuar Nestin nga *tundimi që po vuante*.

- Pyet motrën, - më thotë, kur e pyes për zarfin, kur po vonohej përgjigjja. Të vërtetën do të ma tregonin më vonë, kur po dyshoja mbi vonesën e përgjigjes së aplikimit, por edhe kur kuptuan që edhe unë isha tërhequr nga vendimi i ikjes. Tani do të ndiheshin *shpëtimtarë për të keqen që do të na priste po të ishim larguar*.

Vendimin për të mos emigruar do ta merrja atëherë kur gjatë një vizite zyrtare në FAO/Romë i bëj një vizitë

Marianës, kushërirës me të cilën kishim ndarë shumë kohë së bashku në Tiranë, kur isha studente dhe rrija te prindërit e saj, njerëz bujarë dhe të kulturuar. Mariana shkoi që në fillimet e largimit të shqiptarëve drejt Italisë, sepse burri i saj Ingri kishte mamanë italiane dhe ikja në Itali kishte qenë me të drejtë ëndërr e hershme e familjes. I gjeta të stabilizuar familjarisht me fëmijët e tyre, Nensin dhe Fabion, të cilët do të përligjnin edhe largimin e tyre nga një jetë komode në Tiranë, (krahasimisht me të tjerët në atë kohë), gjë që më bëri të ndihesha mirë për miqtë e mi të dashur.

Ishte ditë e shtunë në darkë dhe të nesërmen do të nisesha për në Tiranë. Mariana si gjithmonë shumë xhentile, (sot një kujtim i paharruar), m'u lut të mos shkoja në hotel atë natë dhe të qëndroja në shtëpinë e tyre, për më tepër që atë natë do të mblidheshin me miq të tjerë shqiptarë, për të kaluar së bashku një darkë, gjë që e bënin shpesh mes miqsh. Takimi ishte lënë në një sallë boshe diku, që nuk e kujtoj kujt i përkiste, por kujtoj miqtë dhe shokët e tyre, disa prej të cilëve i njihja dhe unë që në Tiranë. Të gjithë vinin me gatimet e përgatitura më parë në shtëpi dhe, pasi shtruan tryezat, filluan të hanin dhe të bisedonin njëkohësisht. Ajo që më ra në sy ishte ndryshimi pas pak vitesh i personave që njihja, që po i gjeja me pamje pak të lodhur. Ishin miq të tyre, që dikur i përkisnin elitës së Tiranës nga profesioni dhe pozicioni në shoqërinë e intelektualëve të kohës dhe kishin shkuar aty për një jetë më të mirë. U ishte dashur të ndryshonin profesion nga mjekë dhe pedagogë, që kishin qenë dikur, të punonin në profesione të tjera. Sigurisht, me kalimin e viteve janë stabilizuar

mirë, sikurse motra e Marianës, Liliana, që është njëra prej tyre e integruar plotësisht si mjeke; por tek unë ndikoi ajo vizitë për një mendim ndryshe, për të mos e menduar emigrimin.

Të njëjtën situatë do të përjetoja në ato vite kur të takoja rastësisht miq dhe të njohur emigrantë në Greqi dhe SHBA, te të cilët e ndieja të vështirë të dalloja të njëjtën shprehje komunikimi me të shkuarën. Kështu e mirëprita *tradhtinë* e motrës dhe të Nestit për mosdërgimin e zarfit në ambasadë, edhe kur nga miqtë tanë aty merrnim lajme të mira që ishin rregulluar më së miri. Pëlqyem të mos largoheshim dhe të shpresonim të ndryshonte jeta jonë për më mirë, por edhe pse nuk ikëm vetë, nuk ngurruam të largonim nga ky vend gjënë më të shtrenjtë, fëmijën, në momentin kur kuptuam se këtu nuk do të kishte të ardhme.

Ishte viti i paharruar 1997, kur Shqipëria hyri në kaos dhe gjithçka kaloi në anormalitet...kur motra së bashku me bashkëshortin e saj, si shumë të tjerë në atë kohë, larguan vajzën e madhe Zelinën, dhe pas një viti edhe vajzën e vogël Emin, për të vazhduar shkollën e mesme dhe më pas studimet e larta në Francë.

Nuk ishte vendim i lehtë, sepse do të shoqërohej me sakrifica jo vetëm nga ana financiare, por njëkohësisht edhe ankthi për përballjen e vajzave minorene me një jetë të panjohur, megjithëse mbështeteshin nga një familje franceze. Fillimisht ideja ishte për studime dhe ishte e domosdoshme ikja e tyre si shpëtim nga rreziqet e kohës, kur asgjë nuk ishte e sigurt këtu.

Si shumica në atë kohë, Kiu do të mbante armë në shtëpi, që *me mik* e kishte siguruar me leje në mbrojtje

të familjes. Ishte ndodhur mamaja te motra në një nga ditët e *luftës së vitit 1997*, kur papritur kishin dëgjuar krisma armësh afër pallatit të tyre në Pogradec.

- Kiu, gati, në pozicion me armën në dorë, - tregonte mamaja, - kurse Lida më kishte marrë mua për krahu duke më thënë e tmerruar: - Mama, po vijnë ata… - Kush ata, me? e pyesja unë... - Ata, mama… ata… bandat..- Ç'janë këto banda, me?! (mamaja shprehej bukur në dialektin korçar) - Shpejt, mama, në dhomë..! Dhe bashkë me vajzat, motra i kishte mbyllur me çelës në dhomën tjetër, për të mos parë Kiun me armë në dorë, gati për mbrojtje nëse *banditët e pritshëm* do të arrinin të hynin në shtëpinë e tyre.

- Çupat e tmerruara, më shtrëngonin fort, - deri sa krismat pushuan dhe Kiu hoqi armën nga dora, - tregonte më tej mamaja, gjithë emocione atë histori që e kishte të vështirë ta harronte.

Dërgimi i vajzave në Francë ishte shpëtim për Kiun, që të mos kishte më nevojë për armën në shtëpi, deri sa ta dorëzonte pas *luftës së vitit 1997*. Jeta ishte pak, që mund të jepte Kiu për ato vajza, por edhe për Lidën.

Kiu nuk do të harronte amanetin e babait ditën e dasmës, kur Lida po përcillej nuse te porta e shtëpisë, kur babai, duke e përqafuar Kiun i thotë: "Të ma mbash mirë çupën...!!!", gjest që u shoqërua me emocione të paharruara për të gjithë të pranishmit përreth.

Na u larguan dy dashuri, ishte dhimbje, merak, ankth si do të ambientoheshin, ishte mall që sa vinte shtohej. Mbetet e paharrueshme dhimbja që ndiente mamaja, njëkohësisht nëna që i kishte rritur, sa herë largoheshin, pasi vinin me pushime.

- Edhe kur vijnë mërzitem, sepse mendoj ikjen, - thoshte mamaja, sa herë fëmijët vinin me pushime. Ngushëllimi i vetëm ishte që ia dolën më së miri me studimet dhe më pas gjithçka shkoi mbarë, duke përligjur sakrificën e largimit dhe investimit të nevojshëm, për t'u integruar në jetën europiane, tashmë si qytetare franceze.

Pas tetë vitesh do të merrej vendimi tjetër i vështirë për mua dhe Nestin, për të dërguar Tedin, djalin tonë, po në Francë, për t'i dhënë një mundësi më tepër në vazhdimin e studimeve. Nesti, që jepte mësim në një nga fakultetet shtetërore dhe ishte më pranë arsimit në atë kohë, shpesh përsëriste: "Arsimi i sotëm është e Ardhmja e së nesërmes", që donte të thoshte mungesë shprese për të ardhmen e djalit. Marrjen e vendimit na e lehtësoi *Florent*, bashkëshorti i Zelinës, i cili si shtetas francez ofroi pa ngurruar mbështetjen e tij, për arsye të rregullit që për minorenët duhej një familje franceze mbështetëse dhe kështu u bë familja Barth për Tedin gjatë gjithë kohës që ishte pranë tyre. Lidhja me Shqipërinë i bënte të huajt dashamirës të kuptonin drejt realitetin shqiptar shpesh kontradiktor. Dëshirën e tij e nxitën edhe rezultatet e Tedit në mësime, por edhe kur ai fitoi çmim në një olimpiadë rajonale matematike, që do ta përligjnin sakrificën e përbashkët.

Nga një anë ishte situata e vështirë dhe pamundësia për realizimin e ëndrrave të së ardhmes dhe nga ana tjetër ishin përpjekjet e jashtëzakonshme për kapërcimin e pengesave me të gjitha mundësitë...ishin përpjekje këto që i kanë ndihmuar në përgjithësi shqiptarët për t'u mbijetuar situatave.

Mungesa, meraku dhe malli, do të ishin vazhdimisht të pranishme në jetën tonë, po aq sa edhe për atë, përveç vështirësive të tjera të pashmangshme.

Do ta humbësh djalin,- më thotë një mike, kur i thashë se mendonim ta dërgonim djalin për studime në Francë. U trishtova për momentin, por kur fola për herë të parë në telefon me Tedin që e pyes se si ndihej dhe përgjigja e tij ishte, - këtu edhe koshat e mbeturinave në rrugë të thonë *Merci,*- mendova se nuk kishim gabuar..

- Viti i parë ka qenë i vështirë, - kujton shpesh Tedi, më tepër se Shkolla "*Preparatoire*", që njihet nga shkollat më të vështira në Francë, por që ia doli me sukses, për të vazhduar më pas *Grande Ecole* për inxhinieri, ku ai dëshironte.

- Edhe për ne fillimi ka qenë i vështirë, - kujtojnë Zelina dhe Emi. Por vështirësitë shpesh ndikojnë në rritjen dhe forcimin e personalitetit dhe motivimin për arritjen e rezultateve të duhura drejt qëllimit final të integrimit në jetën e qytetëruar, gjë që na bën të ndihemi krenarë për rrugën ku i drejtuam.

Ndihemi krenarë kur shohim që fëmijët tanë nuk janë inferiorë ndaj vendësve, përkundrazi ndihen të barabartë në konkurrim dhe në arritje, pavarësisht vështirësive të pashmangshme të të qenit larg vendit, familjes, shoqërisë, gjuhës amtare etj.. dhe nuk janë të vetëm, por pjesë e atyre që u shtohen humbjeve të vlerave njerëzore, morale, investimeve të rritjes dhe edukimit që shteti ka bërë në vite...megjithëse ka edhe zëra shtetarësh që e konsiderojnë *krenari të shtetit që përgatit kuadro të denja për vendet e huaja*. Do të më kujtohej kjo shprehje, kur një shoqja ime më thotë e

gëzuar që burri i saj mjek, pensionist prej vitesh, kishte rifilluar punë si mjek në një fshat të afërt.

- Si ndodhi, - e pyes.

- Ka mungesë mjekësh, m'u përgjigj.

- Domethënë të moshuarit po zëvendësojnë të rinjtë që largohen nga ky vend dhe me pak humor e mbyllëm bisedën, duke e uruar për lajmin e mirë.

Me sa duket, është destinacion emigracioni i këtij populli. Parë në këtë prizëm, edhe në familjen tonë vërej dy fenomene të përsëriten: emigracioni dhe mbijetesa në mungesë të "ujdive", nëse do të quaja kështu një nga shkaqet kryesore të vështirësive dhe pengesave të kaluara mrekullisht, për fat të mirë.

Ka qenë gjyshi (babai i mamasë), Kostë Papa Konomi, nga Leusa e Përmetit, i cili emigroi në SHBA, me synime patriotike, duke kontribuar pranë shoqërisë "Vatra". Me këto synime ai u rikthye në vendin e tij në kohën e shpalljes të Pavarësisë në vitin 1913, së bashku me disa bashkatdhetarë të tjerë, për t'iu bashkuar Ismail Qemalit në Vlorë dhe pas kësaj familjes së tij në Leusë të Përmetit. Ndryshe nga sa kishte parashikuar, kundër dëshirës së tij, iu desh të përjetonte ngjarjet si dëshmitar okular i masakrave të andartëve grekë, në jug të Shqipërisë, i ashtuquajtur *Vorio Epir*. Pavarësisht zhgënjimit që nuk i pa të realizuara idealet për një vend të lirë dhe me demokracinë e dëshiruar, (për të cilën ishte kthyer në vendin e vet), kontributin e tij patriotik ai e materializoi në librin e kujtimeve "Barbaritë greke në Shqipëri", që e botoi në *Massachusetts* të SHBA në vitin 1917.

Libri është vlerësuar prej studiuesve, veç të tjerash, si i vetmi me kujtime historike të një veprimtarie pak të

njohur në studimet shqiptare, për periudhën prej Shpalljes së Pavarësisë deri në njohjen e Pavarësisë së Shtetit Shqiptar. Libri, i vogël në përmasa, por i pasur në dëshmi dhe mesazhe, veç të tjerash përçon (pavarësisht titullit) mesazhin për ruajtjen e fqinjësisë së mirë midis dy popujve (ai vetë e kishte babanë grek)...gjithashtu edhe thirrjen që u bënte shqiptarëve të bashkoheshin dhe të mos binin pré e politikave të huaja, që i nxisnin për vëllavrasje.

Veprimtaria e tij do të vazhdonte me përkthimin e librave fetarë nga greqishtja në shqip dhe kontribute të tjera ndaj Kishës në atë kohë...por në këndvështrimin e gjyshes ndryshonte puna: - Ç'më duheshin gjuhët e tij (zotëronte katër gjuhë të huaja), apo dekorata, - thoshte shpesh gjyshja (Domenika quhej, shkurt Dome) me ironi, e pakënaqur që iu ndërpre pensioni, meqenëse i shoqi kishte qenë i veshur prift. Me ndalimin e fesë me ligj në kohën e diktaturës, u hoqën edhe pensionet e personave që kishin kontribuar në institucionet fetare. Duke dëgjuar shpesh gjyshen të ankohej, ne si fëmijë mendonim që gjyshi kishte gabuar që ishte veshur prift dhe nuk i kishte lënë lekë gjyshes, që të mos ankohej.

Në fakt, dekorata e gjyshit, që qëndronte e varur në mur në një nga dhomat e shtëpisë së gjyshes, e kishte ndihmuar vëllanë e mamasë, Yllin, që t'i jepej nga Komiteti Ekzekutiv i kohës një hyrje apartamenti në pallatin më të mirë dhe më të bukur në qendër të bulevardit kryesor të Korçës (projektuar nga i madhi P.Kolevica).

- Tani mos u anko më, - i thoshin gjyshes, por gjyshja vazhdonte të kishte peng humbjen e pensionit të burrit të saj.

Më vonë do të kuptonim që gjyshi nuk la pasuri si bashkatdhetarët e tij kur ktheheshin nga mërgimi, nuk la as pension për gjyshen që jetoi edhe shumë vite pas tij, por trashëgimia e tij ishte ajo morale, atdhedashëse dhe guximi për të thënë të vërtetën.

Ishte gjyshi nga ana e babait, Kosta Vreto, nga Postenani i Oparit, të cilit iu desh të emigronte në Stamboll, i thirrur atje nga xhaxhai i tij Jani Vreto, një nga shkrimtarët dhe publicistët me kontribut të shquar në zhvillimin e arsimit shqiptar, që ka merituar titullin "Nderi i Kombit". Pas disa vitesh pune në emigracion, para se të kthehej pranë familjes (sipas tregimeve të babait mbi historinë e dhimbshme të t'et), me të ardhura të mira pas një biznesi aty me një ortak, ky i fundit ia vjedh të gjithë pasurinë në flori që e kishte vendosur në një sënduk për ta transportuar në Shqipëri (siç ndodhte rëndom në atë kohë). Pas kësaj ngjarjeje, tregonte babai, ai u sëmur dhe nuk mundi të kthehej, sepse pas pak kohe ndërroi jetë. Ishte babai më pas që i duhej të ndërpriste shkollën dhe të kujdesej për familjen, me mjaft sakrifica për të përballuar jetesën në mungesë të të ardhurave të pritshme nga i ati. - - Mbijetuam, me të gjitha vështirësitë që na u desh të kalonim, - tregonte babai.

E kujtonte shpesh këtë histori kur shihte sëndukun, kujtimin e vetëm që kishte nga i ati me gjithë vendin e hapur me tryelë, nga ku ishin marrë florinjtë e kursyer. Sënduku ishte dërguar më pas nga miqtë e tij me sendet që ai kishte përgatitur për kthimin në Shqipëri.

Si përfundim, nëse emigracioni duhej të përmirësonte ekonominë e familjes sonë, për gjyshen e mamasë,

si vlerë materiale ngeli dekorata në mur, kurse për gjyshen e babait, sënduku me dy velenxe dhe vendin e hapur si kujtim i florinjve që kishte gëzuar ish-ortaku. Mesa duket, emigracioni historikisht nuk ishte shans për familjen tonë.

Kishte studiuar në Vjenë kushëriri i mamasë, mik i nderuar në familjen sonë, pianisti i mirënjohur B. Plumbi dhe thoshte se pëlqeu të kthehej në Korçë pas studimeve, jo vetëm sepse ishte qyteti i tij, por edhe si djepi i artit dhe kulturës qytetare shqiptare, që në atë kohë qëndronte më lart se vendi fqinj Greqia. Pas zhgënjimeve të njëpasnjëshme në kohën e *demokracisë*, Borizi do të shprehej se u jepte të drejtë të rinjve që emigronin, ndoshta dhe në ndonjë provincë greke... ndërsa lidhja me qytetin e tij të dashur ishte një stimul më tepër për vazhdimin e jetës së tij koncertale pianistike në Korçë deri në fund të jetës së tij. Nuk ishte i penduar Borizi, sepse nuk janë vetëm të mirat materiale të munguara, apo dhe humbja e shpresës së të ardhmes së një vendi, që duket se justifikojnë emigracionin në një moment të caktuar. Ka qenë kjo ide që më ka shoqëruar gjithmonë, pa përjashtuar edhe kohën kur isha gati ta lija këtë vend, apo edhe kur punoja në Sektorin e Emigracionit, që në terma zyrtarë *sjell zhvillim*... gjithashtu sot, kur pasiguria e së ardhmes më bën të mendoj përsëri largimin pranë njerëzve të mi të dashur.

- Vetëm ti më mungon, - më thotë motra tani që familjarisht ndihen shumë të kënaqur, jo vetëm që janë bashkuar me vajzat në Francë, por edhe sepse aty kanë gjetur shumë shërbime të munguara këtu në vendin e tyre.

"Vive la France!", ua përsërit shpesh këtë shprehje me humor, *Guillaume,* dhëndri i tyre mjek, shumë i përkushtuar ndaj tyre dhe jo vetëm, kur marrin në Francë shërbime mjekësore që nuk mund t'i marrin këtu.

Ndërkohë, mua, përveç shumë mungesave këtu, më mungon motra familjarisht me vajzat e saj. Më mungon dashuria e motrës, bisedat pa fund në shëtitjet e gjata çdo ditë në natyrë, dhe në çdo moment të ditës, që do të mbushej me praninë e saj, më mungon pjesa e jetës ku ajo ka qenë gjithmonë e pranishme. Më ngushëllon vetëm fakti që motra gjendet pranë vajzave të saj, Zelinës dhe Emit, pranë nipërve *Aurelien, Maksimilijan, Nael* dhe bukuroshes *Eline*, të cilët më mungojnë pa masë, me gjithë komunikimin e përditshëm.

Më mungojnë fjalët për mungesën e Tedit familjarisht, për dhimbjen që më shkakton mungesa e Hygos së vogël, që shpreh aq bukur të vetmet fjalë në shqip "nëna dhe gjyshi"...por telefoni është i pamjaftueshëm që të shprehim ne atë që mendojmë dhe ndiejmë në thellësi të shpirtit.

Mungesat vazhdojnë me njerëzit e afërt të familjes, kushërinjtë, miqtë, shoqet dhe të njohur të tjerë, që përbëjnë tani një karvan të gjatë të të ikurve, që nuk i dihet fundi në njerëz dhe në kohë.

Fillimisht nga familja jonë u larguan për në Greqi djemtë e vëllait të mamasë, Kosta, Leonardi, Kristofori, djem me vlera morale dhe profesionale, së bashku me mamanë e tyre Donikën, për të mos e lënë të vetmuar pas ikjes së t'et. Më pas do të emigronte familjarisht në SHBA kushërira shumë e dashur për të gjithë,

Leonora, inxhiniere kimiste e përkushtuar...Leonora do të pasohej nga nipërit e vet dhe kushërinjtë tanë Arturi, jurist dhe ish-futbollist me emër, që emigroi në Kanada, pas të cilit do të emigronte i vëllai Genci, gazetar i mirënjohur, që u detyrua të kërkonte azil politik në Francë. Vetëm Arturi është kthyer së bashku me familjen dhe nuk di nëse mund të largohet përsëri. Nga të gjithë kushërinjtë, vazhdojnë të jetojnë këtu vetëm Nikolini, një nga studentët e dhjetorit që nuk e ka dashur emigrimin më shumë se vendin e tij, por dhe që nuk mund të linte vetëm mamanë e tij Milikën, pas emigrimit të vëllait të tij Altinit, i cili ndihet mirë i stabilizuar në SHBA.

- Jam mirë këtu pranë Nikolinit, që kujdeset shumë për mua, - thotë shpesh Milika, - por më mungojnë njerëzit e tjerë të dashur, më mungojnë tryezat e shtruara kur mblidheshim së bashku, më mungojnë këngët përmetare të kënduara aq bukur nga Donika dhe Foti dhe të tjerët që i shoqëronin me shumë kënaqësi. Si Nikolini, edhe kushërira tjetër Rezana, pedagoge dhe juriste e mirënjohur në institucionet e shtetit, shumë herë e përgatitur për të emigruar, më në fund vendosi të qëndronte për t'u shërbyer prindërve të saj Rodolfit dhe Kristinës, tashmë të moshuar.

- Fat që të kemi ty pranë, - i them shpesh Rezanës, si e vetmja e mbetur këtu nga soji i Konomëve. - Edhe unë gati jam, më thotë me një lloj humori që e karakterizon, por për sa kohë u duhem prindërve nuk mund të largohem... Rezana nuk u largua vetë, por ka larguar dy djemtë e saj Klajdin dhe Dastin për studime jashtë vendit.

- Ndihet vetmia e Adhonit dhe Licës, pa Violën dhe Shirlin,- do të më thoshte Nesti një ditë pas vizitës në familjen e mikut të tij të paharruar, A. Polenës. Ato vajza me shumë vlera, nuk i mungojnë vetëm familjes. Shirli sot e integruar në fushën e Artit në Gjermani, do t'i mungonte skenës shqiptare me zërin dhe debutimet e saj të mrekullueshme; kurse Viola, Sektorit të Mjekësisë ku kishte studiuar, për të ushtruar profesionin e saj në Francë në fushën e kërkimit shkencor.

Nestit i mungojnë gjithashtu nipërit e tij Ina dhe Tomi, të rregulluar më së miri në SHBA, por pa mohuar mungesat lidhur me çfarë kanë lënë pas.

Vazhdon të ndiehet ende mungesa e miqve të dashur Ani dhe Mikeli, edhe pse kanë shumë vite të larguar në Itali, por që i kujtoj si të ikurit nga të parët që më munguan kur kam ardhur në Tiranë dhe nuk i gjeta ata miq...shtëpia e tyre ishte kurdoherë e hapur për mua, kur isha studente dhe kalonim shumë kohë me biseda interesante për kohën.

Vazhdojnë të më mungojnë shoqet e dashura Keti, Vasilika, Tatiana, Vjollca, Sofika, e të tjera shoqe që janë larguar jashtë vendit prej vitesh dhe na bashkon vetëm telefoni apo *fb*.

Janë të pakët miqtë që kemi pranë, por edhe te një pjesë e tyre vazhdon ngasja e ikjes nga ky vend, ose më mirë ikja nga pasiguria shumëdimensionale që vazhdon të ndihet gjithmonë e më tepër.

Pas shumë diskutimesh në telefon me miken e dashur Tatianën, më thotë se, pavarësisht gjithçkaje, mbetet dëshira për t'u bashkuar me djalin e vetëm. Së fundmi edhe Tatiana po përgatitet të bashkohet me djalin,

Martinin në Angli, të stabilizuar atje familjarisht dhe profesionalisht.

E pamundur të mos përmenden njerëzit e dashur, që janë kujtime, janë pjesë e jetës, janë mall, dashuri e munguar, janë vlera të munguara të familjes dhe jo vetëm...e pamundur të mos përmenden edhe profesionet e tyre, sepse janë jo vetëm vlera të tyre personale, por edhe vlera të munguara të këtij vendi, të këtij populli, që ka investuar në edukimin dhe kultivimin e mëtejshëm të tyre...vlera të cilat i kanë vënë në shërbim larg këtij vendi, larg familjes dhe miqve që lenë prapa në vetminë e tyre.

Nuk duam të kujtojmë, mes shoqesh, vetminë, që është jo vetëm më e frikshmja, por edhe më e pashmangshmja në kushtet e largësisë nga fëmijët dhe të gjithë miqtë e dashur. Është pikërisht frika e vetmisë dhe kushtet ekonomike që lenë të hapur mëdyshjen tonë dhe të atyre që nuk janë larguar ende. Dhe nuk është vetëm ekonomia që i bën të ndihen të huaj shqiptarët në vendin e tyre, por ka edhe shqetësime të tjera që i bëjnë të mos ndihen mirë.

Është shqetësuese kur shikon në vendin tënd dhe në qytetin ku banon, pakësimin e kurorës së gjelbër dhe zëvendësimin e saj me betonin që gjithmonë e më tepër i merr frymën qytetit dhe banorëve të tij; është shqetësuese kur ndeshesh në vendin tënd dhe në qytetin ku banon me gjënë jo të duhur që ndodh në parqe, rrugë, trotuare, bulevarde, lokale, restorante, megjithëse për këto të fundit ka parapëlqim nga shumica e shqiptarëve, por edhe e të huajve që e vizitojnë këtë vend. Nusja e djalit, Marioni, e cila, sikurse dhe Tedi e pëlqen shumë

natyrën shqiptare, gjithashtu dhe restorantet, vjen me shumë kënaqësi në Shqipëri; por sigurisht ka rezervat e saj për atë që ajo ndien jashtë standardeve normale, për shkak edhe të kualifikimit të saj profesional, lidhur me urbanistikën, ajrin, zhurmat akustike të pakuptimta, mjedisin në tërësi, ku nuk mund të mos ndjejë ndryshimin në kontrast me vendin e saj, Francën.

- Mungon identiteti arkitekturor, do më thoshte një ditë duke shëtitur në bulevardin e Tiranës, si dhe harmonia e pjesës historike me modernen. - Ndërsa ajo fliste, m'u kujtua ngjarja e frikshme, prishja e Teatrit Kombëtar, një nga veprimet e dhimbshme për qytetarinë tiranase, megjithë rezistencën e elitës së artistëve të mbështetur nga një shumicë qytetarësh.

Ishin të bukura netët, kur së bashku me motrën, e kishim zëvendësuar shëtitjen e zakonshme të darkës me vajtjen tek sheshi përballë Teatrit Kombëtar. Ishte kënaqësi të takonim miq me të njëjtin shqetësim dhe preokupim për prishjen e asaj ndërtese dhe na dukej e pamundur të prishej Teatri, ajo godinë që mbartte art, arkitekturë, histori dhe kujtime të shumta. Rezistenca qytetare nuk ia arriti qëllimit aq shumë të mirëpritur, nga shumica e qytetarëve në Tiranë dhe jo vetëm...ndërtesa e Teatrit Kombëtar u prish papritur, duke marrë me vete historinë së bashku me kujtimet shumëvjeçare, jo vetëm të aktorëve që kishin debutuar në atë Teatër, por edhe të qytetarëve që e kishin frekuentuar atë ndërtesë me shumë emocione në vite.

Nuk dua të mendoj se çdo gjë që bën qeveria në një vend me probleme të shumta, si vendi ynë, është e keqe. Sot i gjithë globi është i përfshirë në vorbullën e problemeve

për zgjidhje...trazirave politike...korrupsionit, kësaj sëmundje të pashërueshme që ka shtrirë metastazat e saj kudo ku ka mundur)...për pasojë, krizës ekonomike që po ve në dyshim deri edhe S*istemet Politike aktualë*... përplasjeve të politikave sa paqedashëse aq edhe luftënxitëse...frikës për mospërsëritjen e historisë së luftrave që e kanë shpënë prapa në kohë njerëzimin, e të tjera si këto. Në këto kushte, janë vetëm shpresa dhe besimi ato që na bëjnë të mendojmë më të mirën për të ardhmen tonë dhe të fëmijëve tanë.

Pavarësisht gjithçkaje, besoj se mund të ecet drejt në rrugën e duhur, falë vullnetit dhe këmbënguljes për të qenë vetvetja në çdo kohë dhe rrethanë, si edhe falë besimit tek e Vërteta dhe Zoti, ajo Forcë e mistershme që na ndihmon gjatë përpjekjeve tona, në bërjen realitet të ëndrrës sonë. Mund të jetë rruga më pak e shkelur, që është edhe rruga më e vështirë njëkohësisht, por është rruga ku mjafton të bësh si duhet pjesën që të takon, për të jetuar normalisht Ëndrrën e Jetës (një nga këshillat e mia që u jap fëmijëve).

Kënaqësia për gjithçka të realizuar, bazuar në parimet e tua, mbetet një nga kënaqësitë e viteve që sigurisht janë më afër fundit të udhëtimit të trenit, me shpresën që udhëtimi të vazhdojë i qetë në të njëjtat shina deri në Stacionin e Fundit…

EPILOG

Duke u kthyer nga shëtitja e zakonshme nga Parku i Madh i Liqenit, ku kënaqësisë së bukurisë pranverore të gjithçkaje që jeshilonte, iu shtua edhe telefonata e Rezanës, e cila më fton të kaloj nga zyra e saj. Jemi takuar shpesh me Rezanën në Kafe, por rastësisht mësoj që zyra e saj gjendej te godina e ish-zyrës sime në Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve, vite më parë.

- Jo, i thashë fillimisht, disi me humor, - nuk vij, sepse do të kem emocione të hyj në atë ndërtesë pas shumë vitesh (për herë të fundit kisha qenë aty pas lirimit nga detyra, për të bërë dorëzimet e shkëputjes nga puna).

- Lëri emocionet, më thotë, - po eja se kam pak kohë të lirë për të pirë një kafe së bashku. Vendosa të shkoja, me dëshirën për të takuar Rezanën, por edhe duke menduar që ndoshta nuk do të ishte keq të kujtoja atë kohë.

Kaluam vite në atë ndërtesë, ku Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve iu dha kati i dytë i ndërtesës, për të qenë afër fizikisht me stafin e Projektit të Pyjeve të Bankës Botërore, në katin e parë. Investimet për ato zyra të reja u bënë nga kredia që BB jepte në kuadrin e ristrukturimit të Sektorit Pyjor. U ngrit gjithçka nga fillimi, që nga rikonstruksioni i zyrave dhe të gjitha pajisjeve të nevojshme. Gjithçka ishte e re dhe komode për të dy katet e ndërtesës.

Ngrinë emocionet, sapo hyra në portën kryesore ku gjithçka ishte e ndryshuar dhe asgjë nuk po më ngjasonte

me atë që kishte ngelur në kujtesë nga ajo kohë. Shkoj në zyrën e Rezanës, ku shijoj çajin e servirur me shumë dashuri dhe bisedën e këndshme si gjithmonë.

Ndërkohë, mësoj se në katin e dytë gjendeshin zyrat e Agjencisë së Mjedisit, njëkohësisht, zyrat që varen nga po ajo ministri që përfshiu dikur Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve. Di që është një agjenci që formalisht ka në veprimtarinë e saj edhe pyjet, por që nuk ka asnjë lidhje me atë agjenci që duhej të krijohej në atë kohë, në kuadrin e Projektit, bazuar në parimet e vetëfinancimit të Sektorit Pyjor.

Ndërkohë që Rezana po më shoqëronte në dalje, duke kaluar afër ish-zyrës sime të dikurshme, nuk munda të përmbaja emocionet, por edhe kuriozitetin dhe dëshirën për të parë ish-zyrën time të shumë kujtimeve të shkuara...mendoja se do të gjeja po atë zyrë me po ato pajisje, meqenëse ishte vazhdimësi e të njëjtit institucion. Trokas në derë me shumë emocione, pak e rezervuar dhe me ankth, se nuk dija çfarë mund të shihja brenda saj, por me shpresën që diçka do të ma sillte në kujtesë zyrën time të viteve të shkuara. Shoh një djalë të ri me celular në dorë, por që më buzëqeshi dhe nuk u duk i bezdisur që i tërhoqa vëmendjen nga celulari.

Përreth, gjithçka e ndryshuar, asgjë e trashëguar nga ato pajisje. Ishte gjithçka e re si edhe djali i ri, që me po atë buzëqeshje që më priti, po me atë buzëqeshje më përcolli pa reaguar aspak, pasi i thashë se hyra rastësisht për të parë zyrën ku kisha punuar dikur... Djali vazhdonte të buzëqeshte deri sa unë mbylla derën...

Ishte kjo mbresa që mbylli kujtimet e mia dhe u largova duke lënë pas *qetësinë* që mbretëronte në atë ambient zyrash, krejtësisht ndryshe nga *gjallëria e dikurshme*...

PËRMBAJTJA

Çlirimi 13
Kukulla 19
Violina dhe shkolla 24
Mbresa 32
Filmi 56
Zhgënjimi 62
Realizimi i ëndrrës 97
Pranë pyllit 112
Fejesa 131
Ndryshimi 145
Politika 183
Duri 191
Rikthimi 198
Quo vadis? 205
Epilog 224